

11-32
21

**MALET
PËRCJELLIN
OJHËTIMËN**

Tregime

8SH-32

M 2 1

8SH-32

50

MALET PËRCJELLIN
OSHËTIMËN

— Tregime —

2012
SHKURTORIA E SHKËRTORIS
PËR TREGIMET

43080

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHERI»

Dy fjalë

Në këtë vëllim janë përmbledhur tregime të autorëve të rinj, punonjës të profesioneve të ndryshme që kanë filluar të shkruajnë kohët e fundit, të botuara në organet e shtypit periodik: «Nëndori», «Drita», «Zëri i Rinisë» dhe «Puna».

Tregimet e këtij vëllimi ngjallin interes për tematikën e larme që përfshijnë, për pasurinë faktike të nxjerrë nga realiteti ynë revolucionar, për thjeshtësinë dhe rrjedhshmërinë e naracionit të tyre.

Autorët e këtyre tregimeve i ka frymëzuar vetë jeta e gjallë, njerëzit tanë të thjeshtë e me zemër të madhe, që i ndeshim kudo në jetë. Duke çfletuar këto tregime, lexonjësi do të ndjejë ritmin vigan të ecjes sonë përpara, do të dallojë shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit, që është bërë një tipar i zakonshëm për masën e gjerë të punonjësve tanë, të cilët, duke ju përgjegjur detyrave të mëdha që shtroi Kongresi V i P.P.SH., luftojnë njëherazi edhe kundër çdo çfaqjeje të huaj në ndërgjegjen e tyre. Kjo ide del në pah me forcë në shumë nga

tregimet e këtij vëllimi si te: «Njerëzit tanë», «Trau i fundit i soletës», «Dhe yjet u ndezën», «Emira», «Montatori» etj. Në ndonjë tregim tjetër autorët e marrin temën nga Lufta e jonë Nacional-Çlirimtare si p.sh. te: «Misioni i skuadrës», «Kur doli dielli majë malit» etj. apo nga e kaluara si te «Shpërblimi».

Në tërësi vëllimi lexohet me ëndje, ai të ngjall emocione dhe kënaqësi sepse në shumë nga tregimet e tij lexonjësi do të gjejë jetën dhe njerëzit që e rrethojnë, që i njeh dhe me të cilët ka të bëjë çdo ditë.

ARQILE SEMINI

NJERËZIT TANE

1

Të dielën Jorgo Bellani marton motrën. Më ftoi dhe mua në dasmë. Patjetër që do të më ftonte! Ne punojmë bashkë në një brigadë. Mirëpo unë i kam zët dasmat, janë të mërzitshme. Edhe Jorgua e di këtë gjë. Kur do të më jepte ftesën, ai nguroi për disa çaste, u përtyp, sikur diç do të thoshte, po s'i vinte mirë të hapte gojën. Unë i buzëqesha; e mora ftesën dhe i thashë se të shtunën në darkë do të vija, kurse të dielën, ditën që nxirret nusja, jo, se mund të bëjmë përsëri prova me turbinën që është në rimont. Jorgos iu çel fytyra, iu bë qejfi. E kuptova përse u gëzua. Ai e di që unë s'ja përtoj t'ja them copë një gjë kur s'më pëlqen. Pandehte se nuk do ta pranoja ftesën. Unë e pranova më tepër për t'i bërë qefin atij. Pastaj Jorgua më tha të mos harxhohesha. Unë përdrodha buzët. Derisa hyra në valle, duhet ta ngrija këmbën sipas daulles. E ku të linin gratë të shkoje me duar bosh në dasmë!... Ai

e ndërroi menjëherë bisedën. Më tha se unë do të isha miku më i nderuar në dasmë. Kjo lajkë s'më pëlqeu. Mirëpo Jorgua e tha megjithë zëmër, mbase nga entuziazmi, por e tha megjithë mënd. Aty s'kishte njeri tjetër që të na dëgjonte, prandaj heshta. Edhe Jorgua s'po fliste. Ahere unë desha të largohesha. Ai s'më la, më pyeti i mërzitur:

— Si mendon për Kriston?

— Sa ke ndërmend të ftosh në dasmë? — e pyeta.

— Nja dhjetë shokë nga puna...

— Dashke ta djegësh!...

— E, mor Ali, ç't'i bëj plakut, më zuri ky taksirat!

— Ahere duhet ta ftosh edhe Kriston!

— S'kam qejf, t'i e di!

— O të gjithë o asnjë, as mua!

— U muar vesh...

Një copë herë të vogël Jorgua ndënji me kokë ulur. Diç bluante me mendje. Unë e lashë në qetësinë e tij. Prisja që të fliste ai i pari.

— Po Zana?!... — pyeti Jorgua me gjysmë goje, duke u përpjekur të fshihte shqetësimin.

Emri i motrës sime e trondiste. Këtë gjë unë e dija dhe më vinte keq.

Nuk i dhashë përgjigje menjëherë. Jorgua më vështroi në dritë të syrit. Edhe unë e shikova. Ai e hodhi shikimin mënjanë, në një pikë të fiksuar, duke përplasur kapakët e syve sikur të ndiqte i shqetësuar përpëlitjet e një fluture në xhamet e

dritares së ndriçuar nga brënda. E kapa mendimin e tij dhe i buzëqesha për t'i dhënë zëmër.

— Le të vijë dhe Zana, punë e madhe!

— Hej, Ali Medini, ti qofsh ky që je! — tha Jorgua.

Pas kësaj ai u largua. E ndoqa me vështrim derisa u zhduk prapa pallatit të tij. E shikoja me simpati tek ecte me hapin e tij të rëndë siç ecin zakonisht njerëzit e mendueshëm ose ata që e marrin me seriozitet jetën që në moshë të njomë. Jorgua vjen i lartë nga trupi, me kurriz pak të kërrusur, me krahë të fuqishëm me kockë të rëndë. Është i ri, 28 vjeç, zanatin e ka filluar me të mbaruar shtatëvjeçaren. Unë jam përgjegjës i brigadës së parë të rimontit në repartin e turbinave, Jorgua është ndihmësi im. Në punë, ne ruajmë përgjegjësitë. Që të kuptohemi: çdo pjesëtar i brigadës diskuton, bën vërejtje, vendosim kolektivisht se si do të zgjidhim problemin që na del dhe, si marr aprovimin e përgjegjësit të repartit, jap urdhëra.

Në brigadën tonë punët nuk kanë shkuar keq deri tani, duke përjashtuar rastin e rimontit të fundit të turbinës nr. 1. Jorgon e kam mbështetje të madhe. Kemi disa vjet që punojmë bashkë, qysh nga montimi i termocentralit. Jorgos i pëlqen që nganjëherë të jetë vetëm për vetëm me mua, të bisedojë me orë të tëra. Ai sikur ka rënë në dashuri me mua! Dhe kam ç'bisedoj me të!... Jorgua është i dashur dhe me shokët e tjerë. Ai s'i duron dot mendjemëdhenjtë, sidomos servilët. Ka hak!...

Nejse! Kalojmë më tutje. Sot jam i shqetësuar. Dhe kam arësye. Do ta shpjegoj me hollësi... Duhet ditur se unë, zakonisht nuk flas shumë. Mirëpo këtë radhë më ngeci sharra në gozhdë, nuk di si ta vërtit punën, prandaj s'di si ta vërtit dhe bisedën. Ti do të kesh durim të më dëgjosh deri në fund!... Të zuri rrota bishtin, s'ke ç'të bësh! Hë, si thua?... Dakord... Kalojmë më tutje ahere!... Më parë, t'i mbushim dhe njëherë gotat! T'i s'e pi rakinë, e di!... Je mysafir, s'ke ç'bën! Vetëm dhe një gotë!...

Mua, or mik i dashur, kam disa dit që po më vjen festja rrotull. Kjo histori — se u bë histori tani rimonti i turbinës nr. 1 — filloi para dy muajve. Turbina me avull është një maqineri e ngatërruar. Ishte fjala për t'i bërë rimontin kapital me njerëzit tanë, pa thirrur specialistë të huaj, siç kishim bërë më parë. Turbina është sovjetike. Sa herë që i kemi bërë rimontin kapital ka ardhur një inxhenjer sovjetik për të drejtuar punimet. Unë kam marrë pjesë në të gjitha rimontet e turbinës, por gjithmonë nën udhëheqjen e inxhenjerit sovjetik. Tani të gjithë specialistët sovjetikë u larguan nga vendi ynë, na lanë në baltë!... Këtë vit, sipas grafikut, duhej bërë rimonti pa derman. Ahere nga t'ja mbanim?!... Kishte një rrugëdalje: specialistët tanë të merrnin përsipër një detyrë kaq të vështirë! U shpall një konkurs. Njerëzit filluan të lëvizin, të mendojnë, të diskutojnë, të nxitur më shumë nga sedra që edhe ne, shqiptarët, mund të drejtojmë rimontet e vështira pa nevojën e tutelës së huaj. Kjo ishte një çështje parimore, të cilën e kuptonin të gjithë. U disku-

tua ky problem në mbledhjen e zgjeruar të këshillit teknik të termocentralit, ku merrnin pjesë të dy brigadat e rimontit të turbinave: timja dhe ajo e Kristo Zotos. Inxhenjer Aleko Dhimitri, përgjegjës i repartit të turbinave ishte i vetmi njeri që duhej të merrte niasativën. Atij s'i mungonte përvoja në rimontet e turbinave. Megjithatë ai nguronte, e quante veten të ri. Alekua kish mbaruar studimet e larta para shtatë vjetëve në Tiranë. Kish marrë pjesë në dy rimonte kapitale të turbinave. Ishte njeri punëtor, studioz, i zoti. Unë e njihja mirë, prandaj kisha besim tek ai. Mua s'më takonte të flisja para atij, kurse Alekua, sa herë që ngrihej për të diskutuar, shikonte nga unë. Lëkundjet e tij më bënë të stepesha. Këtë pasiguri e shtoi më tepër Kristua, i cili ishte i paqartë në diskutim: herë e errësonte çeshtjen, herë e paraqiste si diçka të lehtë, duke përsëritur se një pjesë të barrës mund të merrte përsipër ai. Unë i rashë hiles. Të them të drejtën; këtë njeri e kam parë gjithmonë me dyshim! Ndofta kjo gjë më shtyu të mendoja se Kristua dëshironte të merrte niasativën. Ky mendim më futi thellë: Kristos i pëlqen lavdija — thashë me vete. Në këtë mes s'kishte donjë të keqe të madhe. Mirëpo unë e dija që ai ishte mendjemadh. Për këtë shkak s'kisha besim tek ai. Gjeta kohën, kur Kristua u ngrit për të pestën herë dhe e ndërpreva:

— Mirë, o shoku Kristo, pse e sjell muhabetin anës e anës, merre përsipër!

Kristua më shikoi me ironi dhe, pasi vuri buzën në gaz me të keq, u përgjegj:

— S'mund të dal para inxhenjer Alekos, por edhe para teje, ti je më i vjetër se unë!..

Alekon sikur e pickoi grenxa. U hodh përpjetë:

— Këtu s'është fjala për t'u prishur apo për t'u ndrequr qejfin njerëzve! Ti folë më qartë: a e merr përsipër?

-- S'di si të them! — Kristua uli sytë përdhe.

-- E po, ne jemi mbledhur këtu për të bërë diçka, jo për muhabetel...

U munduam tri orë rresht të nxirrnim ndonjë gjë në shesh, por s'ia dolëm. Më në fund, e pamë se ishte e kotë të vazhdonim.

Kjo mbledhje mbaroi kështu: u ngrit drejtori, i pakënaqur sigurisht, e na tha me një ton pak të vrazhdët:

— Mendohuni dhe njëherë! Nesër, ora tetë këtu përsëri!...

2

Të nesërmen, para orës tetë, të gjithë shokët ishin nëpër vendet e tyre. U ulën po në ato karrige, si një ditë më parë: drejtori në vendin e tij për t'i parë të gjithë në sy kur flisnin, inxhenjer Alekua në karrigen në krye të tavolinës së gjatë që shtrihej kryq me tavolinën tjetër, karshi meje, që të më pyeste me shikime; kurse Kristua në cep të tavolinës, andej nga fundi, sikur donte që të kish të bënte vetëm me drejtorin dhe t'u shpëtonte vështrimeve të Alekos. Shokët e tjerë kthenin kokën sa andej këndeje sipas rastit: kur fliste drejtori, ata shikonin nga ai; kur ngrihej inxhenjeri, kthenin kokën nga unë, ndonjë lozte me nervozizëm me gishtat e du-

arve; kur fliste Kristua, shikonin Alekon. Mendi-
met e vështrimet ishin gërshetuar kaq shumë sa
që njerëzit, kur dëgjonin Kriston, pandehnin se
ato fjalë i kisha thënë unë pak më parë dhe ana-
sjelltas.

Drejtori fliste zakonisht i ulur; ai ngrihej ve-
tëm në ato raste kur ndërhynte për të sqaruar
ndonjë mendim të ngatërruar. Lëmshi i diskutimeve
ishte mpleksur aq keq, sa që asnjëri s'dinte nga
ta kapte fillin. Jorgua, që s'e kish hapur fare go-
jën, u ngrit papritur e tha:

— E di ç'kemi, o shokë, kështu s'ecet më!
Po humbasim kohën kot! A nuk e shtrojmë këtë
çeshtje në mbledhjen e kolektivit?..

Kristua qeshi. Pas tij dhe disa shokë të tjerë.
Drejtori, mbase nuk e dëgjoi mirë, tundi kokën
me mosbesim. Unë s'thashë gjë, po shikoja Alekon,
që rrinte mendueshëm. Jorgua u skuq në fytyrë,
shtrëngoi dhëmbët, më tepër nga inati që disa
shokë qeshën. E përmbajti veten. U ul pa bërë
zhurmë.

Alekua tha:

— S'është mendim i keq!

Kristua u hodh:

— Unë s'e kuptoj, këtu s'kemi të bëjmë me ndo-
një problem politik, që ta diskutojmë me kolekti-
vin!... Ky është një problem thjesht teknik...

— S'është ashtu! — tha me rrëmbim Alekua,
pa u ngritur nga vendi.

Unë shikova nga ai: fytyra i mori një çehre
tjetër, në lulëkuqe. Iu ndez gjaku dhe zëmërimi,
që i jepnin forcë krahëve të tij për të shoqëruar me
gjeste lumin e fjalëve që rridhnin të harmonishme
dhe i bënë për vete dëgjonjësit. Po, e them pa

teprim: Alekua ka një aftësi të veçantë për të folur. Ai zgjedh çastin e volitshëm dhe ndërhyr me tërë forcat e mendjes. Nuk zgjedh fjalët, zgjedh mendimet, kërkon që të arësyetojë sa më mirë, sa më qartë, të jetë sa më shumë bindës. Është viti i dytë që Alekon e zgjedhim sekretar të partisë për ndërmarrjen. Ai është i ri në parti, por me aftësi. Këtë e thonë të gjithë, komunistët dhe të tjerët... Propozimi i Jorgos sikur e nxorri nga lëmshi i ngatërruar i mendimeve. Alekua iu drejtua Kristos:

— Përse mendon që ky është një problem thjesht teknik?! Ti e di se ç'rëndësi ka për ne që ta bëjmë rimontin me njerëzit tanë...

— Po, po! — tha Kristua për t'i dalë para fjalës së sekretarit. — Unë desha të thoja se në ç'mënyrë mund të na ndihmojë kolektivi...

Jorgua më shikoi me kuptim, ai sikur desh të thoshte: «E dëgjon servilin!!...» Unë i shkela syrin.

Alekua vazhdoi:

— Këtë gjë do ta shohim... Si mendoni ju, shoku drejtor?

— U duk puna: ne s'po nxjerrim gjë në dritë! E mbledhim njëherë kolektivin, s'kam kundërshtim, — tha drejtori me një pamje të lodhur.

Mbledhja e këshillit teknik u mbyll me kaq. Mbledhja e kolektivit u la për të pasnesërmen. Alekua qëndroi ndonjë orë në drejtori, pastaj erdhi tek unë në repart. Më tha se donte të bisedonte me mua. Dualëm jashtë, nga prapa repartit. U ulëm në një lëndinë me bar të egër, fije-shkurtër, të spërkatur me blozën e njomë, që binte nga

oxhaku i lartë i termo-centralit. Çdo gjë rreth e rrotull aty është e nxirë, qoftë nga bloza e oxhakut, qoftë nga hiri i kaldajave, nga pluhuri i qymyrit apo nga vajrat e derdhura pellgje-pellgje.

Ishte mëngjes. Ora kish kaluar nga dhjeta. Dita ishte e bukur, e ngrohtë. Dielli i marsit sikur na ftonte në gjirin e natyrës, që kish filluar të hidhte dalngadalë vello të shumë ngjyrëshe të pranverës. Unë e dua natyrën, e kam dashur që në vogëli. S'ka njeri që mos e dojë natyrën! Por ja që hallet, puna sikur na kanë larguar pak nga natyra, ose ne kalojmë pranë saj dhe nuk e vëmë re.

Hodha sytë nga kodrat përreth. Alekua ndoqi vështrimin tim. Ai e kuptoi se ç'bluaja në kokë. Mua më erdhi pak zor që u bëra melankolik; kjo s'i shkonte karakterit tim. Pastaj u pendova për qortimin që i bëra vetes: ç'të keqe kishte në dëshirën për të admiruar një gjë të bukur?!

Alekua tha:

— A ngjitemi andej nga kodrat? Unë kam kohë që s'vete më andej...

— Kemi punë — thashë unë.

— Ne me punë do të shkojmë. Ajri i pastër do të na ndihmojë për të zgjidhur problemin që na mundon!...

Unë e shikova Alekon në dritë të syrit. S'e kuptova: ai bënte shaka, apo mendonte si unë për natyrën?!... Ç'është e vërteta, propozimi i tij më pëlqeu: të largoheshim njëherë nga zhurma e maqinerive, nga nxehtësia, nga hekurat, nga vajrat, nga qymyri!...

Me këto mendime filluam të ngjiteshim në

kodrën e depos së ujit. Alekua shkonte përpara, unë pas. Ai ka trup mesatar, fytyrë të hequr; është i fortë nga këmbët. Herë herë kthente kokën prapa, duke buzëqeshur. Më pëlqejnë sytë e tij, vështrimi i tyre është i fortë, të hyn gjer në zemër. Nuk e di përse i çmoj shumë njerëzit nga sytë!...

Arritëm në majë të kodrës. Gjetëm një lëndinë të vogël dhe aty u ulëm. Një copë herë, pa folur, muarrëm frymë thellë, të kënaqur nga ajri i pastër. Alekua më pyeti:

— Pse qesh me vete?

— Hë?... Kot!...

— Ç't'u kujtua?

— E di çë?... Një natë isha në kinema verore me gruan. Ishte aty nga shtatori, vjet. Kisha veshur xhaketen. Në mes të filmit e hoqa, se pata nxehtë. Kur dolëm nga kinemaja, ndjeva të freskët. Më erdhi çudi në fillim. Pastaj e shpejgova ndryshimin: në kinema, megjithëse ishte përjashta, bënte nxehtë për shkak të frymës së njerëzve... Kur je larg nga vendet ku grumbullohen njerëzit, bën më freskët. Këtë gjë unë e kisha harruar. Tani që erdhëm këtu, m'u kujtua.

— Edhe unë e harroj natyrën... Jemi bërë njerëz të ngushtë!... — tha Alekua.

— Të vjen keq?

— Posi... dhe fajin e kemi vetë. Pse mos të organizojmë shëtitje në natyrë me kolektivin ose grupe-grupe?! Kjo do të ishte diçka e mirë, do të na hiqte mykun që kemi zënë duke ndenjgur gjithmonë brënda në qytet!

— Për ne, të martuarit, është pak e vështirë.

Ndërsa ju, beqarët, sa të vijë pranvera dhe merrni pyjet pa i thënë njeriu apo jo?

— S'e kam fjalën aty!

— Të mora vesh; bëra shaka...

— Me gjithë, mënd e them: kur del në natyrën e madhe, të freskohet mendja, të zgjerohet horizonti i mendimeve, bëhesh më optimist... Pa shiko sa bukur duket që këtu kombinati, termocentrali ynë, shtëpitë e banimit, monumenti i Stalinit, klubi, rrugët, lulishtet!... Ç'pamje e bukur! Këtë s'e kupton kur je atje poshtë. Vërtet: s'ka ca ditë që pashë në një revistë një fotografi të kombinatit, ja sikur ta kishin marrë që këtu ku jemi ne. Po e shikoja e thoja me vete: fotografia të mashtron; duke kufizuar të pamit, ajo të jep një ide më të bukur se realiteti. Kështu të duket! Tani po e kuptoj se jam gabuar. Panorama që kam para syve është po aq e bukur sa dhe fotografia e revistës... M'u kujtua diçka. Dëgjo, Ali!... Kur isha i vogël, shkoja në buzë të lumit me shokët dhe ndërtonim me baltë qytete me rrugë të gjëra e të drejta, me shtëpi të larta dhe loznim me mend nëpër sheshet e tyre, flinim në dhomat që ndërtonte fantazia jonë, i tregonim shoku shokut se ku ishte shkolla, kinemaja, veturat që lëviznin me shpejtësi dhe, së fundi, ziheshim se cili qytet ishte më i bukur... Fantazia e fëmijës e gjen të bukurën mbi sendet e zvogëluara, mbi madhësitë e kufizuara. Ndërsa fantazia e të madhit, kur është larg së bukurës, se kështu ka mundësi t'i kapë të gjitha objektet që e sajojnë atë... Ja, shikoje kombinatin! A nuk duket që këtu sikur çdo gjë: fabrikat, termocentralin, qytetin e vogël industrial, i ka vënë dora e

një fëmije si në maket, për të lozur? Nga larg njeriu e shikon më mirë të vërtetën, e kupton më mirë atë. Kështu ndodh dhe në jetë: kur largohesh nga shoku dhe vitet rrjedhin, ti e çmon më mirë atë!...

— Aleko!... Ti qenke poet, mor vëlla, dhe fillozof! — thashë unë me të qeshur.

Ai u përgjegj seriozisht:

— Poet nuk jam. Fillozof, qoftë ty, qoftë mua dhe cilindo, e bën jeta... Ja këtë po mendoj tani: si t'ja bëjmë me turbinën?! Ta marrim me radhë punën. Ku të duket më e vështirë ty, Ali; në cilat pjesë të turbinës?

— Në rregullatorin e shpejtësisë, në disqet, lopatet e... sidomos në nivelimin e tyre, e... ç'mund të dalin të papritura! — u përgjegja i menduar dhe jo shumë i sigurt.

— Ti këto pjesë i ke rimontuar vetë?!

— Ashtu është, por me inxhenjerin e huaj mbi kokë. Sa probleme teorike mund të lindin gjatë çmontimit e montimit, këtë e bën hesap?

— I ndajmë ahëre detyrat: ti për anën praktike, unë për anën teorike, si thua?

— Pse s'e merr ti përsipër, Aleko?

— Po të kisha përvojën tënde!

— Unë aty do të jem...

— Domethënë se duhet ta marrim të dy!

— Po sikur t'i hyjmë kësaj pune, ç'mund të ndodhi?

— Është nisativë me zarar!

— Unë marr përsipër që në rastin më të keq ta lë turbinën ashtu siç ishte...

— E bën dot këtë?

— E bëj!

— Vërtet?!

— Ta them me gjithë mend.

— Mua kaq më duhet, Ali. Po që dakord drejtori, që fundja në rastin më të keq, të pranojë që të humbasim një muaj punë, e marrim përsipër ahër!

— Ashtu e bëjmë, Aleko, se vajti dava e gjatë kjo punë!

— Mirë... Zbresim tani!

— Prit, Aleko, mbledhja e kolektivit ç'na duhet për derisa e zgjidhëm këtë problem?

— Unë kam nevojë për mendimin e tij, dua të forcoj besimin në veten time, më kupton? Aty mund të na dalin gjëra të reja. Këtë e kam provuar dhe herë të tjera.

Unë nuk fola. Nuk desha të kundërshtoja Alekon për një gjë që ai e kuptonte më mirë se unë.

Zbritëm nga kodra të kënaqur ose më mirë të them të gëzuar, por jo fort të sigurtë për nisiativën që do të merrnim.

3

U ndava me inxhenjer Alekon. Ai shkoi në zyrën e tij. Unë u ngjita në sallën e turbinave. U ula karshi turbinës së parë, pranë kabinës së aparateve termike. Ndeza një cigare dhe u kredha në mendime. Po vrisja mendjen për ato që bisedova me inxhenjerin. Atje, në majë të kodrës, ishim treguar si tepër entuziaztë. Na u duk se e zgjidhëm problemin, megjithëse harruam kushtin që vumë: po të pranonte drejtori që të humbis-

20/2

SHKURIMI I SHTETIT
E KOPJES 18/10/78

45082

nim një muaj punë!... Kësaj i thoshin: po doli djalë, na rroftë, po doli vajzë, të rroftë! Nga ne s'kërkohesh kjo gjë, të bënim prova. Fjala ishte për të bërë rimontin e turbinës sipas rregullave teknike që ajo të punonte pastaj me fuqinë dhe rendimentin e kërkuar. Unë qesha me veten, desha të tallesha me tundimet e mia...

Ky muhabet po zgjatej shumë, po më mërzishte. Aty për aty i dhashë karar punës që ta merrnim përsipër rimontin e turbinës pa vënë asnjë kusht. Shkova në zyrën e inxhenjer Aleksos. E gjeta me skicat e turbinës të hapura mbi tavolinë. Me të më parë te dera, më bëri shenjë me dorë që të afrohesha. Shkova pranë tij. Ai vështronte skicat pa folur. Unë i thashë se kisha ardhur për të bërë planin e rimontit të turbinës. Ai më vështroi në sy dhe buzëqeshi. S'e kuptova se ç'donte të thoshte prandaj, e pyeta:

— I the drejtorit?

— Përse?

— Ja, që të fillojmë nga puna...

— Ku?

— Me turbinën...

Alekua, pa i ngritur sytë nga skicat, vuri përsëri buzën në gaz dhe u përgjegj shkurt:

— Jo!...

— Pse?... Ne sikur vendosëm?!

— Ashtu,... po ne ngatërruam diçka.

— Çfarë?

— Se s'duhet të bëjmë eksperimente me turbinën!...

— Edhe unë kështu them...

— S'të marr vesh?

— Ja, të fillojmë që nesër nga puna!

Alekua më shikoi në sy një çast dhe sikur ma thithi mendimin. Mori një karrige, e vuri pranë tavolinës dhe më tha të ulesha. U ula, ndeza cigaren që më dha ai dhe po shikoja skicat.

— Dëgjo, Ali!... Ti thua që të fillojmë pa vënë asnjë konditë?

— Po...

— Kështu ndryshon puna... Po ne s'menduam mirë kur ishim atje lart, në kodër... Kur erdha këtu, e kuptova që ishim nxituar, kishim gënjer veten...

— Edhe mua kështu më ndodhi, si ty — i thashë.

— Po ti prapë mendon që ta marrim përsipër rimontin e turbinës?

— Duhet, Aleko, s'ka kuptim të ngurojmë akoma!... Që të fitosh, duhet të rrezikosh!

Inxhenjeri më vështroi përsëri dhe buzëqeshi. Mu duk sikur ai buzëqeshi për fjalët e fundit, që i theksova më tepër. Unë kisha ngritur një parim!... As vetë nuk e kuptova mirë përse i thashë ato fjalë: «që të fitosh, duhet të rrezikosh», për t'i dhënë zemër inxhenjerit, apo për të bindur veten? Se më në fund, i pari unë duhej të shkundesha nga mendimet e ngatërruara që po më mundonin dhe të merrja një vendim të prerë. Problemin e kisha parë e stërparë nga të gjitha anët. Vërtet që s'kisha nxjerrë një konkluzion të qartë, por instinktivisht e kuptoja se duhej të merrja nisiativën. Unë i besoja shumë instinkteve të mia, instinkteve të profesionit. Ato kurrë s'më kishin lënë në baltë.

Kurse inxhenjer Alekua e shikonte këtë çështje në një mënyrë tjetër. Ai ishte njeri i parime-

ve ose, të paktën, mundohej të ishte i tillë. Prandaj, kur i thashë se duhej të rrezikonim që të fitonim, ai u shkund nga pluhuri i ngurimit, që s'e linte ta shikonte me optimizëm problemin që po diskutonim. Ana tjetër ishte se Alekua besonte shumë tek unë, e dinte që për punët e profesionit tim nuk flisja qesim...

— Ke të drejtë, Ali, duhet t'i japim fund këtij muhabeti!...

— Hajt, se për hair do të na dalë!... Të fillojmë sa më parë nga puna, se s'më rrihet kështu, me duar kryq, duke ardhur rrotull!...

Në këto çaste, papritur, më pushtoi dëshira e zjarrtë që më shtynte të filloja menjëherë nga zberthimi i turbinës. Kjo ishte një sëmundje e profesionit. Gjatë atyre ditëve me kokëçarje dhe ngurime, mendja u kurdis që të punonte vetëm për rimontin e turbinës. Pra, ishte diçka i natyrshëm padurimi që tregoja. Këtë gjë e ndjente po aq sa unë edhe Alekua. Ai kishte diçka tjetër që s'e kisha unë: në raste të këtilla, e përmbante veten, i zotëronte pasionet, nuk rrëmbehej, bisedonte shtruar... E, jo, unë s'mund të veproja si ai!... Jo se nuk doja, por s'mundesha. Mbase kjo është e lidhur me rrugët e ndryshme që kemi ndjekur për të ardhur në termo-central?! Ndofta është e lidhur me karakterin e njeriut?! Prapë unë nuk përpiqem ta prish këtë zakon, këtë sëmundje të profesionit... Kam vënë re se inxhenjer Alekua e ndjen gëzimin, bukurinë, madhështinë e profesionit, kur është mbi skicat, kur e ka turbinën të zberthyer në skicat. Aty punon më mirë se kudo fantazia e tij. Kurse fantazia ime zgjohet plotësisht kur prek me duart e mia çdo pjesë, çdo detal

të turbinës... Ky është ndryshimi më i madh midis nesh. Kjo është një nga arësyet që e thërresin Aleko Dhimitrin «Inxhenjer Alekua» dhe mua «usta Aliu».

— Prit, Ali, mos u nxito! Para se të fillojmë nga çmontimi i turbinës, kemi punët përgatitore: duhet të bëjmë grafikun e detajuar të punimeve, forcat që do të marrin pjesë, ndarjen e punës, veglat e tjera... Afati i rimontit është i shkurtër, prandaj do të marrë pjesë edhe brigada e Kristos...

— Si ndihmëse! — ndërhyra unë.

— Po — tha Alekua, duke ndezur cigaren.

— Ai s'ka për të pranuar!...

Inxhenjeri, gjithmonë gjakftohtë, u përgjegj:

— Këtu ka rregull, ka disiplinë.

Unë s'e ngacmova më tutje. U ngrita. Para se të largohesha, ramë në ujdi që Alekua të bisedonte me drejtorin, të bënte projektin e punimeve dhe, pasi ta shikonim dhe njëherë bashkë, ta paraqitnim në këshillin teknik.

4

Në këto ditë, që ishin ditë gjithë tension pune, sikur të mos mjaftonin hallet që kisha, më plasi në derë dhe një proçkë tjetër. Zana, motra ime e vetme, kish rënë në dashuri me Kristo Zoton, kish lidhur telat me një njeri që s'e honepsja dot. Ata kishin kohë që ishin marrë vesh me njeri-tjetrin, ndërsa unë s'dija gjë. As Zana s'më kish thënë gjë, ajo s'guxonte, i vinte turp. Mirëpo dhe gruaja, që ish në dijeni të kësaj çeshtjeje, ma mbajti të fshehtë për një kohë të gjatë. Kur

ma hapi këtë muhabet, çdo gjë pothuajse ishte mbaruar, gati për të shpallur fejesën. Mua ma thanë sa për të bërë zakonin. Nuk më erdhi mirë, m'u duk sikur në familjen time ishte përgatitur një komplot prapa shpinës sime. Megjithatë nuk e bëra veten se isha fyer. I thashë gruas të më thërriste Zanën...

Ishte e dielë. Po rrija në kuzhinë duke pirë kafënë që më kishte bërë nëna. Nëna e bën edhe gjellën, ajo ma di shijen. Kam më shumë se të të vjet që jam martuar, po më pëlqen që kafënë dhe gjellën t'i bëjë nëna; bile nganjëherë më vjen mirë kur ma sjell ajo një gotë ujë. Nëna i ka kaluar të gjashtëdhjetat, po është e mbajtur, është grua kapedane, s'ja ha qeni shkopin. Për fat të mirë, ime shoqe nuk bëhet xheloze për nënën, është e urtë. Pata me tërë mend fat me Dritën, se, siç i thonë fjalës, gruaja e prish, gruaja e ndreq shtëpinë... Kështu pra, isha në kuzhinë, duke pirë kafënë. I hapa nënës muhabetin e Zanës.

— Jo, mor bir, edhe unë s'di gjë; ja sot ma tha nusja!

— Si mendon ti, nëne, t'ja japim?

— E, ore Ali, vajza derë e botës është! Zana e ka vaktin derisa i doli fati, ta lëmë të shkojë në punë të saj!

— E njeh djalin ti, nëne?

— Nusja thotë se është djalë i mirë. Unë s'e njoh për vete. Pastaj, Zana s'është e vogël tashti, i mbushi njëzetedy vjeç; budallaqe s'është, sytë në ballë i ka!

E pashë që ishte e kotë ta vazhdoja më tutje muhabetin me nënën. Shkova në dhomën time dhe

thirra Zanën. Ajo erdhi bashkë me gruan. Unë isha ulur në krevat. Zana u ul në kolltukun tek, duke më qëndruar brinjas, rrinte me kokë ulur. Drita u ul karshi meje, pranë Zanës. Të dyja rrinin si mbi gjemba. Gruaja kishte frikë se mos i bërtisja që ma kishte mbajtur të fshehtë këtë punë një kohë të gjatë. Zanës i dridhej zemra: a do ta jepja unë aprovimin për Kriston?... Më erdhi keq për të dyja, që rrinin si pula të lagura! Thashë ta ngrohja pak atmosferën. E pyeta Zanën me të qeshur.

— Po sikur të them jo, ç'do të bësh ti?

Zana s'u përgjegj, e vari kokën më shumë. E pashë që ishte gati të zhgrehej në vaj.

— Do të ikje pa pyetur, do të na lije shëndenë! — shtova unë.

Në këto fjalë e sipër, në faqet e Zanës rrëshqitën dy çurka lotësh. Mua më hipi damari. Nuk e duroja dot këtë dobësi të motrës. I ishte bërë zakon sa herë e qortoja për ndonjë gjë, në vënd që t'u përgjigjej pyetjeve të mia, ulte kokën, s'fliste dhe më në fund mbushte sytë me lot. Kështu ndodhte sa herë që ajo e ndjente veten fajtore. Unë doja t'i mbushja mendjen se e kishte gabim, ndërsa ajo bënte si fëmijë. Më vinte inat dhe filloja të bërtisja. Prapë ajo s'nxirrte asnjë fjalë: rrinte me kokë ulur, me sy të përlotur. Ahere e përzeja. Kurse tani po i flisja me të butë, me të qeshur. Siç dukej, këtë radhë Zanës i vinte më shumë gjyç se zakonisht.

— Zana, kjo s'ka kuptim! — i thashë duke u përpjekur ta përmbaja inatin — Fajin e ke ti, Drita, të ma kishe thënë me kohë!

— Por dhe tani s'është vonë — u përgjegji gruaja.

— Po — tha ajo me gjysmë goje.

— E ke menduar mirë këtë punë!? Martesa s'është lojë, ti s'je e vogël tani, e kupton! E njëj mirë Kriston?...

«Po» — dëgjohej zëri i Zanës sa herë që e pyesja për të fejuarin.

— Po ti, si thua, Ali? — më pyeti motra papritur.

Unë, u ndodha ngushtë. T'i thoja ato që mendoja për Kriston, ajo s'do të më kuptonte, bile mund ta trashja më keq muhabetin! Të jepja pëlqimin, prapë s'ma mbante! U mendova për disa çaste dhe i dhashë karar punës, duke zgjedhur një rrugë të mesme.

— Dëgjo, Zana!... Të më kishe folur më parë për këtë gjë, do të kish qenë më mirë! Unë s'të them as po as jo tani... Mendoje dhe një herë këtë punë, s'ke pse të ngutesh!

Ato u ngritën të dyja në një kohë, dolën nga dhoma, mbase të pakënaqura, po më pak të shqetësuara.

Këtë muhabet ma hapën përsëri pas dy javësh. Gjatë kësaj kohe kishin ndodhur disa gjëra: u bë mbledhja e kolektivit, u nënshkrua kontrata për rimontin e turbinës, bile filluan dhe nga puna në stil të gjërë.

5

Kristo Zotua u bë që u bë dhëndri im. E pashë që s'mund të dilja përpara vrullit të dashurisë së

zjarrtë. E ç'është kjo dashuri, djall o punë?! Unë s'i besoj shumë me ç'më kanë parë sytë me disa të rinj, që në fillim digjeshin për njeri-tjetrin, pastaj kanë përfunduar keq! Zjarri i dashurisë i ngjan zjarrit të furrës së kaldajës; atë duhet ta ushqesh vazhdimisht me qymyr ose mazut, ndryshe ai shuhet menjëherë. Kështu më duket mua! Mbase Kristua e Zana do të kenë forca ta mbajnë gjallë flakën e dashurisë sa të bëjnë një fëmijë, sa t'u lidhen këmbët?! Ndofta nga që më djeg miza për motrën time, e shikoj me frikë dhe s'e kuptoj dashurinë që bën rinia e sotme!... Nejshe, unë e kam bërë ndryshe dashurinë me gruan, në se këtë mund ta quajmë dashuri në kuptimin e sotëm të fjalës. Ne kishim kohë që ishim njohur, kishim biseduar disa herë, kishim këmbyer vështrime dashurie. Dhe kur erdhi puna për të folur hapur, kaluam drejt e në temë. I thashë një ditë Dritës:

— Dëgjo, a pranon të martohesh me mua?

— Po! — tha ajo e turpëruar dhe uli kokën.

— E ke menduar mirë këtë gjë?

— Po ti?

— Kam nja pesë muaj...

— Edhe unë, Ali!...

— Mirë, mirë, mendoje dhe njëherë! Ik tani!...

Ne u fejuam pas një viti. Ç'hoqi Drita e zezë gjatë kësaj kohe! Ajo punonte në kombinat. Herë pas here, para ose pas punës më zinte rrugën dhe më thosh që të shkoja në familjen e saj.

Unë ja prisja shkurt:

— Mendohu, mendohu dhe njëherë. Mendo për këtë... mendo për atë!... — dhe nxirrja një së-

rë kleçka. Në të vërtetë, gjatë kësaj kohe unë he-
toja andej këtej për t'u siguruar mirë për vajzën.

Më në fund, Drita e humbi durimin. Një ditë,
ajo më tha me lot në sy:

— Ti s'më do mua, Ali, ti tallesh me mua, ti
do një tjetër!...

— Jo, Drita, të betohem, më beso!... — mi-
rëpo ajo s'pritti sa të mbaroja unë.

Pas këtij takimi, dërgova shokët e mi në fa-
miljen e Dritës, për t'u kërkuar vajzën... Nejse...
u martuam. Tani kemi tri vajza. Përpiqemi të ke-
mi dhe një djalë. Drita është përsëri shtatzënë.
Nuk kemi shkuar keq gjer më sot. Mua më kënaq
një gjë: e kam gruan punëtore dhe të urtë...

Pra, siç shikon, unë s'kam shumë haber nga
dashuritë që janë të mbushura plot me premtime,
gjithë zjarr e mall të papërmbajtur për t'u takuar
çdo ditë. Mbase unë s'arrij t'i kuptoj të rinjtë e
sotëm! Edhe vetë s'jam kush e di se sa i vjetër,
aty rrotull të tridhjetepesave jam. Po më duket se
kohët kanë ndryshuar shumë, e bashkë me to
edhe njerëzit. Duhet të pranojmë një gjë: ndry-
shimet tek ne tani ndodhin çdo vit dhe jo çdo
dhjetëvjeçar. Këtë diferencë kam unë me Kris-
ton. Tek ky vetëm një gjë s'më pëlqen: është
mendjemadh! Kjo është një fatkeqësi, që tregon
se ai s'ka shumë mend në kokë. Nejse... Zana i
ka ngjarë nënës; do të dijë ta vejë në udhë të
shoqin. Në fund të fundit, kjo është puna e Zanës.
Unë bëra atë që më takonte. I thashë se nuk isha
dakord për Kriston. Zana s'më dëgjoi.

Megjithatë, unë nuk e ndryshova qëndrimin
karshi Kristos. Në mbledhjen e kolektivit, ku u
diskutua për rimontin e turbinës, ne patëm një

fërkim. Kjo ndodhte gjatë ditëve që unë s'i jepja pëlqimin Zanës për Kriston. Ky e kishte marrë vesh këtë gjë dhe, i prekur në sedër, deshi të mburrej në sytë e mi. Ky do të jetë shkakun që Kristua më shpalli garë në mbledhjen e kolektivit; për këtë jam i bindur. Ja se si ndodhi:

Mbledhja e kolektivit u bë po atë ditë që ishte caktuar. Unë shkova në sallë pesë minuta para se të fillonte mbledhja. Më ra në sy që salla ishte plot, kishin ardhur bile dhe punëtorët e turnit të natës. Alekua kishte zënë vend bashkë me drejtorin dhe kryetarin e komitetit profesional në tavolinën e vetme që ndodhej në sallë. Punëtorët ishin ulur në bango si ato të shkollave. Thashë me vete: kjo mbledhje s'organizohet kot, siç mendoja unë. Duket që puna e rimontit të turbinës zjen në të gjithë termo-centralin. S'qenkemi vetëm ne, punëtorët e rimontit, që mendojmë për këtë çështje! Po ç'do të dalë nga kjo, pa të shohim?!...

Inxhenjer Alekua, me fjalë të zakonshme, po rrjedhshëm e shtroi problemin para punëtorëve. Ai foli vetëm pesë ose shtatë minuta. Në fund kërkoi që të gjithë punëtorët ta vlerësonin rimontin e turbinës së parë si aksion të tyre dhe të jepnin mendimin...

Pas kësaj, u vendos një heshtje, që zgjati në copë herë të madhe. Kjo ishte diçka e zakonshme, kështu ndodhte pothuajse në të gjitha mbledhjet. Secili priste që tjetri të thyente akullin e qetësisë. Më në fund, u ngrit ai që fliste përherë i pari, Nazmiu, një punëtor në çfrytëzimin e turbinave. Ai e hodhi fjalën rrotull e rrotull:

— Le të flasim ustallarët më parë!

— Për cilët e ke fjalën? — e pyeti drejtori.

— Ja për Aliun dhe... — Nazmiu s'e çoi deri në fund mendimin e tij.

Unë shikova nga Kristua. E pashë që ai po përtypej. E dija që do t'i pëlqente shumë që Nazmiu të zinte dhe emrin e atij në gojë.

Në këto çaste drejtori lëvizi nga vendi. Ai i kish këmbët të gjata, mezi rrinte në stolin e ulët. Diç i tha kryetarit të komitetit profesional, pastaj u kthye nga Alekua. Ky tundi kokën e tha: «Jo, jo, le të flasim ata!» — e kishte fjalën për punëtorët. Drejtori i buzëqeshi si me zor dhe heshti. Megjithatë ai tani dukej në fytyrë më i çelur se zakonisht. Tërë këto ditë, që diskutohej për rimontin e turbinës, drejtori dukej i lodhur dhe i mërzhitur. E mërzhiste më shumë ngurimi i inxhenjer Alekos. Drejtori kish pandehur se problemin e turbinës do ta zgjidhte me një mbledhje të këshillit teknik, por s'i doli ashtu. Ai u lodh dhe u mërzhit duke diskutuar sa me njerin sa me tjetrin, ndërsa asnjëri s'i thoshte një gjë për të qenë. Drejtori ishte njeri që u besonte shpejt të tjerëve. Kjo e shtynte që nganjëherë të rrëmbehej pa të drejtë. Kishte një të mirë: me të thënë tjetri dy-tri fjalë të arësyeshme, fytyra e drejtorit nga e ngrysur kthehej e bëhej e qeshur...

Një punëtor nga fundi i sallës tha:

— Shoku Aleko na foli këtu si sekretar i partisë, po ç'mendon ai si inxhenjer i turbinave?

Kaq tha punëtori dhe u ul.

Salla filloi të lëvizë, të gumëzhijë nga fjalët me zë të ulët që bridhnin nga njera gojë në tjetrën.

Alekua u shtrëngua të ngrihej. Mbështeti du-

art mbi tavolinë dhe për disa çaste vështroi kanalet që ishin gërvishur aty. Në sallë ishte vendosur heshtja.

— Unë mendoj — tha Alekua dhe mori frymë thellë — se ne duhet ta marrim përsipër rimontin e turbinës!... Këtë gjë ne e kemi të qartë, por të papriturat që do të na dalin gjatë rimontit, na bëjnë të stepemi. Kur e marrim turbinën në tërësi, nuk na duket dhe aq e vështirë. Veçse kur vjen radha për t'i hyrë çdo pjese, sidomos atyre më kryesoreve, ndjejmë një farë frike: a do të jemi në gjendje t'i zgjidhim gjithë problemet teorike e praktike që do të na lindin?... Kjo është e lidhur me zakonin që është krijuar tek ne, që për rimonte të këtilla ne mund të punojmë vetëm nën udhëheqjen e një specialisti të huaj. Tani që duhet ta marrim vetë nisiativën, përgjegjësia e madhe e kësaj pune na bën të stepemi. Megjithatë, unë them se duhet ta marrim këtë nisiativë. Po do të thoni ju: hë, pra, ç'pret, ç'na mban me llafe kot! Bile ka midis nesh dhe shokë që mendojnë se kjo mbledhje do të ishte e kotë... Unë kam vënë re gjatë këtyre ditëve që po diskutohet problemi i rimontit të turbinës, bile dhe sot në këtë mbledhje, se të gjithë shokët mendojnë që ky problem mund të zgjidhet vetëm nga inxhenjerët apo specialistët, se është më tepër një problem teorik se sa praktik, se vetëm një ose dy kokë të rralla kanë punë në këtë mes. Ky mendim është krejtësisht i gabuar. Në këtë rast ne harrojmë mësimet e Partisë, besimin në forcat krijuese të masave! Po, po, shokë, kështu është!.. Turbina u bë si një gogol, nga i cili ne trëmbemi si kalamanjtë! Unë kam biseduar mënjandë me shumë shokë për këtë

geshtje. Më në fund, me usta Alinë vendosëm që ta merrnim nisiativën. E dini ç'më tha pastaj Aliu?... Që mbledhja me kolektivin s'kish përse të bëhej!.. Unë i thashë se kam nevojë për mendimin e kolektivit, për të forcuar besimin në vetvete. S'ishte vetëm kjo!.. Ka dhe diçka tjetër: dhjetë mendje punëtorësh japin më shumë këshilla të dobishme se sa një mendje inxhenjeri apo specialisti, qoftë ky dhe me eksperiencë të madhe si Ali Medini. Kështu është.... Një punëtor, p.sh. i kategorisë së katërtë, mund të japë një mendim të atillë që ta shtyjë specialistin për t'u thelluar më shumë në një çeshtje. Çdo punëtor, edhe ai më i zakonshmi, për një gjë të caktuar me të cilën merret përditë është më tepër i specializuar se sa ustai i tij... Kështu, duke i rrahur problemet punëtori, ustai, inxhenjeri, krijohet një atmosferë besimi në forcat tona, atmosferë mobilizimi dhe do të gjendet patjetër rruga e zgjidhjes së problemeve... Ja, mbi këtë bazë, mendoj unë, duhet të diskutojmë! Ta zhdukim gogolin që na kanë lënë specialistët e huaj, të besojmë më tepër në forcat tona, në njerëzit tanë!..

Alekua u ul duke na lënë të gjithëve me gojë hapur.

Unë isha i pari që u shkëputa nga atmosfera e elektrizuar prej tonit impononjës të fjalëve të inxhenjer Alekos. Hoqha një vështrim në sallë dhe vura re se të gjithë vështronin në një pikë, andej nga kishin dalë fjalët duke gurgulluar me harmoni si ujët e një burimi. Në këto çaste ndjeva një rrëngethje të brendshme të lehtë, një dridhje të ndërgjegjes... Kritikën e Alekos e mora si një qortim të rëndë. Mendja m'u çorodit. M'u

duk se isha nxituar kur dhashë fjalën për të marrë përsipër rimontin e turbinës. Kjo ishte një nisiativë e guximshme, e nxitur nga sedra e profesionit, por jo e studjuar deri në fund, jo e qartë. Kisha besim se do të dilja mirë, vetëm kaq. Isha përpjekur ta mbyjtja pasigurinë, frikën e mos-suksesit. Pra, isha treguar egoist, i njëanshëm, i besova vetëm vetes, pa u këshilluar me shokët, ashtu siç e kërkonte puna. Tani ndjeja tundim, mosbesim. Qortoja veten që s'e kisha parë problemin e turbinës në prizmin që e shtroi Alekua. Unë kisha mundësi ta shikoja këtë çeshtje ashtu siç duhej. Çfarë më pengoi?... Besimi i tepëruar në zotësinë time, në përvojën time të gjatë (dhe më vjen zor që ta them) dëshira për të qenë gjithmonë i pari, nisiatori... Ky arësyetim, ky qortim i ndërgjegjes, më ngjalli ndjenjën e modestisë. Është mirë të jesh kurdoherë modest, i thjeshtë, në jetë dhe në punë, sikur e ndjen ndërgjegjen të qetë... Thashë se unë s'do të ngrihesha i pari për t'u zotuar solemnisht para kolektivit se e merrja përsipër rimontin e turbinës! E dija që kolektivi besonte tek unë, po tani ishte puna që të besoja unë vetë në veten time. Këtë besim mund të ma jepte vetëm kolektivi nëpërmjet rrugës që këshillonte Alekua. Tani, për këtë gjë isha i bindur. Vetëm si të ishte diskutuar problemi i turbinës në detaj, ahëre mund të shikoja qartë në se nisiativa ime do të kishte rezultate të sigurta..

Ndërsa kaloja duke u përpëlitur nëpër avujt e tundimit të ndërgjegjes, dëgjova një zë që përmendi emrin tim (ndërkohë kishin folur dy-tre shokë, por unë s'dëgjova se ç'thanë):

— Usta Aliu ka zënë qoshen dhe s'po ndihet fare... Më duket se duhet të flasi edhe ai, pastaj vjen radha jonë, e çirakëve!

Në sallë plasi të qeshurit.

Unë fola pa luajtur nga vendi:

— S'kam ç'të them!...

— Si s'ke ç'të thuash?! — pyeti drejtori me habi dhe i pakënaqur.

— Nuk mund të them gjë tani! — u përgjegja unë dhe ndjeva gjakun që më hypi në kokë.

— Me lejë, kam unë dy fjalë për të thënë...

Ktheva kokën andej. Kristua ish ngritur dhe po shikonte nga tavolina, duke pritur që të mbaronte drejtori, i cili ish kthyer nga Alekua dhe diç i pëshpëriste në vesh.

— Shoku inxhenjer e shtroi problemin shumë drejt, — vazhdoi Kristua, — bëj autokritikë para gjithë kolektivit se, ndërmjet atyre që e kanë shikuar me mosbesim këtë mbledhje, isha edhe unë. T'ju them të drejtën, tërë këto ditë në brigadën time është menduar e folur vetëm për turbinën e parë. Si përfundim, ne zotohemi këtu përpara jush se e marrim përsipër rimontin e turbinës. Prandaj i bëjmë thirrje brigadës së Aliut që t'i përgjigjet nisiativës sonë!...

Mua nuk m'u durua, e pyeta para se të ulej:

— Përse na bën thirrje, o shoku Kristo, të vihemi në garë për tërheqje litari?!

— Shoku Ali Medini! — foli Kristua i nevrikosur më tepër kur pa njerëzit që po qeshnin. — Këtu jemi në mbledhje të kolektivit, s'është vend për të bërë shaka! Organizata e Partisë na shtron përpara një detyrë të madhe. Nën këtë frymë

brigada ime zotohet... Përse mundohesh t'u presësh nisiativën të tjerëve?

— Jo, mor vëlla, s'ta pret njeri nisiativën, qejf të kesh! — thashë unë. — Po na sqaro: përse na bën thirrje? Që ta marrim ne përsipër rimontin e turbinës së parë?... Kjo s'ka kuptim, ti u zotove se e merr përsipër me brigadën tënde, për hair qoftë! Apo jo?

— Po! — u përgjegj Kristua i vendosur.

— A, kështu thuaj!... E mirë, dëgjo: më duket se po nxitohesh!..

Ky muhabet do të kish vazhduar gjatë, sikur të mos kish ndërhyrë Alekua.

Ai tha:

— Të dy ju, shokë, po nguteni!... Usta Aliu e merr muhabetin pak me të përpjekur, po ashtu edhe Kristua. Është kollaj të marrësh një zotim, po është vështirë ta zbatosh. Për rastin konkret, problemi është i jashtëzakonshëm. Prandaj, shokë, kur flasim, nuk duhet të udhëhiqemi nga entuziazmi bosh ose nga sedra e sëmurë. Për mendimin tim, unë nuk do të isha dakord që rimontin ta merrte Kristua. Të jemi realistë, shokë. Kristua është punëtor, specialist i mirë, por është akoma i ri në profesion, nuk ka eksperiencën e nevojshme për të bërë rimontin kapital të një turbine me avull. Ky është mendimi im, shokë, mund të jem i gabuar, nuk e di se ç'mund të thoni ju!..

Një murmurim zërash shpërtheu në sallën që filloi të gumëzhinte si ndonjë koshere bletësh që e trazojnë.

— Pastaj, shokë... — tha Alekua duke e ngritur zërin, por s'e lanë të vazhdonte.

— Me leje! — u hodh që nga fundi i sallës një punëtor i rimontit. — Kam një pyetje: a e ka çmontuar ndonjëherë me duart e tija rregullatorin e shpejtësisë shoku Kristo?...

— Po disqet...? — pyeti një tjetër.

— Mbani qetësi, shokë! — ndërhyri kryetari i komitetit profesional.

— Më fal, shoku kryetar, me leje! — ky ishte një punëtor i vjetër i rimontit, i cili priti pak sa ra salla në heshtje, pastaj tha: — Unë jam në një mendje me shokun Aleko. Kaq kisha... — dhe u ul.

— Pastaj, shokë, — vazhdoi Alekua që kish ngelur në këmbë — puna kryesore nuk është se kush do ta marrë përsipër rimontin. Më parë duhet që ta studjojmë turbinën detal më detal, pastaj, caktimi i njerëzve është puna më e lehtë, apo jo?

— Ashtu është! — tha një punëtor i çfrytëzimit.

— Mirë e ka inxhenjeri, shokë! — ja priti një tjetër.

Alekua hodhi një vështrim nga Kristua, pastaj nga unë dhe u ul pa u thënë gjë shokëve që kish përkrah.

Diskutimi u fut në një rrugë tjetër: ku mund të dilnin vështirësi gjatë rimontit të turbinës e se si duheshin kapërcyer ato. Folën shumë shokë të rimontit e të çfrytëzimit. U dhanë mendime me të vërtetë interesante, që nxisnin fantazinë e seicilit. Sa vinte, problemi po dilte më i qartë, më i studjuar. Vija re se shumë gjëra që po thuheshin aty, as që i kisha menduar. U ngrita dhe unë e thashë mendimin tim, po nuk mora zotim. Pas pak

më vjen një pusullë e shkruar nga drejtori: «Je dakord që Alekua me brigadën tënde të filloni që nesër?». Iu përgjigja: «Të pyes shokët e brigadës».

Drejtori u ngrit:

— Ja, i pyes unë. Si mendoni ju, shokë të brigadës së Aliut? A do t'i japim fund këtij muhabeti? Bashkë me inxhenjer Alekon ta merrni përsipër rimontin e turbinës, ç'thoni?

— Po të jetë dakord ustai, ne jemi me të dy duart — tha Jorgo Bellani.

Unë u ngrita, shikova Alekon. Ai më tundi kokën në shenjë inkurajimi.

— Mirë! — thashë dhe u ula pa ceremoni. Isha i qetë. Llogjika e ftohtë më tha se u përgjigja drejt. Unë e kisha rifituar besimin në vetvete.

Pas kësaj, mbledhja u mbyll, por jehona e saj vazhdoi gjithë kohën e rimontit të turbinës.

Të nesërmen këshilli teknik i ndërmarjes aprovoi propozimin e mbledhjes së kolektivit për rimontin e turbinës së parë. Aty u vendos që brigada e Kristo Zotos të punonte në ndihmë të brigadës sime.

6

Që nga dita që filluam zmontimin e turbinës, unë shkoja në punë gjysëm ore më parë se të vinin punëtorët e rimontit. Ndjeja një kënaqësi të paspjegueshme tek vështroja pjesët e turbinës të shpërndara grumbuj-grumbuj rreth korpusit kryesor. I prekja një nga një me dorë, i ledhatoja si të ishin qenie me shpirt, bisedoja me to dhe mendja më shkonte tek dita kur pjesët e turbinës, të

rimontuara, do të punonin si sahat. Pastaj shkoja në tavolinën ku kisha vendosur rregullatorin e shpejtësisë. Ulesha në karrigen e nxirë nga vajrat, mbështesja bërrylat në tavolinë dhe rrëshqisja vështrimin nga njeri detal i rregullatorit në tjetrin. Këtij ia kisha frikën se mos më hapte avaze, prandaj s'lija njeri tjetër që ta prekte.

Kur vinin punëtorët e rimontit, unë e kisha bërë planin ditor të punimeve, me mend, jo në letër. Këshillohesha me inxhenjerin, caktoja punën për çdo punëtor, pastaj merresha me rregullatorin e shpejtësisë.

Në një nga këto ditë—aty nga fillimi i rimontit të turbinës — Jorgo Bellani erdhi në punë më herët se zakonisht. Unë sapo kisha mbërritur. S'më la të bëja xhiron e përditshme rreth turbinës. E pashë që ishte i mërzitur, prandaj s'ja prissha qejfin. Jorgua më tha se nuk e kuptonte përse duhej edhe brigada e Kristos, për derisa ne mund ta bënim vetë rimontin e turbinës.

— Që të mbarojmë punë më shpejt — i thashë unë.

— Më duket se është fjala për të mos i prisur qejfin atij.

— Jo, Jorgo, këtu po nxitohesh!

— Eh, Ali, sikur s'e njeh Kriston ti! Ai desh ta merrte vetë rimontin; kur e pa se s'i doli gjë, bëri ç'mos që të futej në kontraton e rimontit... E di ç'ka thënë ai për ty?

— Jo, s'di gjë!

— Vërtet?!... Unë pandehja se e dije dhe po më vinte çudi që pranove Kriston si ndihmës...

— Ç'ka thënë?

— Që ti e more përsipër rimontin e turbinës

për të fituar nam që të të dalë emri në gazetë dhe për 75.000 lekët, që janë vënë si shpërblim. Po t'i hiqnin këto, ti do të hiqje dorë nga rimonti!?!...

— O-u, Jorgo, përse mërzitesh dhe ti! Këto janë gjëra të zakonshme. Lëre atë të grijë salla-të! Shiko punën aty!

— Ti nuk më beson mua, Ali! — Jorgua u mat të largohej. Unë s'e lashë.

— Dëgjo, Jorgo! Mos ua verë veshin fjalëve që thuhet prapa kurrizit! Puna është që rimonti të dalë me sukses. Kjo është kryesore, fjalët i merr era!... Pastaj Kristos i ka ndezur me mua. prandaj lëshon dhe ndonjë fjalë qesim...

— Pse? — pyeti Jorgua ftohtë, në një mënyrë të atillë, sikur ta dinte përgjigjen që do të merrte.

— Kristua ka kërkuar Zanën, por unë s'e kam dhënë pëlqimin! — I thashë këto fjalë duke e shikuar Jorgon në dritën e syrit. Vura re se ai u zverdh në fytyrë dhe aty për aty mori një gëhre të kuqe. Sytë iu ndezën nga një flakë e brendëshme, një flakë ndjenjash të thella e të dallisura. S'e kuptova tronditjen e tij. Ai s'foli. Unë e pyeta:

— Si mendon?

— Për çfarë?

— Për Zanën...

— Nuk di ç'të them!...

— Nuk të kuptoj?

— Ti e ndërrovetë muhabetin, Ali. Të pyeta për turbinën, ti më hodhe te Zana!

— Prapë s'të kuptoj!...

— Ta sqaroj unë.

— Pa hë!...

— Ose të hiqet brigada e Kristos nga rimonti i turbinës, ose ai të kërkojë falje para teje për gëpifjet e ulta!...!

— As njëra, as tjetra s'besoj të bëhet!

— Ahere të hiqet shpërblimi nga kontrata!

— Këtë mund ta shikojmë. Unë jam dakord. Pyet dhe shokët e brigadës. Tani për Zanën?...

— Unë atë e dashuroj! — këto fjalë Jorgua i tha pa lëvizur asnjë dell të fytyrës.

— Megjithëmend!... S'e prisja këtë gjë!

Jorgua u zverdh në fytyrë. Pështyma iu tha. Tani fliste me zor, i merrej goja.

— Ali... S'ta kam pasur me hile!...

— Jo, more Jorgo, s'ta thashë në këtë kuptim. Mua s'më ka shkuar nëpër mend se ti e doje Zanën! Të ma kishe thënë, o derëzi!

— Më vinte zor... më dukej sikur do të bëja një poshtërsi.

— Përse?

— Më dukej se shfrytëzoja rastin që të njihja ty, vija në shtëpi si mik, kurse nga ana tjetër të rrëmbeja motrën! S'ishte punë ajo!...

— Qenke budalla, mor i vrarë! Po të vinte zor të ma thoje vetë, vije një tjetër!... Hajde, Jorgo Bellani, hajde! Këtë gjë s'ma priste mendja!

— Jo, jo, s'mund të veproja!

— Po Zana di gjë për ty?

— S'i kam dhënë rast... Ndofta e ka kuptuar!

— Ikë tutje me gjithë dashuriçkat platoni-ke!... Mos na hap avaze.

— E di, Ali Medini, se më vjen mirë që ndodhi kështu? Për mua është më e rëndësishme miqësia jote se dashuria për Zanën!

— S'të marr vesh?! Ç'të keqe do të kishte sikur ti të bëheshe kunati im?! Kjo do ta prishte miqësinë tonë?

— Do t'i jepte një karakter tjetër miqësisë sonë. Unë dua që në këtë miqësi të mos ketë asnjë fie interesil...

— Mirë, mirë, Jorgo Bellani! Tani më lerë vetëm, se ma bëre mendjen çorbë!

Para se Jorgua të shkonte në punën e tij, më vështroi me një buzëqeshje të hidhur si të deshte të më kërkonte falje. Më erdhi keq për të; më erdhi keq për veten, për Zanën. Unë s'e kisha njohur Jorgon ashtu si duhej. Ai kishte zemër të madhe, zemër të thjeshtë punëtori, por të madhe. Prandaj (më vjen mirë të them kështu) nuk e kisha njohur e kuptuar Jorgon. Është vështirë ta njohësh shpejt njeriun me zemër të madhe!... Unë nuk njihja ashtu si duhej as Zanës, motrën time. E kisha në shtëpi, por jetoja larg saj, larg halleve të saj. Njihja më mirë Kristo Zoton, se njihja në themel veset e tij. Ja se ç'ndodh: shpesh herë ne i njohim më mirë njerëzit nëpërmjet veseve të tyre! Kjo për detyrë që të njihja virtytet e Kristos, të kunatit tim të ardhshëm. Bëra një plan të këtillë: ta thërrisja Kriston, ta pyesja në se ai pranonte ndershmërisht që kish çpifur kundër meje. Ashtu veprova. E thirra Kriston po atë ditë në zyrën e Alekos. Ishim vetëm. Aty më ra ndërmend që t'i vija kushtin se nga singeriteti në përgjigjen e tij, do të varesh pëlqimi im për t'i dhënë Zanën. E peshova një hop këtë çeshtje dhe hoqa dorë, m'u duk pa vend... Pyetjen ja bëra papritmas. Kristos iu skuqën faqet, uli kokën. E pashë me vë-

mendje: kish fytyrë simpatike, prandaj prisja nga ai përgjigje të sinqertë. Nuk u gabova. Kristua e pranoi që kish çpifur kundër meje dhe nuk pati kurajë të justifikohet. Më gëzoi qëndrimi i tij. I thashë se mund të largohet me kaq. Kristua u bind, si të ishte para të jatit. Unë mendova: ky njeri është i sinqertë në disa momente të caktuara. I tillë duhet të jetë në dashuri me Zanën; kurse në punë i zë sytë ambicja, egoizmi. Megjithatë Kristua ka virtyte, mund të vihet në binarë, është i ndreqshëm... Ky konkluzion nuk më mjaftoi që t'i jepja pëlqimin motrës për Kriston. Ata vendosën vetë më në fund. Për hair qoftë!... Mirëpo kjo ngatërresë nuk m'u hoq nga këmbët edhe pasi u bë fejesa e Zanës me Kriston. Ky bëri lutje për të hyrë në parti. Në mbledhjen e organizatës unë u ngrita e thashë se s'isha dakord me propozimin e byrosë për ta pranuar Kristo Zoton si kandidat partie, duke nxjerrë shkaqet që kam thënë më sipër. Qëndrimi im habiti shumicën e komunistëve, përmbysi situatën. Unë ngula këmbë në timen dhe, së fundi, organizata më mbështeti. Disa shokë më thanë se s'veprova mirë, bile më quajtën «njeri të paarësyeshëm, të pakuptueshëm»! Kjo gjë s'kish bërë vaki ndonjëherë ose ne s'mbanim mend një rast të këtillë në organizatën tonë. Unë habitësja me qëndrimin e atyre, që u habitën nga qëndrimi im për çeshtjen e Kristo Zotos. Unë mendoja se veprova drejt.

Kunati më mbajti mëri një kohë të gjatë. Mua aq më bënte, vazhdoja punën time. Me kohë vura re se ai po ndryshonte, ngadalë vërtet, por po bënte kthesë. Iu thye hunda që e mbante për-pjetë. Në këtë mes s'kish patur faj vetëm ai, por

edhe drejtori, që e kish përkëdhelur pak si tepër. Kjo gjë doli në mbledhjen e organizatës... Tani Kristua filloi të merret më shumë me problemet e punës se sa me llafet poshtë e përpjetë. Prapsepapë unë s'e hoqa nga shënjestra. Për më tepër, tani që Kristua u bë njeri i shtëpisë sime, unë tregohesha më i rreptë me të. Mbase në ndonjë rast i bëhesha havale kot, por s'kisha ç'të bëja, vetë u fut në rrethin tim familjar, pra, duhet të duronte dhe huqet e mia.

Kështu u mpleksën punët me Kristo Zoton. Ndërsa me Jorgo Bellanin marrëdhëniet tona hyjnë në një rrugë të re. Ai mundohej të ishte sa më korrekt me mua në punë dhe jashtë punës, sikur kërkonte të shlyente ndonjë faj. Kjo gjë s'më pëlqeu. Më dukej se ai po ftohej me mua. Më dhi mbte zemra tek e shikoja që punonte pa pushuar, si ndonjë kalë. Shpesh merrej me punë që s'i takonin. Jorgua sikur desh të harronte dëshpërimin për Zanën, kur punonte në atë mënyrë. Mbase më dukej mua kështu?!... Isha matur disa herë ta pyesja, por nuk guxoja. M'u duk me vend që ta lija rehat në punën e tij, mos t'ja ngacmoja plagën. Mirëpo Jorgua më ngacmoi i pari. Një ditë, kur po dilnim nga puna, më tha të ktheheshim në bufe për të hedhur nga një gotë.

— Vemi nga shtëpia ime? — i propozova unë.

— Jo, aty nuk vij, Ali!... Unë bëra gabim kur të fola për Zanën, të hapa avazet. Po ti mos mendo se të jam larguar!...

— Ç'ne, aspak! — thashë unë duke u mundur t'i buzëqeshja,

— Ashtu?! — pyeti ai me dyshim.

Unë u ndodha ngushtë. E shikova Jorgon në

sy, i buzëqesha, këtë radhë me gjithë zemër. I thashë:

— Po, Jorgo, më duket se ti je ftohur me mua!...

Ai pa nëpër xhepat e tij, pastaj më kërkoi një cigare. Tek po e ndizte me cigaren time, vura re që i dridhej dora. Mua m'u drodh zemra... Kishim qëndruar në mes të rrugës. Një veturë sa s'na fshiku duke kaluar me shpejtësi. Ne s'e kishim dëgjuar borinë, s'e vumë re veturën, s'vinim re asgjë rrotull nesh. Ishim të hutuar nga biseda, mbase nga lodhja. Unë pata mendjen e zura nga krahu Jorgon e kaluam në trotuar. E pyeta:

— A shkojmë në shtëpi?

— Shkojmë! — tha ai.

M'u bë qejfi. Edhe nëna u gëzua kur pa Jorgon. Kish kohë që ai s'ishte dukur në shtëpinë tonë. Gruaja u bë copë sa na rregulloi pak raki e meze të mirë. Unë u nxitova të ngrija gotën e parë. Jorgua s'më la.

— Prit, Ali!... T'i themi që në fillim fjalët e hidhura!...

— S'kemi ç'të themi, unë të kuptova pa hapur gojën!

Vërtet: kam vënë re se kur marrëdhëniet midis dy shokëve janë me të vërtetë të singerta, ata merren vesh më mirë me gjeste e vështrime se sa me fjalë. Kështu po më ndodhte me Jorgon. Për miqësinë tonë ne flisnim pak, rrallë. Thonim ato fjalë që ishin të nevojshme për të pasqyruar ndonjë moskuptim, ose mosmarrëveshje.

Jorgua nuk nguli këmbë për të thënë «fjalët e hidhura». Çoku gotën me timen dhe e ktheu menjëherë. Atë natë unë piva vetëm dy gota, dhe u de-

ha me dy gota, u deha nga gëzimi që dyshimet e mia për miqësinë me Jorgo Bellanin nuk dolën. Ndërsa kur u fejua Zana, piva shumë, më tepër nga marazi për Jorgon, por s'u deha...

Nejse, kalojmë më tutje!...

7

Kështu, or shok, i dashur, kaluan këto ditë gjithë telashe, gati dy muaj punë intensive. Rimontin e turbinës e mbaruam. Para një jave filluan provat. Në boshllëk turbina punon mirë. Sa e vëmë në ngarkesë, bie rregullatori i shpejtësisë. E kontrolloam disa herë, studjuam me kujdes çdo pjesë të turbinës, por defektin s'e kemi gjetur ende. E zbërtheva dy herë me radhë rregullatorin, po s'gjeta asnjë shenjë defekti aty. M'u mbush mendja se ai është në rregull. Edhe inxhenjer Alekua i këtij mendimi është. Po ku është defekti, hajde ta gjesh defektin në këtë maqinë që ka me mijëra kleçka! Çdo ditë që kalon, defekti po bëhet si një mister, që u lëkund besimin njerëzve. Megjithatë, unë kam vënë re se shokët besojnë akoma tek unë, bile edhe drejtori. Ai e shtyu afa-tin e dorëzimit të turbinës deri të hënën. Më nge-lën akoma dhe tri ditë. Do të bëj çmos që ta gjej këtë qerrata defekt. Tani e kam lokalizuar në dy zona, po s'kam gjetur asnjë shenjë shpresëdhënë-se. Sa herë që bie rregullatori i shpejtësisë, e shoh se shokët dëshpërohen, po s'më thonë asnjë fjalë, asnjë vështrim qortues, më lënë të qetë në men-dimet e mia. Ata këshillohen me njeri tjetrin, pastaj vijnë e më thonë ndonjë mendim. Inxhenjer

Alekos i zjen koka, vjen rrotull turbinës, shkon para skicave dhe aty e kupton se ka të bëjë me një problem të thjeshtë praktik. Menjëherë ai drejtohet nga unë dhe fillon të më pyesë për këtë e për atë. Jorgua më ka qëndruar gjithë këto ditë më afër se zakonisht, jo për të më dhënë zemër, po që të ndjekë me vemendje çdo veprim timin dhe të ndërhyjë ahëre kur më shpëton ndonjë gjë nga sytë.

Unë e ndjej përgjegjësinë e madhe që rëndon mbi shpatullat tona, po gjer tani s'e kam provuar akoma frikën e dështimit. Jam i qetë dhe i sigurt për suksesin. Nuk kam parandjenja, kam besim. Defekti ndodhet në turbinë, prandaj do ta zbulojmë. Mua më ha merakun nëse do të mundemi ta dorëzojmë turbinën në afatin e kërkuar. Ja, ky është shkaku i shqetësimit tim...

Tani le t'i japim fund kësaj bisede, se të mbajta gjatë. Të mërzita ca, po s'ke ç'bën!... Si thua? Të vazhdoj?... S'kam ç'të them tjetër. Po deshe ti, takohemi ndonjë ditë tjetër, pasi të jetë vënë në punë turbina... Dakord?... Hajt, për hair qoftë!

8

U takuam përsëri, ma bëre qejfin. Bëre mirë që erdhe në termo-centralin tonë, t'i shikosh me sytë e tu maqineritë dhe njerëzit, për të cilët të kam folur. Hajde ngjitemi në sallën e turbinave... Qëndrojmë këtu, në hyrje. Hidh një vështrim në

këtë sallë të madhe e të ndriçuar. Ja turbina e parë, më tutje e dyta. . . A e provon dot dhe ti gëzimin që ndjejmë ne, punëtorët, kur shikojmë maqineritë që punojnë si sahat? Kjo është poezia jonë! . . . Hë, se harrova të të thoja! . . . Ti je shkrimtar. . . Mos të të vijë çudi: edhe unë desha të bëhesha poet, kur isha i ri. Lexova shumë libra, po s'më doli gjë. U bëra mekanik. S'më vjen keq. . . Nejse, të kujtohet se ku e lamë muhabetin? . . . E . . . Rimë këtu në sallë. Ka zhurmë, po s'prish punë. Zhurma e turbinave më ndihmon që të flas më lirisht, të shprehem më mirë. Unë jam mësuar me këtë zhurmë, s'mund të jetoj pa të.

Pra, unë kisha dhe tri ditë afat për të bërë prova me turbinën. Se ç'do të bëhej pastaj, s'e kisha të qartë. Veçse, siç të thashë, unë s'e kisha ndjerë frikën e dështimit dhe s'e provova asnjëherë. . . Vinim rrotull turbinës nga dymbëdhjetë deri gjashtëmbëdhjetë orë në ditë. Pinim shumë cigare, për të ngrënë hanim kur na vinte terezia. Ne i kishim përqëndruar të gjitha forcat e mendjes e të shpirtit në sallën e turbinave. Ishim izoluar nga familja, shoqëria, nga jeta jashtë mureve të termo-centralit. Kështu, kur një ditë erdhi Zana dyllë e verdhë në fytyrë e më tha se Drita ishte keq, unë iu përgjegja:

— Çojeni në maternitet! Ç'prisni nga unë! . . .

Motra u largua e hutuar. I thirra:

— Zana, këto punë i di nëna; bëni ç't'ju thotë ajo!

Pas nja pesë-gjashtë orësh Zana erdhi përsëri, këtë radhë e qeshur, por pak e ndrojtur.

— Hë?! — i thashë unë.

— Prapë vajzë! — u përgjegj ajo dhe po më shikonte në dritë të syrit me keqardhje.

— Të na rrojë, motër!..

Zana m'u hodh në qafë nga gëzimi.

Shokët u mblodhën rrotull nesh dhe filluan të më uronin. Filluan me radhë: nga drejtori, Alekua e sipas rangut e moshës. Salla e turbinave u kthye në dhomë pritje. Unë nxorra paqetën. Aty kishin ngelur vetëm dy cigare, kurse ishin më shumë se dhjetë shokë që e pinin. Me se t'i qerasja?!.. Zana më ngacmoi nga prapa. Ktheva kokën. Ajo më dha një pako me llokume.

— Më të lumtë, moj motër! Sa mirë të ka shkuar ndërmend! Të ka vëllai çapajeve, po i ngjan nënës!.. Hë, shokë, merrni nga një llokume, de, se më vonë do ta lagim!

— Të të rrojë, Ali!

— T'u bëftë njëqind vjet!

Shokët uronin e këpusnin ndonjë shaka, duke u përtypur:

— Aliu është i gëzuar!

— Pse mos të jetë!?

— Sikur priste një çikë djalë këtë radhë?

— Sot njësoj është si djalë, si gocë!

— E, e, ai gëzohet që i shpëtoi gruaja!

— O Ali, t'u bënë katër vajza, apo jo?

— Po...

— Të të kenë ymër, or vëlla!.. Ky është kismetimi im që kam një batalion me çuna — tha xha Hasani duke u kthyer nga shokët; pastaj m'u drejtua përsëri: — mirë, Ali, po e ke plan të vazhdosësh kërkimet derisa të nxjerrësh një djalë?

Të gjithë qeshën në një kohë.

Unë u përgjegja:

— Shko pyet gruan, në ta mban!

Pas kësaj shakaje secili shkoi në vendin e tij. Po bëhej vonë. Jashtë po errësohej. Gjithë ditën punuam për ta përgatitur turbinën për një provë të re, e cila na doli pa sukses. Ahere u larguam nga puna.

Me gjithë hallet që kisha, të shtunën në mbrëmje shkova në dasmë tek Jorgua. Erdhi dhe Kristua. Zana nuk erdhi. Jorgos ju bë qejfi shumë, s'dinte se ku të më vinte... E kaluam mirë.

Të nesërmen, aty nga ora pesë mbasdreke, e vumë përsëri turbinën në provë. Akoma s'i kishim dhënë ngarkesë, kur u dha Jorgua në sallë me kostum të ri si për dasmë.

— Po ti ç'kërkon?! — i thashë unë.

— Erdha... Ç'të bëja në shtëpi? Aty është rrëmujë tani; e nxorra motrën...

Jorgua xhveshi xhaketën, mori tubin e dëgji- mit e shkoi te reduktori i shpejtësisë... I dhamë ngarkesë turbinës. Pas disa sekondash ra rregullatori. Jorgua më thirri. Ay dyshonte se kish dëgjuar një zhurmë shumë të lehtë, jo të zakonshme në reduktor. Qëndrova dhe unë aty. I dhamë përsëri ngarkesë turbinës, por s'dëgjuam gjë këtë radhë, as unë as Jorgua. Megjithatë shënova dhe një kryq tjetër në skicë. Kështu, vendi i defektit po shpërndahej përsëri. Kjo gjë më shqetësonte. Prandaj, duke u këshilluar me inxhenjer Alekon, i dhamë karar që të caktonim dy zona të defektit. Filluam nga e para me provat. Vazhduam kështu deri nga ora njëmbëdhjetë e natës. Së fundi i përqëndruam dyshimet tona tek reduktori i shpejtësisë. Për këtë s'ishim bindur të gjithë. Alekon me disa shokë i kish zënë meraku me regullatorin...! Në të

vërtetë, ata i kishin humbur shpresat, të paktën për atë natë. Dilnin kundër meje me qëllim që unë të mos kuptoja se ç'mendonin ata. Kjo gjë më nxiti më tepër që mos ta hiqja mendjen nga reduktori.

Shkova në shtëpi. Portën ma hapi nëna. Ajo s'kish fjetur, më priste mua. S'më tha asnjë fjalë. Kur rashë në shtrat, u kujtova që s'e kisha Dritën aty. Në mëngjes, para se të vija në punë, i shkova në maternitet. Drita ishte mirë me shëndet. Kaq më duhej për atë ditë.

Natën, në qetësinë e thellë dhe në boshllëkun që krijon errësira, fantazia e njeriut punon më lirisht, çdo gjë duket më e lehtë për t'u realizuar, më kollaj se ditën me zhurmë dhe shqetësime mendore... Gjumi s'më zuri. Mendoja për turbinën. Më kish zënë merakun me reduktorin e shpejtësisë. E analizova mirë këtë gjë dhe së fundi m'u mbush mendja që defekti ndodhej aty. U ngrita, u vesha shpejt e shpejt dhe shkova në shtëpinë e Jorgos. I thashë të thërriste shokët e brigadës. Vetë u nis në termo-central. Shokët e turnit u habitën kur më panë. Bëra muhabet me ta sa erdhën shokët e brigadës. U thashë që të fillonin menjëherë zmontimin e reduktorit të shpejtësisë...

Ne kishim filluar nga puna. Kishim hequr kapakët dhe vidhat e xhuntove të ingranazheve të boshtit të turbinës e të gjeneratorit. Në këto çaste mbërriti Kristua me tre shokë të brigadës së tij. Ai kish bërë rimontin e reduktorit dhe dyshonte se defekti ish aty. Pas pak arriti dhe Alekua. E kish zgjuar Kristua. Alekua kish dërguar njeri në shtëpinë time të më zgjonte, kurse nëna i kish thënë që unë isha nisur. Kristua kish gjetur një spesor

në xhepin e rrobave të punës. Mendoj se ishte spesor i ingranazheve të reduktorit, prandaj dyshoi se defekti mund të ishte aty, megjithëse s'ja hante mendja që për një spesor të ndodhte defekti. Unë e dëgjova me gjakftohtësi shpjegimin e Kristos dhe u binda përfundimisht se defekti ishte në reduktor.

I kontrolluam një nga një ingranazhet. Njeri nga ata kish mangut një spesor shumë të hollë. I montuam me kujdes, bëmë provat e nivelimit dhe me një dëshirë të papërmbajtur lëshuam avullin në turbinë. I dhamë rrotullimet e plota, e vumë në ngarkesë. Rregullatori i shpejtësisë nuk ra, turbina mbajti ngarkesën. Prandaj kaluam dalngadalë deri në ngarkesë të plotë. Turbina punonte si s'hat. Ahere u ula dhe vura re që aty kishin ardhur shumë njerëz dhe që ora kish vajtur dhjetë e mëngjesit. Ndeza një cigare bashkë me Alekon. Rreth nesh u mblodhën dhe shokë të tjerë, ulur nëpër stola, me sytë nga turbina. Fytyrat e tyre dukeshin të qeshura. Thashë me vete që dhe unë duhej të isha i gëzuar. Mirëpo me zor s'mund të gëzohesha. Në ato çaste e ndjeva që isha lodhur, që lodhja më kish mpirë. Më vonë, me siguri, edhe unë do ta provoja gëzimin e suksesit. Tani për tani kisha nevojë të shplodhesha, të flija. U thashë shokëve të rimontit që të iknin. Unë do la bashkë me Alekon. U nisëm për në shtëpitë tona. Rrugës Alekua më tha që të ngjiteshim te kodra e depos së ujit.

— Jemi të lodhur, shkojmë flemë më mirë! — i thashë unë.

— Kam dëshirë, mos ma prish qejfin! Më hi pi në kokë!...

U ngjitëm. Ndalua po në atë lëndinë të vogël, ku kishim qëndruar dy muaj më parë dhe bënim plane për rimontin e turbinës. Unë u ula. Alekua qëndroi në këmbë. Pas pak më pyeti:

— Përse mendohesh?

— Për spesorin që u ndodh në xhepin e Kristos... S'besoj ta ketë harruar me qëllim?

— As që mos të të shkojë mendja! Gjë që ndodh! Edhe ti mund ta harroje.

— Megjithatë, ai duhet dënuar. Për faj të Kristos ne humbëm më tepër se një javë punë! Na hapi avaze kot së koti!

— Do ta kritikojmë, por ti mos u ngrit! Ti i dhe një grusht një herë. Po ta kritikosh përsëri, dhe ashtu siç e ke zakon ti, do ta dërmosh fare shpirtërisht. A më kupton? Është çeshtje takti. Ma lerë mua këtë punë. Kur të bëjmë analizën e rimontit, do ta ngre dhe këtë çeshtje. Këtu ka vetëm një pakujdesi, për këtë të jesh i bindur!

— Hë, në rimontin e turbinave, një pakujdesi e vogël mund të hedhë poshtë punën e dy muajve. Kjo gjë s'është kuptuar mirë nga disa shokë!... Nejse, ç'të bëjmë akoma, a zbresim?

Alekua s'foli; ai rrinte në këmbë, mendjen s'e kish tek unë.

— Ç'shikon ashtu? — e pyeta.

— Termo-centralin tonë! Çdo vit që shkon, ai nxihet më tepër!

Unë u ngrita, u vura përkrah Alekos. Hodha sytë andej nga vështronte ai dhe thashë:

— Dhe sa më tepër që nxihet, aq më i bukur bëhet, aq më madhështor duket! E zeza është provë e fuqisë së tij!... Oxhaqe të lartë dhe tymi i

zi — këto përbëjnë panoramën e një vendi të zhvilluar!...

— Kjo është bukuri industriale! — u hodh Alekua.

— Mirë e the! Sa mirë e the!

— Mund të thuhesh dhe më mirë...

— Të kuptoj!...

— Eh, Ali!..

— Ne jse, zbresim tani! Kënaqësia e jonë s'merr fund me kaq!

— Ashtu është!... Zbresim! — tha Alekua pa dëshirë. Ai desh të qëndronte akoma aty, ndërsa unë jo, më dukej pa kuptim.

Tek ndjeja këmbët që iknin vetë dhe mendoja për shtratin që më priste në shtëpi, thashë me vetë se tani isha i gëzuar. Nuk u mallëngjeva, s'kish kuptim të mallëngjehesha. Ky gëzim ishte i natyrshëm, ishte gëzim që buronte nga puna e dobishme, ishte shpërblimi më i madh si për mua ashtu dhe për shokët e mi.

Ne kishim të drejtë të gëzoheshim!...

DHE YJET U NDEZEN

Ajo ish kooperativa e parë e rrethit dhe s'ish e vogël. Pastaj, gjithë rrethi kish vetëm pesë të tilla. Dhe, po të mos shkonin punët mirë në ato, si do të bëhej për të ngritur të tjerat? Këto mendonte Sekretari i Komitetit të partisë dhe mendja i shkonte tek kodrat që kish Sadolishta. Ato zinin një sipërfaqe shumë të madhe dhe çpyllëzimi i tyre i hapte perspektivë kooperativistëve. Por... ç'thonin fshatarët? A do ishin ata të një mëndjeje? Apo do të dëshironin më mirë të punonin si punëtorë në tokat e fermës, që ishin një orë larg, se sa të merreshin me çpyllëzimin e kodrave të kooperativës së tyre?

Si përherë, sekretari kalonte pëllëmbën e dorës herë nën mjekër, herë për të shtrënguar buzën e poshtme dhe herë mbi ballë. Pastaj vështroi orën. Ishte tre e gjysmë e mbas ditës. Mbas pak zbriti poshtë dhe, si hypi në makinë, i tha shoferit:

— Në Sadolishtë. Sa më shpejt.

Maqina u nis. Kish filluar një shi i imtë dhe udhët gropa-gropa të qytetit ishin lagur. Makina hidhej sa andej-këndej dhe dukej sikur kalonte në ndonjë udhë fronti. Në të dalë të qytetit shikoje

akoma shtëpi të rrënuara dhe tek-tuk maqina kalonte mbi ndonjë urë gjysmë të asfaltuar dhe gjysmë me dërrasa. Por, këto, sidoqë kishin rëndësinë e tyre dhe duheshin rregulluar, prapë-prapë nuk e mundonin sekretarin. Ai i shikonte dhe thosh me vete: «Do t'u vijë sëra dhe juve. Kini durim».

Si la mënjanë qytetin, maqina doli në një pllajë nga ku Sadolishta dukej si të ish në fund të këmbëve. Sa herë pati shkuar aty sekretari. Në kohën e luftës ai e kish patur si bazë këtë fshat, shtëpitë e të cilit vinin në formë gjysëm hënëze larg njera tjetrës, si të ishin projektuar nga një arkitekt me shije dhe që ndonjë romantiku do t'i dukeshin si një vetull bukurosheje. Më pas kish shkuar të bisedonte me ta për kooperativën. Dhe sa herë të tjera kish shkuar. Ja, tani ai po shkonte për të zgjidhur një tjetër problem, ndofta edhe më të rëndësishëm.

Akoma vazhdonte të binte shi. Toka dukej sikur djersiste sepse një avull ngrihej përpjetë dhe formonte një mjegull të bardhë si ndonjë dantellë pa çipa. Makina hidhej përpjetë simbas relievit të udhës ku kalonte dhe të dukej sikur tokën e kish zënë lemza.

Kur mbërriti në Sadolishtë, sekretarin e prishte gjithë fshati. Fshatarët ishin grumbulluar në barangën e gjatë, ku ishin zyrat e kryesisë dhe hiqnin valle. Lodrat kërcisnin dhe ato dëgjoheshin që atje lart, në pllajë, nga ku Sadolishta dukej si një vetull bukurosheje.

I pari, që i shtrëngoi dorën Sekretarit ish Kryetari i kooperativës, Pertefi, një burrë me trup të gjatë, veshur me një xhakëtë ushtarake.

Pastaj u qasën të gjithë; edhe xha Likua, në gjoksin e të cilit llamburiste medalja e trimërisë. Sa herë që vinte sekretari, xha Likua harronte që ai s'e pinte cigaren, andaj i zgjaste kutinë e duhanit dhe i thosh:

— Besoj se do të kemi kohë të mëlloisim ca për ato vitet e luftës, se këta (dhe tregonte me dorë të rinjtë) pandehin se gjermani iku nga vendi ynë nga që u mërzit.

Kur fliste kështu xha Likua, të gjithë shkuleshin së qeshuri. Ndërsa moshatarët e tij thonin.

Edhe kur ish i ri s'i linte këto ky.

Të qeshurat vazhdonin si edhe daullja që kërciste.

Kur zunë vend në krye të sallës, Sekretari e pyeti Pertefin:

— Si shkoi mbledhja e kryesisë?

— Jo mirë, shoku Sadik. I pari që e kundërshtoi çpyllzimin e kënetave ish xha Likua. «Ku do të kullosi bagëtia; apo në barangën e kryesisë» — thosh ai.

Sekretari vuri buzën në gaz e tha:

— Nuk keni ditur t'ja shpjegoni. Xha Likua është një njeri i ndershëm dhe e do kooperativën. Për këtë edhe ju jeni të bindur; shoku Pertef, por ai, shumë gjëra nuk i kupton. Por të tjerët ç'thona?

— Të them të drejtën, shoku sekretar të pak-të janë ata që e përkrahin — tha kryetar Pertefi dhe ndezi një cigare; ndërsa sekretari shkoi pëllëmbën e dorës në mjekër dhe me dy gishta filloi të shtrëngonte buzën e poshtme. Ai ra në mendime dhe e kuptoi që punët nuk do të shkonin mbroth.

Për një hop u vendos një heshtje, kaq sa nuk dëgjohej asgjë veç pikave të shiut, që trokisnin në xhamet e barangës si ca qukapikë. Jashtë, tanimë ishte hedhur velenca e zezë e natës. Sekretari kalonte pëllëmbën e dorës mbi mjekër dhe me sa dukej mendjen e kish atje, në lëmin e fermës. A do të kishin mundur ta futin të gjithë misrin brenda? «Ja përse duhet telefoni» — mendoi ai.

— Po ngruhu o Pertef, ç'pret më? Do të na thuash gjë apo jo? — ish zëri si i ngjirur i xha Likos, që e shkëputi nga mendimet sekretarin, ndërsa kryetar Pertefin e bëri të mos presë më.

— Mirë thua, o xha Liko, — s'kemi ç'të presim më — tha kryetari i kooperativës dhe pastaj vazhdoi:

Shokë!

«Si sot një vit fshati ynë bashkoi krahët e punës, bashkoi...» Dhe kryetari vazhdoi të fliste për atë mot të shkuar dhe punën që ish bërë gjatë vitit. Ndërsa nga sytë e mendjes së sekretarit nuk shqiteshin kurrë ato ditë vjeshte. Shumë instruktorë të komitetit ishin kthyer nga Sadolishta me fjalët: «Ata nuk duan të kuptojnë se kooperativa është shpëtimi nga s'kamja e varëfria». Pastaj, ai kish shkuar vetë në Sadolishtë dhe ata e kishin pritur si përherë, ashtu siç pret nëna djalin kur i kthehet nga lufta. Dhe sa shumë gjëra ka mësuar djali në luftë. Këtë e di nëna, prandaj e kupton se çdo fjalë, çdo mendim që thotë djali i i saj, është i drejtë.

Kryetari i kooperativës vazhdonte të fliste. Pastaj, ai shtroi çështjen e shpyllëzimit të kodrave. «Kooperativa jonë nuk e prodhon bukën e vitit vetë. E ku ta gjejmë ne atë nëqoftëse do të vazh-

dojmë t'i lemë kodrat me gëmusha?» kish thënë ai. Ndërsa në sallë filloi pëshpëritja. Xha Likua ngrysi vetullat dhe, si nxorri kutinë e duhanit, filloi të mbushë llullën me ato gishta të hollë e të rreshkur. Dukej qartë që kryetari po e lëndonte atje ku i dhimbte më shumë. Dhe, as ai vetë nuk po e kuptonte se si qëndronte aty, në ballë, pa lëvizur edhe kur kryetar Pertefi kish thënë se «Xha Likua nuk kish qenë dakord në mbledhjen e kryesisë». Prandaj, «këtë çeshtje ne po e shtrojmë sot përpara asamblesë» — përfundoi kryetari. «E, o Pertef! Ta paça borxh këtë që më bëre» — tha xha Likua me vete.

Atij i vinte turp, që këtë ja tha troç kryetari; dhe ku se, përpara gjithë fshatit, përpara Sekretarit të Partisë së rrethit, shokut të tij të luftës. «Ja, nga këto di ky, se mos di gjë tjetër. S'e ka për gjë, të marrë tjetrin nëpër gojë.» mendonte xha Likua për kryetarin e kooperativës.

Përyashta, shiu vazhdonte të binte më shumë se më parë dhe xhamet tani kërcisnin aq tepër sa që në veshët e xha Likos vinin e bëheshin si të trokiturat e dhjetra daulleve.

Sekretari e vështronte tinëzisht xha Likon.

— Ndize llullën, xha Liko — e prishi sekretari atë heshtje plumb të rëndë, që plakosi. Ndizeni dhe ju shokë, — iu drejtua ai të tjerëve, por akoma s'kish mbaruar fjalën, kur xha Likua ngrihti dorën e tha:

— Me leje?

— Urdhëro, xha Liko, — foli sekretari dhe vuri pak buzën në gaz.

— Do të them di fjalë unë, se po e vështroj që s'po më rrihet. Ne, ngjer tani jemi kavërdisur me

këtë tokë. Më përpara po, punonim si argatë në tokën tënë, por që nga dizet e katra e këtej jemi vetë të zot të kësaj toke. Njëditëzaj në mbledhje të kryesisë kryetari tha që t'i prishëm meratë. Mirë, more xhan i vëllait, i prishëm, po bagëtia ku do të na kullosë? E ka sillavisur Pertefi këtë? Po parat ku do t'i gjëjë kooperativa për t'i çpyllosur kodrat? Ja, këto kisha unë për të thënë.

Kaq tha xha Likua dhe si u ul, nxorri nga xhepi i jelekut strallin dhe urorin për të ndezur llullën. Por, një i ri, që ish aty pranë, i afroi shkrepshen dhe ja ndezi llullën.

— Kush e do fjalën — tha Pertefi.

— Unë — tha një vajzë, që ish ulur nga fundi dhe bëri që të tjerët t'i kthejnë kokat mbrapa.

— Kjo është sekretarja e Rinisë së kooperativës nusja e të birit të xha Likos, — i tha Pertefi sekretarit. Është shumë e shkathët dhe e zonja.

Sekretari tundi kokën dhe e hodhi vështrimin thellë në fund të sallës.

— Unë — filloi të flasë Liria, — nuk jam dakord me ato që tha Xha Likua. Mendoj se shpreh edhe mendimin e organizatës për këtë. Çpyllëzimi i kodrave nuk do të thotë të prishim meratë e bagëtive, siç mendon xha Likua e ndonjë tjetër. Për bagëtinë unë mendoj se do të mjaftonin livadhet e vjetra dhe mbjellja e disa tokave me jonxhë e bimë të tjera foragjere. Po, kisha diçka tjetër për të thënë. Shumë anëtarë të kooperativës, bile edhe të rinj lënë punën e tyre, punën tonë të përbashkët dhe shkojnë në fermë, ku shpërblimi bëhet çdo dy javë. Kjo nuk është e drejtë, shokë. Nëqoftëse do të vepronim të gjithë kështu, atëhe-

re kush do të mbetej për të punuar në kooperativë?! Bile nuk do të kish asnjëri për të kullotur bagëtinë. Kjo, mendoj unë, shokë, është për t'u diskutuar dhe jo çpyllëzimi i kodrave. Se ai duket qartë që do të përmirësojë jetesën tonë.

Ajo ish bërë flakë e kuqe në fytyrë. Ndofta nga që iu desh të flasë hapur kundra vjehrrit të saj, por, sidoqë të ish, ajo e njihte mirë xha Likon. Ai çdo gjë që thosh, e thosh për të mirën e kooperativës. Po, ja që kështu e kuptonte ai, andaj ajo edhe nuk i zëmërohej atij.

Në sallë filluan diskutimet. Kish nga ata, që përkrahnin Lirinë dhe këta s'ishin vetëm të rinj, por kish edhe nga ata që s'tundeshin nga ato që tha xha Likua për të mos prishur meritën. Sa për forcat e punës që shkonin në fermë, ishin të gjithë të mendimit se kjo gjë nuk duhet të ndodhte më pas.

Përfundimisht vazhdonte të binte shi, por jo ashtu si më parë dhe kur u ngrit sekretari, në xhamat zhurma e shiut thua jse nuk dëgjohej fare.

— Të më falë xha Likua dhe ndonjë shok tjetër që po shpreh dhe unë mendimin tim të kundërt me ta, — kështu e filloi fjalën e tij sekretar, Sadiku.

Dhe më pas:

— Unë, xha Liko, nuk i harroj kurrë ato vitet e luftës. Nuk kanë kaluar shumë vjet, por edhe sikur të kalonin, unë nuk do t'i harroj kurrë. E si mund t'i harroj unë ato vite kur fshati juaj na priste e na përcillte ne, partizanët, me copën e bukës së misrit me shëllirë? Apo shokët që s'kishin fuqi të luftonin nga që s'kishin ngrënë?

Të gjithë dëgjonin. Xha Likua kish më të djathtë xha Shametin që vazhdonte të hiqte tym

nga llulla. Ai filloi të mallëngjehej dhe, nga që e shih se diç po e shtrëngonte fort në fyt, i thosh xha Shametit:

— Largoma atë dreq çibuku se më verboi sytë.

— Ishin vite të vështira ato — vazhdoi të fliste sekretari. — Armiqtë ishin të veshur, të mbathur dhe të ushqyer me të gjitha të mirat. Kurse ne? Kishim vetëm ato që kishit ju. E ç'kishit ju?! U hiqnit fëmijëve tuaj kafshatën për të mbajtur partizanët. Dhe kështu vazhduat disa vjet deri sa e përzumë fare armikun dhe tradhëtarët e vendit. Mirë thotë Xha Likua: «Duhet në të tëra dimri të molloisen ato vite të luftës». Por ju pse i bëtë të gjitha ato sakrifica? Sepse kishit besim tek ne, që dolëm nga radhët tuaja dhe që luftuam bashkë me ju; kishit besim tek Partia jonë. Këtë e treguat edhe para një viti, kur formuat kooperativën tuaj. Doemos, sepse Partia fjalën e ka mbajtur. Dhe tani, që është fjala për çpyllëzimin e kodrave, unë jam i sigurt se të gjithë ju keni besim tek Partia. Edhe xha Likua ka besim, por atij se si i duket të prishë meritat. Pse, pak livadhe ka kooperativa juaj?! Atëhere përse të mos çpyllëzohen kodrat për rreth?

Unë jam me atë që ngriti ajo nusja atje në fund. Duhet të mobilizohen të gjithë anëtarët e kooperativës për të punuar për kooperativën. Për sa na takon neve, do t'ju dërgojmë specialistë, traktorë dhe shteti do t'u japë kredi. Sido që të jetë, ju vetë dini t'i zgjidhni më mirë punët tuaja. Unë kam ardhur këtu tek ju si mik dhe, në mënyrë mua, unë do t'ju them se ajo nusja atje ka shumë të drejtë, — përfundoi fjalën e tij sekretari.

Përrjashta shiu kishte pushuar fare dhe qielit tanimë i ishin shtuar ca yje. Vjeshta është e guditshme: shiu, që derdh ajo, është si lotët e krokodilit.

Në sallë u ngritën shumë fshatarë që për-krahnin fjalët e sekretarit të Partisë. Nuk vonoi shumë dhe xha Likua kërkoi prapë leje.

— Epo, plaku ngandonjëherë bëhet si fëmijë, — tha ai. — Ç't'i bësh! Erdhi koha që të më ndreqi nusja. U bëra si sahat i prishur unë. Po u kam thënë këtyre unë, shoku Sadi; s'jam për kryesi unë. Pooo. Po i dëgjon koka atij që ke në krah ti — tha xha Likua dhe i tregoi sekretarit me gisht për kryetarin e kooperativës. Në këtë kohë të gjithë ja plasën gazit. Ishte një autokritikë nga ato që dinte të bënte vetëm xha Likua.

— Unë kam besim tek Partia dhe të bëhet ashtu siç thotë ajo. Po, le t'i lemë këto, o Pertef, për kokën tënde, se Sadiku s'ka ardhur të vrero-set këtu, — tha xha Likua.

Diskutuan të gjithë dhe u vendos të ktheeshin kodrat në tokë buke dhe për këtë të punonin të gjithë anëtarët.

Kur mbaroi mbledhja, xha Likua iu afrua sekretarit dhe harroi që ai s'e pinte cigaren, ndaj i qasi kutinë e duhanit duke i thënë:

— Hajde o Dike, të molloisim për ato vitet e luftës.

Sekretari ja mori kutinë dhe filloi dhe ai të pështillte një duhan nga kutia e xha Likos.

TRAU I FUNDIT I SOLETËS

Betonimi kishte filluar qysh në orën shtatë të mëngjesit dhe gjithë ditën vazhdoi pa ndërpreje. Dielli u qëndronte punëtorëve, si saç mbi kokë, aq sa ata nuk dalloheshin nëse ishin lagur nga të djersiturit, apo ishin futur në lumë, ashtu, me gjithë rroba. Zhurma monotone e transportierit të shurdhonte veshët. Por punëtorëve as që u bënte përshtypje kjo zhurmë, sepse ata ishin mësuar me të. Ashtu të lodhur, ca nga vapa ca nga puna e vështirë, ata e kishin përqëndruar vëmendjen vetëm tek betoni dhe e rrëmbenin lopatë mbas lopatë, duke e vendosur në shtresën e soletës.

Brigadieri Jaho Emiri ngjiste trarët e soletës me anë të vibratorit cilindër. Ajo soletë kishte pesë trarë të mëdhenj me thellësi një metër e gjerë si dyzet centimetra, të vendosur secili mbi katër kollona beton armeje, dhe njëmbëdhjetë trarë të vegjël tridhjetë me njëzet centimetra që kryqëzoheshin me trarët e mëdhenj. Duhej kujdes i madh në betonimin e këtyre trarëve, sepse mbi ta do të mbështetej gjithë pesha e soletës.

Kur u plotësua tetorëshi, brigadieri u tha punëtorëve se, kush ishte lodhur e s'mund të qëndronte më, mund ta linte punën. Asnjëri nuk u largua. Të gjithë, edhe pse ishin lodhur së tepërmi, qenë gati të qëndronin deri në fund. Deri në atë kohë (ishte ora tre e gjysëm) ishte betonuar pak më shumë se gjysma e soletës.

— Sa makina me beton kanë ardhur deri tani? — e pyeti tekniku brigadierin.

— Dymbëdhjetë. Pra sipas planifikimit do të na vijnë edhe njëmbëdhjetë. Çdo dyzetepesë minuta vjen një makinë; po që se na vijnë pa ndërprerje, i apim fund para orës dymbëdhjetë.

— Ki parasysh se njerëzit sa vjen e lodhen më shumë, vuri në dukje tekniku.

— Jemi mësuar edhe herë të tjera, prandaj do të vazhdojmë me të njejtin ritëm. Ti, nëqoftëse ke ndonjë punë ikë, se kujdesemi ne për cilësinë e betonit.

Teknikut i erdhën të rënda këto fjalë. Ju duk sikur brigadieri po i thosh: «Ti mos e hiq veten sikur të vjen keq për ne që jemi të lodhur; më mirë thuaje troç që përton të rrish vetë».

— E di unë që kujdesesh ti, se të kam parë dhe herë të tjera, — tha duke i varur vetullat poshtë, — po mos na shit mend dhe mos na jep mësim — shtoi mbas pak.

Brigadieri nuk e merrte dot me mend pse i tha tekniku këto fjalë. Nga kjo ai e harroi vibratorin, i cili duke qenë i lirë, u fut si zvaranik nëpër hekurat e traut.

— Fike, fike o Pilo! — i tha një punëtori që ndodhej pranë çelësit të vibratorit. Pilu e ktheu dorezën poshtë dhe zhurma pushoi në çast. Por

ndërkaq tekniku qe larguar. «Ç'njeri!» — i erdhi inat Jahos. «Ta le plumbin brënda dhe pastaj fësh ia bën e ikën si hije». E ndezi vibratorin dhe vazhdoi të punojë, por mendja i rrinte gjithmonë tek fjalët e teknikut. «Të kam parë dhe herë të tjera». Vibratori futej thellë, e shpërndante betonin me vrull dhe Jahos i dukej se po me aq rrëmbim e qëllonin fjalët e teknikut: «mos na jep mësim». E hoqi vibratorin nga ai vënd dhe e vendosi në një vend tjetër, por mendimi vërtitej po aty, pa lëvizur. «E ka fjalën për betonin e asaj kollonës që doli keq këtu e dy muaj më parë», i ra ndërmend. Jahua është nga ata që edhe kur u thua çfarëdo për veten e tyre nuk nxehen fare, por po u the një gjysëm fjale të keqe për punën që bëjnë, nuk u del nga mendja për një kohë të gjatë. «E mbaka mend, s'e paska harruar. Po pse ma tha tani, për të më mundur me fjalë? Po ka edhe të drejtë. Për ne ajo është njollë dhe gjersa ta shlyejmë, na duhet punë e madhe. Po me punë do ta shlyejmë». U mundua ta heqë mendimin prej saj, por ja që nuk i ndahej ajo kolona e betonuar dy muaj më parë.

Atë ditë, për të ngjeshur betonin në kollonat dhe për t'i rrahur me sqepar armaturat nga jashtë, Jahua kishte caktuar Liman Rukën. Limani qe treguar i vëmendshëm dhe i kujdesshëm, por aty nga fundi, si duket i qe mbaruar durimi dhe nuk e kishte ngjeshur sa duhej. Kështu kur u bë dizarmimi, kollonës që qe betonuar e fundit, i kishin mbetur nja dy hekura zbuluar. «Keq, keq», mendoj përsëri. «Po pësimi do të na bëhet mësim».

Aty rreth orës nëndë e gjysëm mbaroi betoni i makinës së njëzetë. Deri atëhere, sa mbaronte

njera, vinte tjetra, mirëpo asaj rradhe u vonua. Punëtorët u ulën të çlodhen, ata që e pinin duhanin, ndezën nga një cigare. Ndenjën ashtu nja dhjetë minuta, pastaj nga që ishin të djersitur filluan të mërdhijnë, sepse edhe moti ishte freskuar.

— More po na vjen të ftohtë, a lozim më mirë biz, tha njeri prej tyre. Ishte Haliti, një djalë gjithmonë shakaxhi dhe i gëzuar.

— Këtij i zien gjaku, do që të ngjishet me pëllëmbë, ja priti një tjetër.

— Rrini ore rehat, se jini të lodhur, ç'u duhet juve të lozni, kini edhe tri makina akoma, tha tekniku që atëhere sapo kishte hipur lart.

— Po të rimë shtrirë, pastaj kur të vijë betoni, duhet që të na vesh një motor me korent pa të na lëvizin krahët, foli përsëri Haliti. Hajdeni ore, ngrihuni! u tha shokëve.

U ngritën dy veta, pastaj edhe një tjetër. Lojën e filluan ata të katër, mbas pak në lojë hynë dhe të tjerë.

Teknikut i vinte çudi me këta njerëz që s'mund të rrinin asnjë minutë të qetë, donin ta përzinin lodhjen me gjallërinë e tyre të pashtershme. Bëri të largohej që aty, kur Haliti e zuri për krahu.

Teknikut i erdhi zor dhe po bënte naze, më në fund deshi s'deshi, e pranoi ftesën. I erdhi edhe atij radha të goditej nga të tjerët, por kjo nuk zgjati shumë sepse erdhi makina e betonit.

— Edhe më bëje naze — tha Haliti, mos u mënjano kurrë, se ashtu nuk mësohesh dot. Thuaj shqyr që erdhi makina e betonit se do të kishe mbetur brënda rrethit duke pritur pëllëmbët tona gjithë natën.

Halitit nuk i zemrohej asnjëri, sepse shakatë e

ngacmimet ai i kishte të tiat, prandaj edhe tekniku nuk iu zëmërua.

Me të ardhur betoni, loja u ndërpre menjëherë dhe filloi puna më me vrull. Gjithkund rrethëqark zotëronte errësira dhe heshtja, ndërsa në atë objekt të ndriçuar nga disa drita elektrike, ndjehej hovi i punës ndërtimore, vrulli i njerëzve, zhurma e transportierit dhe e vibratorit.

Tri makinat e fundit erdhën njera mbas tjetres dhe një pjesë e betonit që mbeti përfundi, qysh nga makina e parë (ndër këto të tria), e humbi aftësinë e duhur, prandaj për ta prurë përsëri në gjendjen e nevojshme, e përziën me një sasi çimentoje. Kjo punë ua shtoi më shumë lodhjen.

Kur mbeti afërsisht edhe një metër kub beton, brigadieri i tha teknikut se trau i fundit i soletës nuk do të plotësohej i gjithi, prandaj pjesën tjetër duhej ta pregatisnin vetë.

— Prit, të mbarojmë këtë që kemi një herë, pastaj shohim e bëjmë. Fundja e plotësojmë nesër atë pjesë të traut që do të mbetet.

— Po si u ndërpreka trau në këtë mënyrë, nuk ka rrezik që të shembet?

Teknikut i ra një hije e rëndë në fytyrë.

— Kush ka më shumë përgjegjësi për këtë, shoku brigadier, ti apo unë?

Jahua nuk i lëshoi rrugë kësaj radhe.

— Nuk na hyn shumë në punë përgjegjësia, shoku teknik. Veç kësaj, përgjegjësia është si ta ndjesh, por unë mendoj, që në radhë të parë është detyra. Pra detyrën e kemi të barabartë, si ti, unë dhe të gjithë shokët e tjerë. Përveç rrezikut të shembjes, po të mos përfundohet betonimi qysh sot,

brigada për nesër bllokohet sepse nuk mund të fillojmë muraturën e katit të dytë. Prandaj, do s'do ti, traun do ta betonojmë pa ndërprerje.

Ndërsa tekniku me brigadierin po vazhdonin të grindeshin, punëtorët po hidhnin lopatat e fundit të betonit. Trau ishte mbushur nja tridhjet e pesë centimetra, duke kaluar nga kolona e tretë.

— Atëhere në rregull — u tha tekniku punëtorëve duke mos ua vënë veshin fjalëve të brigadierit.

— Largësia ndërmmjet dy kolonave është dy metra, pjesa e tretë e traut është mbushur deri në sakomatë, pra në 1,6 e lartësisë midis kolonave. Teknikisht është krejt e lejuar që në këtë vend të ndërpritet betonimi. Ti, Jaho Emiri, deri sa të jem unë këtu përgjegjës për punimet, do të zbatosh urdhërat e mia; kur të bëhesh vetë teknik, vepro si të të duket më mirë.

Jahua po rrafshonte sipërfaqet e betonuara të traut me mallë druri. U ngrit që t'i pyesë shokët çfarë thoshin, por... malla i ra nga dora. Nga fjalët e teknikut ata ishin çarmatosur dhe njeri mbas tjetrit zbritën nga soleta, ndërsa punëprishësi e shikonte sikur do t'i thosh: «E, kujt i shkoi fjala?»

— Ke ndikuar keq në ndërgjegjen e anëtarëve të brigadës, shoku teknik. Një fjalë e jote e mirë do t'u jepte zemër atyre, do t'i inkurajonte shumë.

I la veglat në vend dhe shkoi tek shokët. Ata ishin në magazinë, po xhivishnin rrobat e punës dhe po bëheshin gati për të ikur. Tek dera u ndodh ballë për ballë me Halitin.

— E di ç'dua nga ti — i tha duke i vënë dorën në sup, dhe si e pa që tjetri ishte gati ta dëgjonte,

vazhdoi: «Ta bësh teknikun që të hyjë në vallen e punës, ashtu siç hyri në vallen e lodrës.

— Tani u kujtove ti, kur mbaroi betoni!

— Pikërisht pse mbaroi betoni na duhet që ta përgatisim vetë e ta kryejmë edhe atë punë që na ka mbetur. Të mos e prishim të gjithë kazanin për një qepë.

Haliti vuri gishtin në tëmthën e majtë dhe me një qëndrim prej oratori shakaxhi iu drejtua shokëve:

— Dëgjoni këtu, shokë! Përpara na del një detyrë e rëndësishme! — Pastaj u foli njerëzisht. — Të mos e marrim me shaka...

— Ti vetë po e merr me shaka, — ja priti njëri nga shokët.

— ...Ashtu është — e mori përsëri fjalën Haliti. — Unë e mora me shaka, por tani po flas seriozisht. Brigadieri ka të drejtë, prandaj o burrani t'i përvishemi punës.

Ai u nis i pari dhe mbas tij gjithë të tjerët.

Ndërsa ata punonin me gjithë shpirt, tekniku rrinte në vend i inatosur. «Po pse vepron kështu ai?» mendonte me vete Jahua. «Ç'humbet që ne punën e nesërme po e mbarojmë që sot? Egoizmi, që po ja shkatërrojmë me punën tonë, e bën me xhinde».

Tre çerek metro kubi beton që duhej, u përgatit brenda një çerek ore dhe mbas kësaj, filloi të transportohet. U duk sikur puna shkonte mbarë, por nuk zgjati shumë dhe doli rrypi i transportierit.

— O burrani ta ndreqim — u dëgjua zëri i Jahos, ndërsa tekniku buzëqëshi me ironi.

— Po ky ç'më rri si hu, kur neve po na del

shpirti me gjithë këtë derr rrypi — foli Haliti nëpër dhëmbë i nxehur. Hë pa ja tregoj unë tani. Dhe me qëllim e tërhiqte rrypin nga ana e kundërt.

— Jo andej, o Halit, se i more në qafë shokët që po e shtyjnë në drejtim të kundërt me ty.

— Po rri rehat aty ti dhe mos na çaj kokën! Po t'u dhimbsën shokët, hajde e i ndihmo dhe mos më rri aty si djalë beu. Unë kështu di, kështu punoj po dije më mirë ti, më mëso.

Teknikut iu duk sikur i mori koka flakë.

— Ja kështu shtyhet — i tha Halitit me inat dhe i dha rrypit me forcë.

Rrypi i transportierit i mundoi shumë. Kur mbaroi betonimi plotësisht, ora kishte kaluar nga tre.

— E brigadier! A e futa teknikun në punë, apo jo? — iu krekos Haliti Jahos.

— Po, por tani punët e tjera i kemi përpara.

Në mëngjes kur erdhën brigadat e tjera, të gjithë e shikonin punën e brigadës së Jaho Emirit. Me admirim vërente edhe tekniku, që e njohu për herë të parë forcën e madhe të këtyre punëtorëve në betonimin e traut të fundit të soletës

EMIRA

Emira po bënte një vit që punonte në spitalin tonë. Dhe nuk punonte keq. Kur erdhi në fillim, qe ca e mërzitur, e druajtur. Kuptohej që s'kishte besim në forcat e veta. Unë isha i qartë për këtë. E cili mjek fillon të punojë që ditët e para i sigurt në diagnozat që jep, në recetat që lëshon? Edhe unë kalova nëpër këtë rrugë, prandaj dhe e mbaja pranë. E këshilloja e, ngandonjëherë, e kritikoja me takt për të mos e lënduar.

Shefe e repartit qe doktoresha Pandora, mjek e vjetër e me eksperiencë, që e njihte mirë zënatin e vet. Atë ditë u vendos të hapej në qytetin tonë një konsultore për fëmijë. Duhej dërguar një mjek në këtë sektor të ri. U vendos që të shkonte Emira. Dërgova një infermiere për ta thirrur dhe, si drejtor i spitalit, t'i komunikoja vendimin.

Sikurse thashë, në fillim qe e drojtur, rrallë fliste në mbledhjet e mjekëve dhe e merrte fjalën vetëm kur kërkonte ndihmën e ndonjë specialisti. Kur kaloja për kontroll nga reparti i fëmijëve, e gjeja me stetoskopin në vesh duke vizituar të sëmurët e vegjël. Ata, duke qarë, i zinin me duart

e tyre të vogla tubin prej gome të stetoskopit dhe ja hiqnin nga veshët. Ajo s'mërzitej. Rregullonte aparatën, u dëgjonte frymëmarrjen, u prekte barkun, u hapte gojën, u lëvizte kokën. Mësoi mirë t'u shtinte të sëmurëve gjak në kokë nga venat e qafës, t'u merrte lëng nga palca e kurrizit. Doemos, në fillim i dridhej dora dhe balli i mbushej me bulëza djerse, por që atëhere kish kaluar mjaft kohë. Ajo tani ecte me këmbët e saj. Pikërisht në këtë kohë duhej t'i thoja se do të punonte në një vend tjetër, në konsultoren e fëmijëve.

Emira, dy muaj më parë që fejuar me një inxhenjer që punonte në një ndërmarrje të qytetit tonë. E uruam që të gjithë. Na thanë se kish marrë një djalë të mirë. Më prezantoi me të në një mbrëmje vallzimi, që organizuam me rastin e 1 Majit. Emira dhe i fejuari rrinin bashkë; njeri pranë tjetrit. Ai fliste më tepër, ndërsa Emira e dëgjonte. Ç'i thoshte vallë? I shikoja e, sakaqë, m'u kujtua dhe mua koha e fejesës me time shoqe. Ashtu qëndronim dhe ne, pranë njeri tjetrit e, unë flisja më tepër. E çfarë s'i thoja. Qesha ca me vete.

Ndërsa po mendoja, dëgjova të trokitura në derë.

— Hyrë! — thashë.

Te pragu u duk Emira, me bluzën e bardhë. Mbi xhepin e sipërm lexova Dr. E.N. të qëndisur me pe ngjyrë qielli të çelur.

— E dini përse ju kam thirrur?

— Jo.

— Uluni!

Emira u ul përkarshi meje. Ajo po më shikonte me habi. Ndoshta pyeste veten «ç'të këtë

ngjarë»? Mos kisha diktuar ndonjë të metë në re-partin e saj dhe tani e thërrisja për ta kritikuar?

— Emira — fillova — ju kam thirrur t'ju njoftoj një urdhër të seksionit.

Vajza po më dëgjonte me vëmendje. Shikoja sytë e saj të këndshëm nga nisej një vështrim që më depërtonte tejpertej. Buzët i kishin mbetur gjysëm të hapura dhe shprehnin habi.

— Puna qëndron kështu — vazhdova unë — tek ne do të hapet konsultorja e fëmijëve. Seksioni ka vendosur që atje të punoni ju. Rëndësinë e këtij institucioni të ri si pediatre, e dini më mirë se unë. Të hënën do të filloni nga puna atje...

— Unë mjeke konsultoreje! — tha ajo e habitur.

— Po.

— Si është e mundur! Sapo fillova ta ndjej veten të sigurt në punë, ju më propozoni, si pa të keq, që të vete në konsultore.

— Këtu s'ka asgjë të keqe!

— Si s'paska asgjë të keqe!

Emira po merrte flakë. Shikoja se si vala e zemërimit po e pushtonte dalngadalë atë vajzë me trup të imtë. Ashtu e nevrkosur, ajo dukej më e bukur, me sytë që i shkëlqenin nga zemërimi. Më erdhi keq. E pashë të arësyeshme t'i spjegoja misionin humanitar të mjekut të konsultores. Asaj do t'i takonte t'u mësonte nënave të reja si t'i ushqenin fëmijët, si t'i vishnin, që të rriteshin të shëndetshëm dhe kështu të kishim më pak të sëmurë në spital.

Emira nuk më dëgjonte më. Ajo i kish mbushur sytë me lot. E shikoja që vajzës i vinte

keq të ikte nga spitali, nga kolektivi ynë, me të cilin ishte mësuar për një vit rresht. Dhe ja, tani, unë, papritmas, po i thoja se do ta transferonim në një vend tjetër. Megjithëse puna në spital qe më e rëndë, ajo nuk donte të ikte...

... M'u kujtua se si, një mbrëmje, tek bënte Emira roje, vajta në spital për të parë gjendjen e të sëmurëve. Më është bërë zakon. S'ka ditë të mos vete në mbrëmje në spital, ku qëndroj ndonjë orë e ndonjëherë më tepër. Kur nuk shkoj, e marr mjekun e rojës në telefon që nga poliklinika dhe e pyes si i ka punët. Por atë mbrëmje vajta vetë me autoambulancë. Infermiera e rojës më tha se Emira kish vajtur tek i sëmuri Nr. 35, në dhomën e veçantë. Zakonisht, në këtë dhomë vendosim të sëmurët më rëndë, që kanë nevojë më tepër për qetësi. Në atë kohë ndodhej i shtruar në atë dhomë një poet i ri, emri i të cilit nuk po më kujtohet, që vuante nga leukemia. Deri tani, ndaj kësaj sëmundje ne mjekët jemi të çarmatosur. Kuptohet se ai qe mjaft i sëmurë. Ne nuk kishim lënë gjë pa bërë për ta shpëtuar, por, për fat të keq, pa asnjë rezultat. U drejtova për atje, por nuk u futa në dhomë. E kisha vështirë të ndeshesha me vështrimin e zgjuar të atij djaloshi, që qe bërë kockë e lëkurë. Duke pritur Emirën të dalë që andej, dëgjova këtë bisedë:

- Pse nuk flini? Gjumi ju bën mirë.
- Po shkruaj, që ta ndjej më pak dhimbjen.
- Kështu lodheni më shumë...
- Duke punuar harroj veten. Kam në dorë një poemë ku flitet për një njeri, që, megjithëse i mbërthyer në shtrat, mendon të bëjë diçka që

t'i shërbejë shoqërisë. Dua ta mbaroj sa më shpejt, se s'dihet...

— Mos mendoni ashtu. Po bëjmë gjithçka që të bëheni më mirë. Ju e kini parë...

— Ju faleminderit, por kur lexoj vështrimet tuaja të shqetësuara, kuptoj gjithçka.

Emira doli nga i sëmuri e pikëlluar. Edhe mua më vinte keq. U pamë sy më sy dhe nuk folëm. Fjalët ishin të tepërta atë çast. Ne mjekët ndeshemi shpesh me gjëra të këtilla. Disa mendojnë se nuk prekemi fare nga skena të kësaj natyre. S'është e vërtetë. Më bënte përshtypje vuilneti i fortë, optimizmi që kishte në vetvete ky djalë i ri. Atë ngjarje ja tregova dhe sime shoqeje në shtëpi. Për pak sa nuk i shkuan lot...

E përshkrova këtë ndodhi për të treguar se Emira kishte një shpirt delikat. Puna në spital e kishte thithur dhe ajo e dashuronte atë, ndaj nuk dëgjonte të ikte në konsultore. Por shefi i seksionit më mirte gjithmonë në telefon dhe më tërhiqte vërejtje pse ajo nuk po paraqitej në detyrën e re. Fola gjatë me të. I kujtova shokët e shoqet e saj, që kishin shkuar në fshat për të ndihmuar njerëzit të ruajnë shëndetin. Nuk i mbushej mendja.

— S'kam aq pregatitje, — ngulte këmbë ajo. — Unë sapo fillova të jem e sigurt...

— Po kë të dërgojmë, sipas teje? Doktoreshën Pandora që është e kaluar nga mosha dhe që së shpejti do të dalë në pension?

Emira ngrinte supet, belbëzonte.

— Unë...

Të nesërmen në mëngjes, në mbledhjen e mjekëve, erdhi vetë shefi. Kur mjeku i rojës mbaroi

së raportuari mbi gjëndjen e spitalit, ja dhashë fjalën atij, shefit. Ay u koll, i hodhi një vështrim të shpejtë Emirës dhe filloi të flasë me ngadalë si të donte të sistemonte mendimet.

— Erdha sot në mbledhjen tuaj jo pa qëllim. Mendova të shqyrtojmë së bashku një problem, që na intereson të gjithëve. Ju kini dëgjuar se në qytetin tonë do të hapet për herë të parë një konsultore për fëmijë. Kjo është një gjë shumë e mirë. Në këtë konsultore është caktuar të punojë një mjeke e spitalit tuaj, Emira. Por ajo refuzon, nuk don të shkojë atje. Ja për këtë punë kam ardhur në mbledhjen tuaj, që të shqyrtojmë së bashku qëndrimin e saj.

Për një farë kohe, pllakosi heshtja. Mjekët i drejtuan sytë nga Emira. Kjo e ndjeu veten ngushtë. U skuq dhe uli kokën.

Jashtë koha që e mvrejtur. Disa pika shiu vinnin e përplaseshin nga era në xhamet e dritares. Pikat e ujit rrëshqisnin poshtë duke përshkuar mbi qelq një rrugë dredha-dredha, si lotët mbi faqe.

I pari e kërkoi fjalën doktor Fatosi. Ky është kirurgu i spitalit tonë, burrë me flokë që kanë filluar të thinjen prej kohësh në tamthat. Zanatin e tij, ç'është e vërteta, e njeh mirë. Punojmë së bashku prej disa vjetësh dhe është kolona vertebrale e spitalit. Njerëzit e duan dhe kanë besim tek ai kur operohen. Kjo është një gjë e madhe për një kirurg. Për kirurgët thonë se dhjetë vjetët e para u dridhen duart nga pasiguria, dhjetë vjetët e dytë, operojnë mirë dhe dhjetë vjetët e tretë duart fillojnë t'u dridhen përsëri, por këtë radhë

nga pleqëria. Sidoqoftë, Fatosi është një mjek që na nderon. Ai, pra, kërkoi fjalën e pari.

— Unë, për veten time, e kam filluar punën si kirurg në një spital të vjetër dhe pa asnjë farë komoditeti. Ashtu qenë kohët atëhere. Askush nuk çante kokën. Por vështirësitë më mësuan shumë gjëra. I thirra nevojës, siç i thonë fjalës, dhe ajo erdhi. Ndryshe është tani. Emira sapo bën hapat e para në rrugën e vështirë të mjekësisë. Unë e kuptoj këtë. Emira është e re dhe s'ka pse t'u tërmbet vështirësive.

Kirurgu heshti, u mendua pak, pastaj tha:

— Kaq kisha për të thënë.

Pas doktor Fatosit e mori fjalën dekania e trupës sonë, Pandora.

— Me hapjen e konsultores, po realizohet një dëshirë e imja e vjetër, që më parë kishte mbetur vetëm një ëndër. Më vjen mirë që atje është caktuar një mjeke pediatre siç është Emira. Por t'ju them të drejtën, habitem pse shoqja jonë nuk don të shkojë atje. Unë mund të them, tani, se në se na sëmuren shumë fëmijë, kjo vjen nga që një pjesë e nënave tona të reja nuk dinë akoma t'i ushqejnë ose t'i veshin fëmijët sipas rregullave. Vetëm me këshilla mund të kem shëruar me mijëra fëmijë dhe kushedi sa herë jam ftuar nëpër ditëlindjet e tyre. As shpërblimi më i madh nuk më ngjallte kënaqësi më të madhe se sa rritja e mirë e njerëzve... Eh, më përpara e kemi pasur më të vështirë, kurse tani, njeriu ka mundësi të mëdha për punë, për të zhvilluar aftësitë e tij. Po ngrihen spitale, dalin çdo vit me dhjetra mjekë të rij, të cilëve, ne, më të vjetrit, do t'u dorëzojmë stafetën. E, megjithatë, na mbetet mjaft për të

bërë. Kush do t'u mësojë nënave të rritin fëmijë të shëndoshë? Pa dyshim mjekët, e, në radhë të parë, ata të konsultores. Si shoqe pune që jemi me Emirën, dua t'i them që t'i futet këtij problemi. Atëhere do të kemi më pak të shtruar në spital. Megjithëse kam hyrë në dekadën e gjashtë të jetës sime, do të përpiqem ta ndihmoj sa herë të ketë nevojë.

I hodha një vështrim me bisht të syrit Emirës tek rrinte në vendin e saj. Ç'mendonte ajo atë çast? Ndoshta e ndjente veten në zor të madh? E megjithatë ne i flisnim kështu, se e donim, se dëshironim që ajo ta kapërcente sa më lehtë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme ngurrimin.

Kujtova se do mos flisnin njerëz të tjerë, por u gabova. Emili, infeksionisti ynë, kërkoi fjalën.

— Karjerën time e nisa në Durrës në vitin 1938. Më vonë, pas çlirimit, u transferova në Rubik ku nuk kishte as autoambulancë, as farmaci. Merreni me mend! Sapo kishim dalë nga lufta të djegur e të shkatërruar, sëmundjet bënë punën e tyre. Njerëzit gjithmonë ja kanë pasur nevojën mjekut, sepse u shëron ose u lehtëson dhëmbjen. Vura të gjitha forcat ta kryeja detyrën, dhe s'kish kënaqësi më të madhe për mua kur shihja se ata i shpëtonin vdekjes. Dhe sa mirënjohës janë njerëzit e thjeshtë, punëtorët. E ndjeja mirënjohjen e tyre te kujdesi dhe respekti që tregonin ndaj meje. E ndjeja kur ata thonin: «Hapuni, se erdhi doktori». Ky kujdes më prekte, më mallëngjente. E kuptoja që njerëzit më respektonin dhe jo rralle herë më zgjidhnin në presidium kur minatorët bënë mbledhje. Pra, këta njerëz të thjeshtë, kë-

ta punëtorë, që një pjesë të jetës së tyre e kalonin në galeritë e nëndheshme, respektonin punën time. Puna e jonë ka të bëjë me njerëzit e gjallë. Për mjekun, fronti kryesor është njeriu. Këtu në spital neve na ndodh shpesh të grindemi midis nesh për çështje të diagnozës: është pneumoni apo pleurezi? Në këto polemika profesionale s'ka asgjë të keqe. Përkundrazi. Pastaj, thërresim një të tretë për të dhënë mendimin. Rëndësi ka që mjeku të shpëtojë njeriun dhe s'ka rëndësi vendi ku ai punon.

Fjalët e Emilit më pëlqyen fort. Të gjithë po e dëgjonim me vemendje. Jashtë shiu vazhdonte të binte. Herë pas here, vinte në veshët tanë gjëmi-mi i shurdhër i ndonjë bubullime të largët. Emira kish mbështetur faqen në pëllëmbë dhe shikonte nga dritarja. E kisha zor të kuptoja se ç'ndodhte në shpirtin e saj. Mbase tek ajo, diku thellë, bëhet luftë mendimesh: të shkante apo të mos shkante në konsultore? Kush do të fitonte? Arësyeja apo mendimet që e pengonin? Po ajo, a nuk do të flasë? Nuk do ta thotë mendimin e vet? Për çudi, sikur t'ja kisha lexuar idenë, Emira u ngrit dhe tha:

— Unë e kam thënë edhe më parë se nuk mund të punoj në këtë sektor. Kjo punë është një barrë e madhe për mua, e ndjej se nuk do ta bëj dot. Atje është punë me përgjegjësi. Do të jem vetëm, pa një mjeke që të më udhëzojë. T'ju them të drejtën, nuk kam guxim. Ju e dini që organizimi i fëmijëve është shumë më i ngatërruar se i të rriturve prandaj, atje duhet të jetë një mjek me eksperiencë.

Mbasi mbaroi, u ul në vendin e saj. E kisha

të qartë: ajo u trembej vështirësive dhe nuk kish besim në forcat e veta. Mua dhe shokëve të mi na takonte që t'ja ngjallnim besimin e humbur kësaj vajze të re, që s'kish më shumë se një vit që ish larguar nga shkolla.

Në këtë kohë e kërkoi fjalën doktor Ylviu, një mjek i ri, i cili është përgjegjësi i rinisë në spital. Ai me Emirën kanë mbaruar së bashku fakultetin dhe në një ditë u emëruan në spitalin tonë:

Ai tha:

— Mua nuk më pëlqeu aspak diskutimi i shoqes Emira. — Ylviu u koll duke vënë dorën përpara gojës. Ne jemi shokë që të dy dhe njihemi mirë. Por unë dua ta kritikoj për tendencën që manifeston ajo, për frikën që ndjen përpara vështirësive. Më vjen keq me gjithë mend. Ndoshta ajo do të zemërohet, por megjithatë unë do t'ja them: nuk e këshilloj Emirën që ta vazhdojë karrierën e vështirë, por fisnike, të mjekut në këtë mënyrë. Le të mendojë për një çast mjekët partizanë, që në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa barna, pa instrumenta, mjekonin dhe shëronin partizanët e plagosur. Çfarë sakrifica kanë bërë ata! Kurse ne sot punojmë në kushte që ata as mund t'i ëndëronin atëhere. Po e them përpara të gjithëve, në rast se drejtoria e shikon të arësyeshme, me gjithë që jam i një profili tjetër, mund të shkoj vetë në vendin e Emirës.

Ylviu fliste me zë të fortë, si të ishte në mbledhjen me të rinjtë. Herë pas here i shoqëronte fjalët me lëvizjen e dorës së djathtë, ashtu siç bëjnë shpesh konferencierët. Toni i tij m'u duk tepër i rreptë. Ajo nuk duhej gjykuar kaq ashpër. Emira që një vajzë me shpirt delikat dhe tepër e

ndijshme. Ndoshta fjalët që thamë për të, mund ta shtynin të bënte të kundërtën: t'i ngjallnin ndjenjat e një kokëfortësie të sëmurë. Prandaj, gjithë ato ditë, mbas mbledhjes, e mbajta pranë, i jepja guxim dhe mundohesha t'i rrisja besimin në veten e saj. Shefit i thoja se duhej të prisnim ca ditë, derisa ajo ta kapërcente këtë çast të vështirë për të e të vendoste. Mbledhja e kolektivit asaj i kish lënë mbresa. Bisedova me shefin e seksionit. Ne mund ta detyronim të vinte atje, do të mjaftonte një shkresë, një urdhër, një veprim zyrtar. Por ne nuk u ngutëm. Donim që ajo të bindej, t'i mbushnim mendjen se ajo i kish të gjitha mundësitë ta kryente detyrën, se ish në gjendje t'i kapërcente vështirësitë, donim ta bindnim të kishte besim në forcat e saj dhe se ndihma nuk do t'i mungonte.

Një ditë, portieri më lajmëroi se një inxhener kërkonte të më takonte. Po vrisja mendjen, se cili do të ishte ky inxhener që kishte punë me mua. «Ndoshta», thashë me vete, «ka të shtruar ndonjë njeri në spital dhe kërkon të dijë se si i ka punët». E lejova të futej në drejtori. Përpara meje qëndronte i fejuari i Emirës, me atë trupin e gjatë dhe flokët e krehur me kujdes. I thashë të ulej. Vinte tek unë për çeshtjen e Emirës. Ja spjegova, megjithëse ai e dinte. Ajo që më habiti qe fakti se edhe ai ishte i mendimit që Emira të shkonte në konsultore. Për këtë edhe qe grindur me të fejuarën.

Pas disa javësh, ngjau diçka që na ndihmoi në përpjekjet tona. Një mëngjes, në spitalin tonë u shtrua një fëmijë në gjendje të rëndë. Foshnja erdhi pa puls, me buzë të mavijosura, e ftohtë,

gati e vdekur. Emira luftoi fyt për fyt me vdekjen, atë ditë, tërë natën e deri në mëngjes. Por më në fund, e nxorri nga ajo gjendje. Atë ditë koha rridhte shumë ngadalë për Emirën. Në repartin e pediatriisë njerëzit qenë në lëvizje. Infermierët sillnin serumet, i bënëin gjilpëra herë pas here për t'i forcuar zemrën. Emira i jepte kurajë nënës së foshnjës, që mallkonte veten, sepse e pat ushqyer foshnjën e saj me pelte para kohe. Ku ta dinte ajo e shkretë se nuk i duhej dhënë akoma ky ushqim?

Në mëngjes e tokava doktoreshën në koridorin e pavionit. Dukej e lodhur dhe e raskapitur. Megjithatë, në sytë e saj lexohej një gëzim i papërshkruar, që e ndjejnë të gjithë mjekët kur shpëtojnë ndonjë njeri.

— Si duket fëmija? — e pyeta.

— Besoj se do ta kapërcejë.

Pastaj shtoi:

— Me që u takuam, — tha ajo, — desha t'ju thoja se që nesër nuk do të paraqitem më në spital. Do të filloj atje...

U ndamë. E pashë tek largohej për në garde-robë e qetë, me duart në xhepat e bluzës. E përfytyrova tek po vishej dhe po dilte nga porta e madhe e spitalit. Tani nuk do të vinte më në mbledhjet e mëngjesit. Buzeqesha. Në zyrë, mora në telefon shefin dhe e lajmërova se Emira do të fillonte punën në konsultore.

MONTATORI

Tregim

Andoni kaloi me kujdes koridorin që sapo ishte larë dhe pas pak u gjënd në hyrjen e pavionit.

— Përsëri për tek shokët, mendoi dhe mori frymë thellë.

Po errej. Mbi gjysmën e kupës së qiellit retë e zeza notonin si hie vigane. Kapërceu gardhin me dërrasa që rrethonte spitalin dhe zbriti drejt rrugës së asfaltuar. E bëri këtë mbasi tek dera nuk do ta lejonin të dilte. Njerëzit në rrugë kalonin me nxitim dhe nuk e vinin re. Qyteti poshtë ndriste. Vargu i gjatë i llambave neon zgjatej si shirit i zjarrtë e shkrihej në zemër të tij.

Njerëzit, dhe kjo më e theksuar tek të rinjtë, e ndjejnë veten më të lirë, më të lehtësuar, kur futen sërish në gjirin e jetës mbas një kohë shkëputjeje për ndonjë arësye. Vetja u ngjan e ripërtërirë, e fuqishme dhe e gatëshme për t'i bërë ballë ç'do gjëje në jetë. Këto ndjente dhe Andoni kur e la pas spitalin dhe po futej në qytet. Kishte dhjetë ditë që e kishin shtruar me urgjencë në

spital. Ishte djegur në gjysmën e fytyrës dhe në dorën e majtë. Andoni dinte vetëm se ishte djegur duke hapur kapakun e fuçisë me karbit dhe asgjë tjetër. Dhimbjet e përplasnin në kllapi, e bënë të pa fuqishëm, si një re të shtyrë nga era.

— Jam mërzhitur shumë, i tha ditën e dielë Gjikes, shokut të tij të punës.

— Të kam sjellë dy libra dhe një revistë, i tha Gjika, duke i vendosur bashkë me portokallet mbi komo.

— Habitem me mjekët, vazhdoi Andoni, «do të rrih dhe një javë akoma» më thonë ata. S'më kuptojnë fare. Unë jam i ri, nuk mund të qëndroj kështu. E përse?! Për hiç gjë, jam djegur dhe kaq. Ju punoni atje deri natën vonë, kurse unë rri shtrirë këtu. Dua patjetër të vij tek ju.

Gjikes, tek vështronte Andonin që po fliste me zjarr, i kujtohej ai Andoni i vogël para shtatë vjetësh, që kapte me duart e vogla çelësat dhe thosh: «Do të bëhem montator». Dhe u bë. Kaluan vitet që nga ato ditë dhe ja tani po ai Andon po i fliste me aqë zjarr për veten dhe për punën. Gjika e kuptonte fare mirë.

— E po s'ke ç'u bën mjekëve, i tha ky më në fund për ta qetësuar, edhe ata zbatojnë detyrën.

— Unë po rri kot, s'kam gjë, — i tha prapë Andoni. — Çdo gjë u bë nga pakujdesia. S'jam djegur duke kryer heroizëm...

— Jo, jo, ja preu fjalën Gjika. Edhe akti yt ish një heroizëm. Voza e karbitit, në rast se ti nuk do t'a kishe hapur, mund të kishte shpërthyer. Ajo gjatë natës kish marrë ujë dhe presioni brënda ishte rritur. Merri me mend pasojat. Andonit nuk i vinte mirë, kur i flisnin për veten dhe për atë

që kishte kryer, prandaj i tha Gjيكës për të mbyllur bisedë:

— Eh, a e mbaruat së montuari linjën e fundit të avullit?

— Po, dhe nesër në darkë do të fillojmë provat.

* * *

Unë duhet të jem patjetër atje, mendoj kur Gjika u largua. Dhe ja, tani ai kaloi reklamën e kinemasë dhe u drejtua nga pjesa e jashtme e qytetit. Mendja i rrihte atje tej, mes pyllit me pisha buzë detit, tek provat që do të bëheshin. As i vinte re njerëzit buzë trotuarëve që i shihnin fytyrën e tij gjysmë të nxirë dhe pizhamat e spitalit që i dukeshin poshtë pantallonave. La pas fushën e aeroplanit e u fut në pyll. Në pyllin me pisha dhe me plepa kishte rënë qetësi. Një qetësi vjeshtake, ku dëgjohej lehtë zhurma e gjetheve që binin. Andoni kaloi një copë rrugë të mirë nëpër qilimin e kafejtë, që kishte shtruar vjeshta. Nga oxhaku dilte tym. Sipër majave të pishave dukej ndërtesa madhështore e bikarbonatit. Më të djathtë shkëputeshin si meteorë copat e metalit të shkrirë nga saldatricët që punonin në kullën e gëlqeres. Kur arriti, provat kishin filluar. Shokët ishin ndarë; dikush tek pompat, dikush tek elektromotori, një tjetër tek treguesi i presionit. Pa u vënë re, Andoni u ngjiti sipër në kaldajë. Presioni po rritej dhe po arrinte 13 atmosfera. Nga lart po rridhte me furi ujët prej fllanxhës së tubacionit kryesor. Andoni rrëmbeu një çelës anglez dhe në mënyrë të rrufeshme u ngjiti në katin e tre-

të. Ishin liruar bullonat. Futi çelësin në dado dhe nisi t'i shtrëngoje. Uji që rridhte me presion 13 atmosfera nisi t'i lagë fashën e dorës dhe po i futej në plagët e djegura. Ato filluan t'i dhëmbin, por Andoni as që i ndjente.

— Po ulet presioni, — tha Skënderi që po vështronte manometrën.

— Do të ketë avari, — iu përgjegj tekniku që po llogariste diçka në bllok. — Nisu vrap dhe ndiq linjën e tubacionit kryesor.

Nga kati i tretë po rridhte ujë. Skënderi pa dikë që po shtrëngonte diçka. «Kush do të jetë vallë?», dhe u ngjit të shihte më mirë. Andoni?! U habit dhe zbriti të thërrasë shokët. Kur arritën ata, Agroni po shtrëngonte me zor bullonin e fundit. Pantallonat i ishin ngjitur pas këmbëve dhe uji i kullonte pikë pikë.

— Andon, ç'ne ti këtu? — i tha Gjika kur e pa.

— S'mund të rrija atje. Unë e kam vendin këtu, tek ju.

E muarën dhe e afruan pranë derës së furrës. «Njerëz të mrekullueshëm», mendoi shefi i objektit. Ndërkaq nga fllanxha ujët nuk rridhte më. Shigjeta e manometrit shënoi përsëri 13. Uji po ndiqte rrugën e tij normale. Prova pati sukses.

NË RRUGË NJIHEMI ME NJË SHOFER

Po shkoja për të punuar në një rreth tjetër. Dua t'ju tregoj për udhëtimin që bëmë ahëre: ngjarje e thjeshtë, po, siç më duket mua, tërheqëse.

Kanë kaluar vjete dhe herojt e mi kanë krijuar familje dhe kanë fëmijë. Kujtesa ime është dobësuar, por megjithatë nuk mund të harrohen të tilla ngjarje. Këto janë shumë të thjeshta, por shpesh herë njeriut i pëlqen të kujtojë pikërisht të tilla ngjarje.

Edhe atëhere ishim në një makinë të tipit «Skoda» si kjo që po udhëtoj sot. Në kabinën katër vendëshe, përveç shoferit isha unë, Astriti, të cilin e kisha shok të ngushtë, dhe një vajzë. Ajo qëndronte në sediljen para meje dhe unë i shihja qafën dhe shpatullat. Flokët e saj ishin të butë dhe kishin ngjyrën e arit. Maqina ecte duke lënë prapa fushat që zverdhnin nga gruri. Të gjithëve na ishte kyçur goja dhe kishim një kohë të gjatë pa folur.

— Gruri ka marrë ngjyrën e flokëve tuaja, —
iu drejtua shoferi vajzës.

Për një çast mbretëroi heshtja, pastaj një e qeshur kumboi në kabinë. Qeshëm mjaft dhe kjo gjë e turbulloi edhe më tepër vajzën. Ishte skuqur në fytyrë. Nuk qeshëm për fjalët që tha shoferi, por sepse kjo ishte fjala e parë që u dëgjua që kur hipëm në maqinë dhe më shumë, qeshëm për guximin e tij. Vërejta dhe shoferin dhe kuptova se kishte folur seriozisht. Në buzëqeshjen e tij kishte aq dliresi sa nuk dije ç'të thoshe. Pas pak vajza e mori veten e me gjakftohtësi tha:

— Si mund t'i thoni të tilla fjalë një vajze të panjohur. Si ja lejoni vetes një sjellje të tillë?

— Nëqoftëse ato fjalë ju rënduan, atëhere më falni dhe unë i tërheq përsëri — tha shoferi duke lëvizur timonin nga e majta. — Megjithëse nuk më shkoi në mendje t'ju fyeja dhe po ta dija se do të më keqkuptonit, nuk do të flisja kurrë.

Ngelëm të habitur. Ai fliste çiltër dhe me zë prekës.

Të gjithë vumë re, edhe vajza, se ai ishte pënduar për çka kishte thënë. Kjo gjëndje do kishte vazhduar kushedi sa kohë sikur vetë vajza të mos kishte vënë re disa libra. Pa pyetur dhe ndofta për të dalë nga ajo gjëndje, ajo zgjati dorën dhe i mori. Ajo po çfletonte faqet e librave dhe unë munda të lexoj: «Lumi i vdekur», «Çapajev», «Garda e re» dhe «Përralla popullore». Librat ishin të reja dhe ishte zor të dalloje në i kish lexuar shoferi apo jo.

— Për vete apo për të tjerët i mbani këto libra? — i tha vajza shoferit.

— Për vete, — u përgjegj ai.

— Po ju as i kini hapur fare, vijoi ajo, — dhe këtu u pa qartë se deshte të merrte hakun, — apo i mbani që të dukeni?

Ai e kuptoi ku deshte ta hidhte fjalën ajo dhe me një gjakftohtësi që na çuditi të gjithëve tha: «I kam lexuar të gjithë dhe aty keni dhe shënimet e mia për disa gjëra, po ju si duket nuk i vutë re». Dhe me të vërtetë ashtu ishte. Po një përshtypje të madhe na bëri shkrimi i bukur i tij. Ai kish shkrim të mrekullueshëm. Po mbushja njëzeteshtatë vjetët, po shkrim aq të bukur nuk kisha parë. Edhe ajo vetë u hutua për një çast, pastaj vazhdoi.

— Edhe përralla lexoni? — i tha duke qeshur. — Ato janë për fëmijë.

— Po, edhe përralla lexoj, sepse dua të kujtoj fëmiminë time. Atë fëmimi që pata ëndëruar dhe duhej të jetoja. I kam zili fëmijët, por jam i lumtur që i shoh të gëzuar e të qeshur.

— Ju flisni sikur jeni pesëdhjetë vjeç — i thashë unë, — kurse jeni në një moshë me mua.

— Në mars mbusha njëzetegjashtë vjetët, — tha thjeshtë ai. — Ju e mbaruat shkollën?

— Universitetin, shpjegoi Astriti.

Aq më mirë. Do t'i mësoni fëmijët, do t'u jepni dije dhe do t'u tregoni rrugët e jetës. Kjo punë sjell kënaqësi. Kur sheh se njerëzit që mbaje dikur për dore fillojnë të hedhin hapat e para në jetë duke ecur me këmbët e veta, dhe mendon se nga këta do dalin inxhinierët, mjekët, teknikët, mësuesit. . .

— Dhe shoferët e ardhshëm, — thumboi ajo.

— Po, edhe shoferët, sepse dhe në punojmë

për atë qëllim. Ju çoni dijen kudo, kurse ne ju shpiem juve për të dhënë këtë dije.

— Po shoferët e ardhshëm nuk do të jenë pa edukatë dhe nuk do të ngacmojnë vajzat, — vijoi ajo.

— Sigurisht, do të jenë shumë herë më të mirë, po edhe mësueset e ardhme do të marin leje para se të prekin diçka të huaj, — mori hakun shpejt shoferi.

Ne që ndiqnim këtë dialog, qeshëm përsëri, por këtë radhë e qeshura kumboi gëzueshëm. Të gjithë ishim të gëzuar dhe ndjenim simpati për shoferin tonë. Ai të bënte për vete dhe nuk mund t'i mbaje mëri. «Sigurisht që ka arësim të mesëm, mendova, s'ka si të jetë ndryshe. Po pse të jetë shofer?»

Ai më hodhi një vështrim dhe aty për aty m'i kuptoi mendimet.

— Çuditësh që jam shofer, — më tha. — Më pëlqen ky profesion. Që kur isha i vogël ëndëroja të bëhesha i tillë. Mbarova politeknikumin dhe punoja në park. Aty mësova të ngas maqinën. Tani e kam më lehtë, sepse makinën e kontrolloj dhe e rregulloj pothuajse krejtësisht vetë.

— Ju kam zili, — thashë.

— Më keni zili? Po edhe profesioni juaj është po aq i bukur. A ka lumturi më të madhe kur dashuron profesionin që ushtron, kur ato gjëra që di ua mëson të tjerëve.

— Ju zutë në gojë fjalën «Lumturi», — tha Fatmiri, — kështu e quajnë shoqen që është me ne, shokun tim Astrit dhe mua Fatmir. Ky le të jetë dhe prezantimi. Shoferi na hodhi një vështrim të gjithëve, buzëqeshi dhe tha:

— Më quajnë Agron, veçse prezantimi u bë pak me vonesë, po si thotë një fjalë e popullit «më mirë vonë se kurrë», — shtoi duke qeshur. Pas pak fytyra e tij mori pamjen serioze.

— Lumturi! — foli mendueshëm ai. Ne e vështruam me kureshtje kurse Lumturia gati e hutuar. Por me një ton të qetë dhe të thjeshtë tha:

— Me gjithë mend emër i bukur. Këtu s'ka asgjë për të bërë shaka. Emër thjesht shqiptar dhe, për më tepër, i përgjigjet jetës sonë.

— Ne duhet të udhëtojmë akoma për të arrihur në vend dhe gjatë kësaj kohe të diskutojmë ç'kuptojmë me fjalën «lumturi», — foli Astriti.

— Nuk e di a do të ishte gjë e mirë nga ana jonë të flasim për këtë gjë pa marrë pëlqimin e shoqes, — ndërhyri shoferi. — Do të na quanin përsëri pa edukatë.

Lumturia i buzëqeshi këtë radhë me dashamirësi. Fytyra e saj ishte bërë shumë e bukur për çudi dhe ajo ndjehej e lumtur. — Le të diskutojmë, — mundi të thotë ajo.

— Si e kuptoni ju këtë gjë? — iu drejtua ajo shoferit.

— Më zutë ngushtë, — foli sinqerisht ai. — Nuk di a mund ta shpreh drejt, po unë e kuptoj këtë gjë kur punoj dhe e di se kjo punë çmohet nga njerëzit, kur në veprat e mëdha edhe dora ime ka vendosur qoftë dhe një tullë të vetme, kur di se e ardhmja ime është e sigurtë dhe kur të gjithë ne, pa marrë parasysh profesionet, punojmë për të njëjtin qëllim. Dhe mund të them se jam i lumtur.

— Ju shprehët ato që ndjej dhe unë, — ndër-

hyri Astriti dhe mund të them se i thatë më qartë.

Edhe vetë Lumturia ishte e gëzuar. Ajo kishte kohë që e vështronte Agronin dhe unë vura re mirë në atë veshtrim një shkëndi të vogël... por një frenim i papritur që i bëri shoferi maqinës më këputi mendimet. Ç'kish ndodhur? Një fshatar me një dhi i kish dalë përpara maqinës. Vështrova Agronin, ishte zverdhur pak në fytyrë. Çdo të ndodhte; grindje, të bërtitura ose sharje. Ai çeli derën e kabinës, zbriti poshtë dhe i foli fshatarit qetë.

— Përse rrezikon veten! Për pak ndodhi fatkeqësia. Për ku shkon kështu?

— Për në pazar, — munda të thotë fshatari që s'e kishte marrë veten ende — do të çoj në grumbullim këtë dhi të flamosur.

— Hyp lart në karroceri.

— Nuk kam para me vete, murmuriti fshatari, po deshe të jap ca rrush që kam në trastë.

— Nuk dua asgjë, — tha shoferi. — Kapi dhinë dhe e hodhi mbi karroceri, që qe pathuaj e mbushur me thasë me çimento. Hypi në kabinë dhe pas pak maqina u nis. Kjo gjë na la mbresë të gjithëve.

Dëshiroja që ky udhëtim mos të mbaronte kurrë, po qyteti ku do zbrisnim s'ishte larg. Pas pak maqina ndaloi dhe duhej të zbrisnim. Na vinte keq që ndaheshim me atë njeri.

— Ne tani jemi miq — tha ai — dhe do të shihemi shpesh pasi këtë rrugë e bëj çdo ditë. Mirupafshim.

— Mirupafshim, — u përgjegjëm.

Pas pak maqina u nis dhe ne ngelëm në vend. Agroni kishte nxjerrë kokën dhe na përshëndeste me dorë përsëlargu. Ne ia kthyem përshëndetjen.

Lumturia dukej si e mallëngjyer. Mos e ndjente më tepër se ne mungesën e tij? Kur maqina nuk dukej më, unë mora valixhen time dhe të Lumturisë dhe thashë:

— Të shkojmë në shkollë. Do ta takojmë gjithmonë.

Në heshtje vijua rrugën.

GJYQI I NDËRGJEGJES

— E mo, nuk ta bën borxh ky?... iu drejtua Dhori shokut që kish pranë. Pardje, kur e provuan vizatimin, thërriste në kulmin e entuziazmit: I mrekullueshëm Dhori! I shkëlqyer! Kurse sot... hë, ta bën a nuk ta bën borxh, pra!

— Po, mvaret si ta kuptosh — ja ktheu tjetri qetë qetë, ndërsa gërryente figurat mbi cilindrin prej lakri, pa e ngritur kokën.

— Si, mvaret — shqiptoi i rrudhur e me shikim të vëngër, Dhori — po të ishe ti në vendin tim, si do ta kuptoje, atëhere?

— Aaa, don të dish se si do e kuptoja unë? — foli Sabriu, dhe shtoi: — Secili ka mënyrën e vet të të kuptuarit. Unë, fjala vjen, në radhë të parë do të kërkoja të bindesha në se skarcua ishte ose jo për fajin tim... Pak rëndësi kanë deklaratat, për të mos thënë hiç. Aq më tepër kur dihet se përgjegjësi ynë i bën ca si të nxituara ato të shkreta deklaratat, para kohe. Është natyra e tij, xhanëm, që entuziazmohet shpejt. Po, kjo

nuk duhet të shërbejë si perde për të mohuar përgjegjësinë. Ne e pamë atë cilindrin, po t'i s'u ndodhe këtu. Dhe është për fajin tënd. Prandaj, mendoj se s'ke të drejtë të sillesh në këtë mënyrë...

— Ua, s'paskam të drejtë thotë! Si ore!... Domethënë po doli mirë — na takon neve, po doli keq — mbaje ti! Dhe e paskam fajin unë!... Oj, pardje më mbuloi me një mori lëvdatash, kurse sot dalkam edhe borxhli!

Tjetri mbështeti mjekrën në faqen e dorës dhe po e shikonte në heshtje. Në fytyrë i vizatohej një buzëqeshje e lehtë, keqardhëse. Thosh me mendje: «Eh Dhori, Dhori! Sa i dhënë je pas interesit personal! Sado pak të të preket ai i shkretë, mufatesh si ai qumështi në zjarr! Të ka molepsur fare para! Sa shumë të verbon!...»

I vinte çudi...

Kish përpara një djalë të pjekur, që i kish kaluar të njëzetekatrat. Njeri me përvojë, i zgjuar dhe i rrahur nga jeta. Dy vjet të shkuara mbaroi me nota shumë të mira gjimnazin e mbrëmjes në kombinat. Punon dhe jeton në mes të një kolektivi të talentuar. Dhe, ç'është e vërteta, punon mirë. Po, ndodh nganjëherë që...

Ja: ke punuar mbi një vizatim disa javë. Ose disa muaj, kjo mvaret, — sipas natyrës së vizatimit, nga ngarkesa e tij. Dhe, kur ai provohet në stampim dhe të del mirë, kënaqësia është e madhe, shumë e madhe. Po ndodh që munda dhe djersa, për një difekt të shkaktuar nga pakujdesia e një çasti, të shkon kot. Dhe kjo të hidhëron së tepërmi, të pikëllon pa hesap. Këtë e dinë mirë skalitësit... S'i thonë shaka; shpesh, procesi duhet filluar gati nga e para dhe, po të llogaritësh kohën e hu-

mbur përsëdyti, bazën materiale, ... ke arësye të plotë të hidhëroresh, të ndjesh dhëmbje...

* * *

Inxhenjери doli. Kur u gjend tek dera, Dhori thirri:

— Shoku inxhenjer!

Tjetri mbajti këmbët dhe u kthye andej nga erdhi zëri.

— Desha të bisedoja pak me ju, ka mundësi?

— Posi! — gjegji inxhenjери, dhe qëndruan përballë njeri tjetrit. — Hë, si e ke punën? Apo... mos don të vish në zyrë? Hajde!

— Jo, jo... — belbëzoi Dhori, pa e fshehur zemërimin. — Për atë vizatimin tim desha të shija...

— Aha, po. E pra, njeri prej cilindrave del me një figurë të dobët, s'ngopet me bojë. Ai i blusë, me sa kujtoj. Si dreqin të ka shpëtuar xhanëm, ta marrë djalli ta marrë! Dhe ku na e gjeti tashti, që jemi gjer në fyt si me planin tonë, ashtu edhe me atë të tregëtisë... Duhet çkromuar dhe duhet thelluar paksa ajo figurë. Të fillojë qysh nesër kjo punë, mirë?

— Mirë, mirë... po ç'kusur që ta ha unë tashti, pa mirë! — foli Dhori. Ç'kusur të më pri-tet përqindja mua!

Inxhenjери po e shikonte me habi, dhe një nënqeshje e lehtë e hidhur e pushtoi në çast. Nuk ju durua dhe ja preu zinxhirin e fjalëve, që tjetri po nxirrte me vështirësi, me një ton shumë të butë:

— Le ta zëmë për një çast se ti s'ke asnjë faj në këtë mes, kështu?.. Atëhere, sipas teje, kush duhet të përgjigjet për atë difekt, ë? Unë?

— Po... ju më thatë që doli mirë, bile shumë mirë, kurse tashti...

— Gabova edhe unë. Me që të thashë ashtu, ti mos u shkarkove nga përgjegjësia, ë? Hë, kjo është me të vërtetë e çuditshme! — foli inxhenjeri duke nderur krahët anash e duke thartuar buzët. Do të bisedojmë ndonjë ditë bashkë, patjetër — dhe i ktheu shpatullat.

* * *

Në minutat e fundit, para se të linin punën, Sabriu ju afrua tek tavolina, fare pranë, ashtu siç bëjmë kur nuk dëshirojmë që biseda të na dëgjohet nga një i tretë. I tha duke qeshur, me sinqeritet:

— Mirë de mirë, po, megjithë mend e the atë fjalën «ç'kusur që ta ha unë»? Vërtet nuk e kupton që ajo skarco është për fajin tënd?

Dhori çakarriti sytë dhe thirri me një ngërdheshje qesharake:

— Jo, mo, e thashë pa mend!.. He, t'u bë qejfi ty që do më pritet përqindja? Kënaqu ti, pa dreqi ta hajë!

Tjetri shtangu. I ngriu e qeshura në buzë dhe u pre në fytyrë. Në çast ndjeu një tendosje të çuditshme të nervave, që ja drithëruan trupin si të ndodhej nën influencën e rrymës elektrike. Sytë iu mjegulluan. Edhe goja iu mbërthye për një çast. Vetëm e shikonte me sytë të mbyllur përgjysëm. Më në fund belbëzoi:

— Ç'janë këto marrëzira që thua, Dhori!...
Kur unë të flas me njerzillëk, ti...

— E di, e di njerzillëkun tënd unë! Këtu të flet urtë e butë ti, po nga ana tjetër ta ngjesh mirë!

— Ashtu? Ke kohë që më njeh të tillë?

— Kam — kam, po më lerë rehat tashti, se s'ta kam ngenë, atë bën!

— Ti je një egoist pra, as më shumë e as më pak! — foli Sabriu, më tepër me keqardhje dhe bëri të ikte, po Dhori u ngrit i xhindosur:

— Mbaje gojën, dëgjon! Kujt i thua egoist ti!



Ndërsa ecëte me hapa të ngadalshme e të rënda, me duart të futura thellë në xhepat e palltos e me jakën të ngrehur rreth qafës, e vetmja dëshirë e tij ishte qetësia, vetmia. Por ishte i bindur se do ta gjente në shtëpi të ëmën. Ajo kthehej gjithnjë përpara tij nga puna. Dhe kjo e brengoste, sepse nuk ishte i zoti dhe nuk qe mësuar t'i fshihte asgjë nënës — as gëzimet e as hidhërimet që provonte. Ishin mësuar të ndanin bashkë gjithçka. Ajo kaloi të ritë e saj me të.

Me këto mendime në kokë u gjend përpara bufesë «Tekstili», ku e solli në vete një zë i njohur, që e thirri me emër. Ktheu pak kokën, me përtim. Në mes të turmës, në gjysmë errësirën, dalloi Luanin, një shok të punës, i cili po i bënte shenjë të hynte brenda. U mat t'i thoshte se kish një punë dhe nxitohej, po, me që s'i pëlqente të gë-

njente, ndërroi mendim, maja e gjuhës ja mbajti. Hyri brenda ashtu, pa dëshirë.

— Eja të pimë nga një kafe — i tha Luani.

Dhori nuk foli. Edhe sytë nuk i ngrinte, po i zgjati paketën. E ndezën të dy, në heshtje. Vetëm kur u porosit kafeja, foli me përtim:

— E dua me pak.

I pinë kafetë e shkumbëzuara, përballë njeri-tjetrit, në heshtje, dhe dualën. Me që kish filluar të binte shi, Luani hapi çadrën e tij, i futi krahun shokut dhe vazhduan udhën.

— Nuk u solle mirë sot ndaj Sabriut — e theu heshtjen më në fund Luani. — Besoj e kupton edhe vetë... Doemos, po të punosh keq, edhe do kritikohesh, edhe përqindja do të të pritët. Kështu është... Prandaj them se e ke ofenduar pa të drejtë.

— Edhe ai më ofendoj mua — tha Dhori.

— Mbase, po duhet të dish se ja imponove. Kemi pesëmbëdhjetë vjet që punojmë bashkë me Sabriun, po, ama nuk e njohim për njeri që të godet pas shpine, siç i the ti. E vërteta është se qëndrimi tënd flet për një çfaqje egoizmi që i bën njerëzit të futen në guaskën e tyre të vogël e të mendojnë vetëm për atë çka është e tyre, vetëm për veten... Njerëzit që vrapojnë pas interesit të ngushtë personal, s'ka se si të mendojnë për ato probleme të mëdha që preokupojnë mbarë shoqërinë. Po, kështu është!

Dhori e dëgjonte shokun në heshtje, kokëulur e duke thithur bishtin e cigares. Kjo heshtje po i pëlqente Luanit, qe një shenjë e mirë, që tregon-te më shumë nga deklaratat e bujshme. Prandaj, kur u gjendën pranë pallatit ku banonte Dhori,

i mbajti këmbët e, ndërsa i hodhi një shikim he-tonjës, i shtrëngoi dorën dhe përfundoi:

— Jam i bindur se edhe ti kështu mendon tashti, Dhori... Natën e mirë.

— Natën e mirë — shqiptoi Dhori disi i hu-tuar, dhe mori udhën që çonte në shtëpinë e tij, ashtu, me hapa të shkurtëra e të rënda. Kur u afrua, ndjeu se po i erreshin sytë. Veshët i vër-shëllenin gjithnjë më fort. Në qoshe të pallatit, mbështeti supin në murin ngjyrë kremi, pastaj kokën dhe pushtoi fytyrën me gishtërinjtë e dorës.

MALET PËRCJELLIN OSHËTIMËN

Isha kthyer nga puna dhe Lejlaja po më hidhte ujë për t'u pastruar.

— Kujdes, — i thashë, — se po m'i lag kominoshet.

Lejlaja është motra ime e vetme. Që kur na vdiq nëna e gjorë, motra na u bë nënë e mbi nënë. Tani ajo mbushi të shtatëmbëdhjetat dhe ndo një ditë do të shkojë si shoqet e saj «në shtëpinë e vet»... Plaku e do Lelën jashtë mase. Dhe kjo ka arësytet e veta, që plaku kujton se unë s'i di. Lela, nga natyra, është e urtë si qingj dhe i di të gjitha huqet e plakut. Shtëpinë na e bën dritë; pret e përcjell mikun tamam si një malësore e vërtetë. Dhe, më e madhja, ajo është nëna këmbë e kokë. Kur Lela shkon ndër dajot, plakut i bie një hie melankolie e thellë. Merr shishen e rakisë dhe shkon tek komshiu, një plakush simpatik, i mbuluar nga bora e pleqërisë. Edhe unë ndjej një ndrydhje në zemër, kur e gjej bosh shtëpinë. Shpesh, në të tilla netë jam gëdhirë mbi traktorin

tim, duke hapur tokat e reja mbi Kodrat e Për-
pjekjeve...

Si u fshiva dhe u ndërrova, i vajta babait
pranë.

— A u lodhe? — më pyeti ai.

— Jo, fort.

— Mos erdhi sekretari andej nga ju?

— Jo, pse?

— Të pyeta se ish sot këtu në fshat... si je-
ni me planin?

— Mirë, e kemi tejkaluar.

Ai m'i nguli sytë dhe qeshi nën mustaqe. Më
hodhi kutinë e duhanit. E mora të dredh një ci-
gare dhe zura të vras mendjen se ku qëllonte pla-
ku. E dija se ku i digjte qeleshja, por s'i hape-
sha. Ai donte që unë të shkëlqeja në brigadën ti-
me, të dallohesha me gisht, të kisha titull nderi
ose diçka tjetër «që të vdiste i nderuar edhe nga
i biri»... Ula kokën. Në të tilla raste më detyronte
ajo natyrë e pasur malësori të bëhesha serioz si ai,
t'i jepja edhe të drejtë.

— Dëgjo, mor bir, — më foli shtruar si një
moshatarit të vet, gjë që më pëlqente shumë. Pla-
ku i Dan Trimatës... erdhi përsëri sot...

Lejlaja u ngrit e doli në kthinën tjetër të
shtëpisë. Ajo e kuptoi menjëherë përse flitej. Dan
Trimata, shoku im, traktorist i brigadës së dytë,
ish një djalë që s'ia gjeje shokun. Nga të gjitha ç'ka
të mirë shqiptari, atij i mungonte vetëm gishti. Ku
ta dish, mund të ish edhe Dani si Trimata plak,
por prova s'kish dhënë, se ish moshatari im. Ai
ish lidhur me Lelën dhe unë këtë e dija mirë. Ve-
të Lela më ish hapur dhe unë i kisha dhënë fjalën

të rrinte e qetë, se, edhe po të kundërshtonte baba, do ta zgjidhja unë.

— Për Lelën? — e pyeta.

— Po, xhanëm, po... — ai heshti pak. Dani është djalë i mirë. Trimatajt janë të pushkës e të nderit. Me plakun e tij kemi lënë nam dikur... (ai psherëtiu), por si të them... kam diçka këtu në shpirt, as unë s'e di. Dhe sa bëhem gati t'ja jap fjalën, më thotë «nda!» dhe unë e zvarris e e bëj tërkuzë.

— Baba, fjalën tënde ne e dëgjojmë. Por... — unë e shikova buzagas e i kënaqur që po flitja kaq çiltër si me një shok, — mendoj se Lela na i ka shëruar plagët e nënës... dhe kjo.

— Ç'është ajo punë?! Vajza ka fatin e saj. Si qoftë shkruar, u bëftë!

— Të lumtë goja, baba!

Ai qeshi, unë qesha. Me siguri Lela matanë dëgjonte dhe lot gëzimi i rrëshqitnin. Motërza ime e mirë!

Heshtjen e natës e goditën tri pushkë: oshëti-ma e tyre kaloi si dallgë ajri mbi fshat, lëkundit pullazet e vogla, u përplas me forcë mbi mal dhe u kthye prapë tek ne; se atë e quajmë tonën, si trashëgim të të parëve, si një porosi të shenjtë për t'ua përcjellë brezave, si përcjellim këngët.

— Alarm, baba!

Plaku u ngrit, hapi dritaren. Nga larg u dëgjuan tri pushkë të tjera.

— Nën armë, të gjithë nën armë!... foli ai me zë të qetë. — Lelë, sillmë mauzerin!

Harrova t'ju them se im atë është pushkatar në fshat. Mua më duket se mauzerin e ka që kur ka lerë, e ka kujtim nga i ati. Me të ka luftuar

kundër turkut, kundër krajlave, kundër italianëve, e gjermanëve. Më duket se ai edhe ajo ecin gjithnjë tok si miq besnikë. Sa ish i vogël, thonë, ky rritej, ajo zvogëlohej, tani ky zvogëlohet, ajo rritet mbi supet e tij e të dy çajnë mes viteve. Por zjarrin ajo e ka gjithnjë njësoj në duart e plakut, gjithnjë plumb e shenjë.

Kështu, u nisa menjëherë për në repart dhe plakun e lashë pas. Lejlaja me ndihmës traktoristët u nisën për tek traktorët. Plaku i shoqëron ato, të paktën kështu ndodhte gjithnjë. Ai në të tilla raste ka si detyrë lajmërimin. Pastaj shkon vullnetarisht e gëdhihet me Lelën mbi traktor. Mauzeri i tij qet kryet nga kabina dhe shikon plisat e mëdhenj të përmbysur, ndërsa Lela qesh me të dhe e shikon me dhësuri atë plak njeri, që këkënaqet duke u gëdhirë me të në kabinë. E në mëngjes i thotë: «Si thua, Lelë, sonte e tejkaluam planin, a?». Këto m'i ka treguar Lela disa herë, por unë s'e lëndoј plakun se e di që ky është një gëzim femënor në shpirtin e tij.

Së bashku me fshatarët rezervistë kaluam lëndinë, dolëm në Kodrat e Përpykëve dhe u ndalëm pak tek traktori im. Dan Trimata i mbajti ndëzur «prozhektorët» e ne u grumbulluam e ndëzëm nga një duhan. Ai më tregoi se ish alarm urgjent. Brigata e dytë do të zëvendësohej menjëherë nga vajzat. U nisëm me vrap njëri pas tjetrit. Duke zbritur nga kodra me rrugë e pa rrugë, arritëm në repart. Atje, për një gjysëm ore, ishim në kolonat e batalionit dhe po i linim kazermat pas.

Artileria dhe trupat efektive kalonin me zhurmë e shpejtësi pranë radhëve tona. Kompleti

luftarak ish pak i rëndë dhe më bëri të djersitesha nën kapotën e gjatë ushtarake, ndonëse frynte thëllim nëndori. Vetëm dritat e vogla të maqinave grisnin natën dimërore, me ngricë e me acar..

Udhëtuam gjithë ato orë, natën, në të errët. Pas mesnate, me siguri, të ftohtit ish shtuar. Por ne s'e ndjenim. Ecnim në heshtje. Unë herë herë fshija djersën dhe këmbeja ndonjë fjalë me Dan Trimatën.

— Stërvitje e madhe — më thosh ai.

— Kështu duket... — hyri në muhabet një fshatar i gjatë me zë prej basi.

— Shpejtoni hapin, shokë! — u dëgjua zëri i prerë i komandantit tonë. Gjithë kollona ish si një trup i madh, gjigand, që po i zbriste një kodre për t'ju ngjitur një tjetre më të lartë.

— Shok, ma jep mua mitralozin! — i foli burri i gjatë me zë basi një tjetri aty para nesh.

— S'ka gjë, e mbaj — iu përgjegj ai.

— Bjere, të lutem, se kam ftohtë... — nguli këmbë ai duke qeshur. Na mashinkën time! Këto shpatullat e mia vetëm me këtë babaxhanin ngrohen.

Të tjerët heshtnin dhe mendonin për objektivin e përgjithshëm të stërvitjes ushtarake, për atë që duhej arritur si në kohë lufte.

Mali që është nga lindja, zbulon kryet dhe hesht. Pjesa e tij matanë kufirit duket e zymtë dhe e menduar. Ai e ka parë kolonën gjigande me qindra e mijëra herë duke zbritur si ortek prej tij duke iu ngjitur përsëri.

E lamë artilerinë me repartin xhenjer dhe u ngjitëm lart. Kolona u ndalua para një gryke. As

dhjetë minuta pushim nuk bëmë, kur komandantët e togave na shpërndanë nëpër kuadratet dhe kuotat. Urdhëri ish një, i shkurtër e i prerë: «deri në të zbardhur të hapen llogoret për gatishmëri të plotë luftarake!»

Tamam kur zbardhi, filloi një shi i ftohtë që ma ngjiste hekurin e mashinkës pas gishtërinjve. Xhvesha kapotën, e hodha mashinkën krahaqafë dhe u pështeta buzë llogores së porsahapur. Nën këmbët e mia filloi të rrjedhë një vijë uji tërë glinë nga e tokës së porsapunuar. Asnjeri nuk lëvizte nga vëndi.

Nga dreka, në pozitë tona u dukën komandanti e komisar. Komisar ish njeri popullor, shakaxhi e i dashur. Dy herë isha takuar me të dhe më njihte e më thërriste në emër. Kur kaloi pranë meje, i ngadalësoi pakëz hapat dhe m'u drejtua buzagaz:

— Flamur, ku e ke armën?

— Këtu, shoku komisar! — unë i zbulova tytën e mashinkës në kapotë.

— Ku e paske futur, or derëbardhë... — qeshi ai.

— Më detyroi shiu — shoku komisar.

— Shoku komandant, — i foli ai komandantit, që diç po bisedonte me mitralierin e skuadrës. Ai ktheu kokën sakaq. Ky është djali i atij...

— Ç'thua, more! Hajde, hajde me ne, shoku ushtar! — më thirri komandanti. Unë u ngrita nga llogorja e u shkova pas. Po i uleshim kodrës mes shkurresh e lisash që më spërkatnin fytyrën me ujë shiu. Ata po bisedonin me terma ushtarake. Disa prej tyre nuk i merrja vesh. «Kuadrati 5 ..., kuota e parë..., pika III MLK» — thosh

komisari. «Mundet, do e shikojmë edhe njëherë» — aprovonte i qetë komandanti.

Ne ecëm mjaft dhe na doli parasysh prapavija me nënrepartin e sanitarkave. Punën e repartit xhenjer vazhdonin ta kryenin një përzjerje moshash nën kapotë ushtari. Buzë përroit, pranë burimit, kishte shumë pleq që ja kishin shtruar muhabetit. Sa panë komandantin dhe komisarin e brigadës, ata u ngritën me këmbë dhe njëri, një burrë në moshë, u paraqit. Pastaj u ulën të çkujdesur tek ishin më parë. Pleqtë ishin të paveshur me kompletin ushtarak. Ata kishin vetëm kapotat. Shiu kish ca që kish pushuar. Armatimet e tyre ishin njësoj me tonat, veç një dallim: në asnjërin prej armëve të tyre s'kish rënë pikë shiu... Kjo më ra në sy menjëherë nga rrypat e thatë, sikur të kishin dalë atë çast nga depoja. E dallova nga larg plakun tim, që rrinte mbi një gur dhe mbante mauzerin e tij me tytë drejt qiellit, sikur të ish gjithë lavdia dhe jeta e tij. Rrinte serioz e i menduar. M'u duk më simpatik e i dashur se çdo herë tjetër. Kur më pa, përdrodi mustaqen dhe mua më erdhi për të qeshur. Komandanti ndaloi punimet dhe grumbulloi dy kompanitë buzë përroit. Nisi të bisedojë shtruar me njerin e me tjetrin, të hedhë e të presë edhe ndonjë shaka. Komisari tha:

— Si e shihni, mes jush kemi edhe veteranët. Mbrëmë, kur u dha alarmi, xha Sulua me thirrjen: «Nën armë, burra!» solli edhe këta në repart. Komandanti desh t'i kthente në shtëpi, por s'ish punë me ta. Ata na kërkuan armë me këmbëngulje. Dhe ne ua dhamë, se s'patëm si t'ja bëjmë. Ja ku i kini në mes tuaj.

Katër maqina të prapavijës ishin mbushur plot me veteranë. Mes tyre ish edhe plaku im me mauzerin e tij, që tani po e mbante me tytë drejt qiellit.

Në heshtjen e asaj mbledhjeje, nën tingullin e kristaltë të fjalës së komisarit, unë dallova zhurmën e traktorit tim që vinte nga larg, ku Lela vazhdonte punën. Lëmoja grykën e mashinkës dhe shikoja tim atë, që mbante tërë krenari atë mauzerin e tij shekullor... Duke shikuar plakun, unë mendoja: «atje tej është Lela jonë, me të atdheu dhe të tre ne jemi tri pika të një fronti të vetëm...». Sytë e komisarit më bënë të ul kokën, se më gjeti krejt të harruar në mendimet e mia. Ai qeshi me gjithë shpirt me sjelljen time femi-nore dhe përsëri vazhdoi të flasë, jo më për stërvitjen, por për njeriun...

MISIONI I SKUADRËS

Vuuu, vuu, viuu, ulërinin degët e xhveshura të mëllezave, valanidheve, bulgerave e shkozave dhe majat e tyre përlesheshin e goditeshin si të ishin në një betejë për jetë a vdekje. Zefiri, si i tërbuar, grumbullonte flokët e dëborës, i pëlcsite mbi degët e xhveshura, i ngjishte në rrëzat e vidheve, shkëmbenjve dhe shkurreve; më në fund, dëbora ngrihej kulme-kulme dhe të dilte përpara si vigan. Ajo natë dukej sikur do të përpinte jo vetëm kafshët e shpendët e gjalla mbi tokë, por edhe shkurret e malet. Partizanët, të grumbulluar rrëzë Shkëmbit të Kuq, përpiqeshin, shtrëngoheshin e ngjisheshin me njëri tjetrin. Herë pas here dëgjoheshin të çfryra, kërcitje dhëmbësh, por pushkët, automatikët e mitralozët i mbanin fort në gji, sikur ato hekura të ngrira i ngrohnin, u jepnin jetë e kurajë.

Komisari i batalionit kishte kaluar disa herë nga njëri cep i shkëmbit tek tjetri, e, duke i prekur me dorë ato hje të zeza, ndjente në heshtje frymëmarrjen e tyre dhe aty këtu të kërciturat e

dhëmbëve! Psherëtinte thellë dhe kthehej prapë në cepin e shpellës së ftohtë. Më në fund, nxorri orën nga xhepi dhe e shikoi; ishte shtatë!

«Është gëdhirë, — tha ai me vete, — por akoma nxin, nuk dallohet mirë!» U ngrit në këmbë, hodhi automatikun në sup dhe kapota e murme i kërciti si ndonjë kërce akulli kur i vë këmbën! Shkoi edhe një herë buzë shpellës, të gjithë partizanët rrinin të kruspullosur e të ngjeshur me njeri tjetrin; fytyrat e tyre ishin të nxira e të jeshilosura, por sytë u ndrinin, dukej sikur i thonin: «Të hidhemi në luftë, është më mirë të përfytemi me armikun se sa të ngrijmë nga shtërgata, pagjumësia e uria!»

— Si janë gëdhirë shokët? Ka ndonjë të sëmurë? Mos kanë ngrirë? — pyeti ai komandantin e kompanisë së parë, Muhametin.

— Jo, shoku komisar; të gjithë gjallë, por këmbët e duart u kanë ngrirë, janë pesë të sëmurë nga barku, dhjetë janë të zbathur dhe i kanë lidhur këmbët me lecka! Komisari uli kokën dhe shkoi prapë në cepin e shpellës. Ai u ul mbi një gur, vuri të dy bërrylet mbi gjunjë dhe mbështeti duart në faqet.

«Armiku, — tha me vete, — i armatosur gjer në dhëmbë dhe i ndihmuar nga ballistët e tradhëtarët, ka zënë të gjitha qendrat, fshatrat e rrugët! Ne jemi të rrethuar, depot dhe vendet e furnizimit i kanë zënë ata! Partizanët kanë dy ditë pa ngrënë asgjë, shumë prej tyre janë xhveshur e zbathur dhe mbi të gjitha po na mbyt furtuna, dëbora, e rrebeshi, duhet të luftojmë edhe me natyrën».

Ngriti kokën dhe duart iu lëshuan mbi gju-

një. Shikoi anash, shkëmbinjtë e shkurret uturin, rrebeshi nuk po ndalej. Për të çarë përpara duheshin trupa të fortë, të veshur e të shëndoshë. Ishte vështirë, shumë vështirë, të sulmoje në atë gjendje!

«Duhet të bëj lidhje me forcat e tjera të batalionit, me komandantin e batalionit», — mendoi ai përsëri. Ata ishin shumë larg, në majën e Stravastroit! Atje rrebeshi ishte edhe më i fortë. Por, për të përbulluar situatën duhej të viheshin në dijeni, të kombinohej goditja dhe të shpartalloheshin forcat armike, që ishin grumbulluar në fshatin Leskaj.

— Hasan! — I foli ai komandantit të kompanisë së dytë. — Cilin nga skuadër komandantët ke më të fortë fizikisht dhe më të guximshëm që të kalojë Qafën e Sqepurit dhe të mbërrijë deri në sër në mbrëmje në Malin e Stravastroit?

— Po, ja... — hapi gojën Hasani i menduar. — Rabushja. Ajo vetë dhe skuadra e saj kanë dhënë prova dhe kanë kaluar me guxim shumë raste në luftë dhe në vështirësi të natyrës! Ajo është komuniste.

— Po, po, e njoh. Ajo është e fortë, trime dhe rezistente. Po, sa partizanë ka në skuadër?

— Ajo është vetë e tetë, ka dy mitraloza, shumë herë i kam dhënë automatikun, por ajo nuk pranon dhe mban vetëm mitralozin italian; po ashtu ka edhe Piron me mitraloz sharrës.

— Foli pak Rabushes të vijë! — i tha më në fund komisari, dhe mendimi i kaloi tej në horizont, në Qafën e Sqepurit. — Vallë do të jetë zënë nga armiku, — pëshpëriti ai me zë të ulët.

— Urdhëro, shoku komisar, — u paraqit Ra-

bushja, vuri mitralozin pranë këmbës dhe po qëndronte si gjigande para komisarit.

— Shiko Rabushe, — foli ai me zë të ulët por të kjartë, — ti me skuadrën tënde do të kryesh një detyrë shumë të rëndësishme. Them të rëndësishme sepse nga zgjidhja e kësaj detyre, varet fati i forcave të batalionit! Do ta kini vështirë, jo vetëm nga ndeshjet me armikun, ku do t'u duhet të çani rrethimin me luftë, por do të kini edhe një luftë të rëndë me natyrën, tufani e rrebeshi mund t'ju çorientojnë, mund të humbisni edhe rrugën! Pra ky mision kërkon nga ti, si komandante, kujdes, guxim dhe vendosmëri! Misioni duhet të kryhet sikur edhe një partizan të mbetet!

— Si urdhëron, shoku komisar, jam gati ta kryej këtë mision së bashku me të gjithë partizanët e skuadrës sime!

— Mirë, Rabushe, shko mblidh skuadrën dhe komunikoi urdhërin. Pyeti se mos ndonjëri është i sëmurë dhe nuk vjen dot.

Rabushja kapi mitralozin me dorën e djathtë dhe e hodhi në sup si të ishte një shkop druri, këmba e saj shkeli mbi dëborë dhe vazhda mbeti si gjurmë ariu.

Komisari tundi kokën i kënaqur dhe pëshpëriti me vete: «Rrallë gjen vajza të tilla. Sidoqoftë, vetëm kjo mund ta kryejë këtë mision të vështirë!» Mori çantën, nxorri andej bllokun dhe kapi lapsin të shkruante, gishtrinjtë i kishin ngrirë, por u mundua të mos binte në sy. Ai shkroi: «Shoku komandant i batalionit, situata që është krijuar po e vështirëson çdo ditë e më shumë gjendjen e partizanëve të kompanive që janë këtej! Ne po

thuaj kemi mbetur të rrethuar, gjermanët e ballistët kanë zënë gjithë fshatrat, rrugët dhe grykat; ne jemi grumbulluar në grykën e Shtogut, në rrëzën e Shkëmbit të Kuq; jemi krejt të izoluar, vendet e furnizimit, depot dhe bazat e ushqimit janë zbuluar dhe kapur nga armiku! Partizanët kanë dy dit pa asnjë farë ushqimi, dëbora dhe stuhia na kanë penguar dhe nuk luajmë dot në asnjë drejtim. Partizanët janë mërzitur dhe kërkojnë patjetër të sulmojnë armikun! Merrni masa, dhe më datën 14 shkurt, në ora 5 të mëngjesit — pasnesër — ne do të sulmojmë forcat gjermano-balliste që janë grumbulluar në fshatin Leskaj, në jugë lindje, në drejtim të lagjes Çorraj, kurse ju të sulmoni nga ana e veri-perëndimit, në drejtim të lagjes Osmëzez, sulmi do të fillojë pikërisht në orën pesë të mëngjesit! Vonesa shkakton fatkeqësinë tonë.

Përqaftime «Grepi».

Rabushja mori letrën dhe e futi në xhepin e bluzës së murme gjermane. Komisari ja përsëriti edhe një herë përmbajtjen e letrës, u ngrit në këmbë, u përqaftua me Rabushen, i uroi udhë të mbarë dhe sukses në detyrë, pastaj i përqaftoi një nga një të gjithë partizanët e skuadrës dhe, më në fund, u ndal me Rrapushin e vogël. Ky ishte një topolak, një metro e gjysmë i gjatë, kish veshur një bluzë të madhe, e kishte lidhur mbi bel dhe të dyja mëngët ja kishte palosur deri në bërryl, faqet i skuqnin si dy kokrra mollë, sytë e zez e të vegjël i ndrinin, ishte pushtëjtur nga të ftohtit, por dukej i vendosur! Në sup mbante një

automatik të shkurtër gjerman dhe një çantë me karikatorë.

— Rrapush! — i foli komisari dhe e kapi për dore — a nuk është mirë që ti të rrish këtu me mua dhe këtë detyrë ta kryejnë këta të shtatë? Këta janë mjaft, është rrugë e gjatë dhe e vështirë... — dhe për të mos e ofenduar, ai shtoi, — ti do të më duhesh edhe mua për korier, se je i shpejtë!

— Jo, shoku komisar, — tha ai me një zë të vendosur, fytyra iu vrejt dhe mori një qëndrim serioz, — unë do të shkoj me skuadrën time, nuk dua të ndahem nga shokët!

Komisari, kur pa se ai ishte i vendosur dhe nuk hiqte dorë nga e tia, e kapi, e pushtoi të tërin, e puthi sikur ta kishte fëmijën e tij dhe i tha:

— Hajt, pra, ti ke vendosur të shkosh me shokët, udhë e mbarë!

Skuadra u nis! Para tyre shkante Rabushja si gjigande, mbas saj vinte Pirua, edhe ai ishte i fortë e i pjekur; pas tyre, partizanët e tjerë me radhë deri tek Rrapushi. Ata nuk ishin as të një moshe, as të regjur njësoj në vështirësi, por ishin stërvitur në përpjekje e në betejat partizane, ishin të edukuar nga partia, të gatshëm për të kryer atë mision aqë të domosdoshëm, por me shumë rreziqe!

Komisari nguli këmbët, mbërtheu të dy duart në rrypin e mezit, mori frymë thellë, i mallëngjyer e me lot në sy. Mendonte në se do t'i takonte më Rrapushin e shokët e tij! Skuadra u tret tej në tymin e mjegullt të dëborës. Ai akoma nuk i kishte hequr sytë andej!

Ata ecnin përpara, dëborën e çanin me gju-një, mposhtnin me gjokin stuhinë që e ngrinte dëborën me ngulm kulme kulme dhe ua përplaste në fytyrë. Rrapushi dhe Hekurani, disa herë rrëshqitën dhe u ngjeshën në dëborë, por prapë u ngritën dhe vazhduan rrugën me shokët.

Po nga do të shkonin? Të gjitha shtigjet ishin zënë! Duhej të ngjiteshin brinjës së Malit të Bardhë, vetëm andej mund të mos ndesheshin me armikun! Duhej të kalohej Gryka e Shtrigave: se aty nuk kish forca gjermane, atë e ruanin vetëm mercenarët e fshatit. Por papritur, ky plan u ndryshua. Rrapushit dhe Hekuranit, sa shkuan në mes të brinjës së malit, u rrëshqitën këmbët dhe, ashtu të mbështjellë me dëborë, nuk qenë në gjendje të mbaheshin, rrëshqitën gjer në fund të Përroit të Ujqërve, afër fshatit Tërbuq, që ishte pushtuar nga forcat armike! E gjithë skuadra u detyrua të kthehej dhe të pasonte ata të dy.

Para tyre ishte roja gjermane; ai përpiqte këmbët nga të ftohtit. Kur dëgjoi zhurmën, u zgjat përgjysmë, por tymi e reja e stuhisë nuk e lejuan të shikonte, ai vazhdoi të ecte poshtë e lart duke përpjekur këmbët. Ç'të bënin? Duhej patjetër të asgjësonin rojen, të shkonin anës e anës fshatit e, duke përfituruar nga stuhia dhe mjegulla e dëborës, të ngjiteshin përsëri në brinjën e Derrave për të kaluar Grykën e Shtrigave!

Ushitari gjerman, që bënte roje në shtegun e Përroit të Ujqërve, duhej të asgjësohej! Po ta vrisje, bëhej alarm dhe skuadra ishte në rrezik. Pra,

duhej kapur ose asgjësuar me gëditje pa zhurmë. Për kryerjen e këtij aksioni u nisën Rabushja dhe Pirua; shokët e tjerë zunë vend në buzën e përroit. Ishte vështirë, shumë vështirë ta kapje rojen në atë buzë përroi ku kishte vetëm një shteg të ngushtë që të çonte atje!

Rabushja para e Pirua mbrapa u nisën këmba-dorës. Rrapushi u fut në një shkurre dhe, me anën e shenjave, u tregonte atyre, kur vinte dhe kur kthehej roja. Ata u zvarritën një orë të tërë dhe, më në fund, arritën në anën tjetër të përroit, u vendosën mbrapa një guri. Ishin vetëm dy metra nga vendi ku kthehej roja. Zemra u rrihte dhe sytë u ndrinin! Rrapushi dha shenjën se roja po afrohej. Roja erdhi te guri dhe u kthye. Ajo iu hodh. Me dorën e majtë e zuri për fyti dhe me dorën e djathtë i nguli thikën në sisën e majtë. Roja, që ishte me duar në xhepa dhe me pushkën në krah, nuk qe në gjendje të bënte as një rezistencë! Pa humbur kohë, ata i hoqën armët, çizmet e të gjitha pajimet dhe e hodhën sakaq në greminën e përroit, ku bëri dy tri përplasje dhe pastaj humbi në humnerë!

— Hajdeni, shokë, të shkojmë sa nuk është vonë! — Urdhëroi ajo shokët dhe vetë shkoi përpara.

Rabushja i njihte mirë ato male e gryka, se kishte shëtitur me bagëti dhe i tërhoqi me kujdes shokët anës së fshatit, në Brinjën e Derrave dhe, më në fund, pa u diktuar, kaluan edhe rrezikun e dytë: Grykën e Shtrigave! Po rreziku kryesor akoma mbetej Qafa e Sqepurit! Ata vazhduan rrugën. Automatikun gjerman me gjashtë karikatorë e kishte hedhur krahaqafë vetë Rabushja

dhe u printe përpara shokëvet. Pas shumë mundimesh, aty nga mezi i ditës, arritën në Qafën e Sqepurit. Ajo ishte e lirë, armiku nuk e kishte zënë! Skuadra u hap në formacion dhe zuri pozicione në vendin më dominonjës.

3

Dita po kalonte. Pirua shikoi orën: ishte njëmbëdhjetë. Stuhia kish mbetur, por dëbora ishte shtuar akoma. Tashti binin flokë të mëdhenj dhe të qetë. Gjithçka zbardhte. Ajo bardhësi t'i lbyrte sytë dhe nuk ishte në gjendje të shikoje as dhjetë metra larg! Rabushja zuri pozicion mbrapa një guri, vendosi mitralozin në drejtim të grykës dhe filloi të vrojtojë përpara.

— Po ta kalojmë këtë qafë, do të kemi... — ajo e preu fjalën përgjysmë, ngriti dorën dhe u dha urdhër shokëve të ishin gati për zjarr! I shikoi prapë. Fshiu sytë, që i qenë mbuluar me flokë dëbore. Ata që lëviznin ishin ushtarë gjermanë të veshur me rroba të bardha dëbore. Këtë ata e kishin bërë shumë herë kur kishin sulmuar partizanët në dëborë. Ata ishin një skuadër e hapur në formacion luftarak. Koha nuk priste. Ishin shumë afër! Ç'të bënin? Të hiqeshin mbrapsht dhe të merrnin rrugën nga kishin ardhur? Jo! Kjo do të ishte shumë e rrezikshme, se gjermanët do të zinin pozicione dhe do t'i asgjësonin! Po komisari i porositi që, sa të ishte e mundur, t'i shmangeshin luftës! Ajo vendosi! I ktheu sigurecën mitralozit, hoqi të dy granatat greke, i bëri gati dhe i vërviti përpara njerën pas tjetrës. Skuadra ar-

mike e pararojës u asgjësua gati e tëra, por armiku nuk u zbraps. Forcat e tij të tjera u hapën në formacion luftarak dhe marshuan përpara për të zënë qafën.

Partizanët, të vendosur, pritën gjersa forcat armike u futën plotësisht nën rrezën e të gjitha armëve; megjithëse armiku rrahu qafën me murtaja dhe mitraloza, partizanët nuk luajtën. Zjarri i armëve të skuadrës e dëmtoi rëndë armikun; qendra e forcave, që nuk ishin fort në formacion lufte, u asgjësua e tëra! Ata u tërhoqën, por edhe skuadrës iu mbaruan fishekët! Në skuadër u vra Zeqiri dhe u plagos rëndë Hasani. Situata u keqësua më tepër për partizanët.

— Piro! — thirri me një ton urdhërues Rabbushja, — merr dhe Hasanin dhe tërhiq shpejt me skuadrën, nisuni nga rruga që erdhëm. Para se të kaloni në Grykën e Shtrigave, kthehuni nga ana e djathtë dhe takohemi në shtëpinë e Meçajve, në drejtim të shkëmbit të Bletëve.

— Pooo — zgjati zërin Pirua.

— Vepro shpejt! S'ka kohë për diskutime!

Pirua hodhi shokun e plagosur në krahë dhe mori rrugën, por shokët e tjerë po nguronin dhe nuk donin të luanin nga vendi.

— Ç'prisni, shokë? Nisuni shpejt! Unë do të hedh edhe granatat e fundit, do të largoj edhe njëherë forcat armike dhe do të nisem mbrapa jush!

Të gjithë u nisën; Pirua shkante përpara dhe shokët e ndiqnin nga mbrapa. Hasanit i shkante gjak, i varej mbi bluzë dhe i rrëshqiste mbi dëborë. Shokët, që vinin mbrapa, hiqnin dëborën e

skuqur dhe e hidhnin larg, por prapë gjurmët e gjakut mbeteshin.

Rabushes i ishin mbaruar granatat, kish vetëm edhe një karikator me fishekë mitralozi. Shikoi shokët. Ata po largoheshin. Iu afrua Zeqirit, ai kishte edhe tri granata. Ja zgjidhi nga rrypi, e tërhoqi mënjanë, e mbuloi me dëborë dhe doli shpejt në pozicion. Forcat armike ishin afruar shumë.

— Po! — pëshpëriti ajo me vete. Hodhi granatat njerën pas tjetrës në grumbullin e armiqëve, dogji edhe fishekët e karikatorës, e futi mitralozin thellë në rrëzën e një shkurreje dhe u largua shpejt në drejtim të shokëve. Te shtëpia e Meçajve u bashkua me ta.

— Si të bëjmë tashti? — u tha ajo shokëve. — Hasani është plagosur rëndë. Tre shokëve u janë shkatërruar opingat dhe u janë enjtur këmbët. Qafën e Sqepurit nuk e kaluam; përpara, në fshat, janë gjermanët, nga mbrapa po na ndjekin forcat gjermane dhe ato nuk janë shumë larg! Ka mbetur vetëm një rrugë: t'i ngjitemi pjerrësisë së malit të Thatë. Ne shokë, — theksoi ajo më në fund, — do ta lemë Hasanin në rrëzën e shkëmbit, në atë shpellën e vogël, do të lajmërojmë të zonjën e kësaj shtëpie të kujdeset për të. Ne duhet të nisemi, të kalojmë medoemos, edhe sikur një të mbetet, duhet të kryejmë detyrën!

Ata të gjashtë u nisën brinjës së malit të pjerrët, i cili ngrihej mbi ta si vigan dhe shquante si një re e bardhë e shkëputur nga toka. Gurët e shkurret nuk dukeshin, rrugë nuk kish, ata duhej të ecnin me duar e me këmbë! Ajo u nis dhe mendonte me vete:

«Po, të gjithë janë raskapitur! Si duket, po i lënë forcat, kanë dy dit pa ngrënë, gati të gjithë janë zbathur, rruga tashti po vështirësohet edhe më, ky ma! është vështirë, shumë vështirë të kalohet! Po ç'të bëjmë? Ne do të vazhdojmë rrugën, këtej kemi vetëm rrezikun e dëborës, të ftohtit dhe urisë, por dikush nga ne do të arrijë në malin e Stravastroit».

Ashtu, me këmbë e me duar, mbas tre orësh ata kaluan Qafën e Shkulkës dhe arritën në rrëzën e Shkëmbit të Dhelprës.

— Këtu do të ndalemi për të gdhirë natën, — tha ajo. — Të tjerët nuk u ndien, por u shëmbën ashtu si ishin, trupi u dridhej sytë u qenë errur dhe toka u erdhi rrotull.

— Piro, — tha ajo mbas disa minutash, — ne duhet të ndezim zjarr, përndryshe kemi për të ngrirë të gjithë! Këtu jemi jashtë rrezikut. As gjermanët, as ballistët nuk ngjiten dot.

4

U gëdhi dita e dytë. Stuhia dhe dëborë kishin pushuar, qielli ishte kthjelluar, rrallë shikoje ndonjë re që vraponte në drejtim të jugut, dëborë kishte ngrirë si çimento, kallkanët buzë shpellës dukeshin si krokodilë të radhitur buzë lumit. Era e veriut t'i shponte mushkëritë. Rabushja pa me radhë të gjithë shokët. Ata rronin, por dita e re ishte edhe më e vështirë, dëborë e ngrirë, do t'ua priste më tepër lëkurën e këmbëve. Ishin të gjithë zbathur.

— Piro, — thirri ajo me një zë që i dridhej, — hajde, ti e njeh vendin këtej. — Dhe të dy dualën në bregun e shpellës ku vëndi shihej më mirë. — Dëbora ka ngrirë, rrugë këtej nuk ka. Duhet të kalojmë! Nga është më shkurt?

— Shoqja Rabo, në këtë brinjë as në verë nuk kalon njeri, përveç ndonjë bariu dhish. Ka shumë përrenj dhe kurrize; do jetë zor t'i kalojmë, zor do ta kemi të arrijmë në qafën e malit dhe, po të mbetemi, është shumë vështirë të kalohet nata në atë brinjë të shkretë.

— Duhet të nisemi, Piro, — theksoi ajo, — duhet t'u japësh kurajë edhe shokëve të tjerë, të kesh kujdes Rrapushin, Hekuranin e Shaqon, ata janë të rinj, forcat i kanë lënë dhe duket se nuk do të kenë mundësi t'i kalojnë ato vështirësi.

— Por edhe këtu t'i lemë, ata prapseprapë do të vdesin, më mirë të vinë me ne, ne do t'i ndihmojmë, — tha Pirua.

— Po, Piro, ata do të vinë me ne; ne të dy jemi komunistë, na ka kalitur Partia, ne duhet të rezistojmë, duhet t'i ndihmojmë edhe shokët gjer në fund. Nisemi! Duhet zbatuar urdhëri, rrugë tjetër s'ka!

Skuadra ecte përpara, me këmbë e me duar, asnjëri nuk ndihej! «E kaluam një përrua dhe dolëm në bregun tjetër», tha me vete Rabushja, por pa e mbaruar mirë mendimin, para saj doli një e pjerrët, që ishte e pamundur të kalohej pa rrëshqitur. Filluan këmba-doras, por nuk ishte e mundur, të gjithë rrëshqitën, dhe, pa u mbajtur dot, ranë në fund të përroit. Për t'u ngjitur ishte edhe më zor. Ashtu, ngreu e plasu, këmbët u

ishin rrjepur dhe gishtërinjtë e duarve u ishin çarë!

Dita kishte arritur në mes. Dielli dukej sikur udhëtonte i lodhur midis një tyli të hollë reje që skuqte si ndonjë trëndafil vjeshtak. Era e veriut ta priste fytyrën si me thikë. Sa dilte avulli nga vrimat e hundës, ngrinte. Ata fërkonin vazhdimisht hundët që u bllokoheshin nga ngrica. Ishin akoma larg, shumë larg, nga objekti ku do të arrinin! Rruga vazhdonte. Të gjithë i hidhnin këmbët me vështirësi. Pothuajse asnjeri prej tyre nuk kishte opinga, këmbët u ishin enjtur, fytyrat u ishin nxirë dhe buzët u ishin trashur! Mbrapa u dëgjua një e rrëshqitur dhe një rënkim i mbytur! Të gjithë kthyen kokën. Rrapushi i vogël ishte rrëzuar përmbys mbi dëborë! Shokët u kthyen ta merrnin, por edhe ata ishin të këputur.

— Oh, më lini, mos më luani, nuk lëvis dot, dua të fle, jam shumë i lodhur! — u lutej ai.

Rabushja shikoi një herë nga shokët. Ata ishin të lodhur, asnjeri nuk tregonte gjallëri. Ajo e kapi Rrapushin, e hodhi mbi shpatullat e saj të gjëra dhe çau prapë përpara. Por pa kaluar mirë përruan, një rënkim tjetër u dëgjua. Pirua u kthye, Hekurani ishte rrëzuar dhe nuk ishte në gjendje të luante; rrotulloi sytë dhe buzët iu nxinë, duart dhe këmbët i ishin enjtur, trupi i dridhej dhe zemra i punonte shumë ngadalë. Pirua e hodhi atë mbi shpinë dhe të gjithë vazhduan rrugën. Po tashti rruga ishte bërë akoma më e vështirë. Në përruan tjetër rrëshqitën të gjithë dhe ranë në fund. Pirua dhe Rabushja i nxuarën me zor në bregun tjetër, por aty nuk vonoi e u rrëzua pa ndjenja edhe Shaqua.

— Oh, mos më luani, nuk kam më fuqi, sytë m'u veshën dhe dua të flë! Më lini këtu në rrëzën e këtij shkëmbi dhe nesër ejani më merrni, — tha ai dhe humbi në kllapi!

Ata u ulën të gjithë. Rabushja e Pirua këmben vështrimet. Si të bënin? Ata nuk e kishin gjetur asnjëherë veten aq ngushtë sa në këtë çast. T'i linin shokët në vend?! Kush do t'i ndihmonte? Ishte e qartë që nuk mund të rezistonin gjer të nesërmen. Po të qëndronin edhe ata aty, duhej të dështonte misioni, urdhëri nuk do të zbatohej! Kjo ishte e tmershme dhe nuk duhej të ngjiste.

— Piro, — i tha më në fund Rabushja. — Ne jemi komunistë! Ne kemi marrë urdhër nga Komisari. Ai na foli të dyve me gjuhën e Partisë, u mendua shumë kur na dha urdhërin të nisehim. Ne duhet të dimë se nga forcat tona, nga guximi ynë varet fati i të gjithë partizanëve të batalionit. Ne sot duhet ta shpiem në vend letrën.

— Po, Rabo! — Ne duhet të shpëtojmë shokët. Mund të humbasim tre, por jo një batalion. Duhet të dalim nga kjo humnerë, të paktën deri në mbrëmje. Atje në qafë është një stan bagëtish; ata janë njerëz të mirë, janë të lidhur me partinë, do të na ndihmojnë.

— Po me shokët si do të bëjmë? — Ata vështruan edhe një herë në sy njëri tjetrin, por nuk u ndien. Nuk ishte e lehtë të ndaleshe i gjallë me shokët e luftës.

— Nuk ka si të bëhet ndryshe, — shtoi më në fund ajo, do t'i lemë të tre rrëzë këtij shkëmbi, t'u shtrojmë gjethe dhe t'i vendosim për krah njëri tjetrit, kështu mund të ngrohën dhe të jetojnë

gjer nesër. — Ajo psherëtiu dhe iu drodh trupi.

Ata mbetën vetëm tre. Tashti duhej të ndaheshin edhe prej tre shokëve dhe të udhëtonin prapë asaj brinje të thepisur! U përkulën me radhë dhe i puthën në buzë e në faqet e ftohta si kufoma. Por ata rronin akoma! Të dy shokët, të mbuluar nga lotët, u kthyen të vazhdonin rrugën, Rabushja i puthi me radhë dhe u ndal te buzë e ftohta të Rrapushit. Një e dridhur e fortë i përshekoi trupin, sytë iu veshën dhe buzët iu drodhën. I kaluan para syve vuajtjet dhe jeta e tij. Ata kishin patur të njejtin fat, ishin rritur hyzmeqarë në dyert e të tjerëve, nuk kishin parë asnjë ditë të bardhë. Edhe në luftë, që ditën e parë, atyre të dyve u kish rënë fati të ishin bashkë, në një skuadër. Dhe ja, tashti Rabushja duhej të ndahet dhe ta linte atë të gjallë në rrëzën e atij shkëmbi të shkretët, të ngrirë e gjysmë të vdekur! E puthi edhe njëherë dhe lotët e saj ranë mbi faqet e vogëlushit. Hoqi kapotën e saj dhe i mbuloi të tre, i shtrëngoi me njëri tjetrin.

U kthye të ikte, por këmbët sikur i ishin lidhur dhe nuk i luante dot. Sa dëshironte të qëndronte aty, me ata tre heronj që po e pinin jetën për liri, për Atdhe! Të jetonte ose të vdiste bashkë me ta! Por ajo ishte komuniste!

«Komisari disa herë na ka thënë se komunistët duhet të jenë të fortë, të vendosur, guximtarë, të përballojnë me vendosmëri çdo vështirësi dhe të mos përkulen ballë çfarëdo rrebeshi, po të çajnë përpara!» — përsëriti ajo me vete dhe sikur mori kurajë, nguli këmbët dhe deshi t'u jepte përpara. Por prapë iu duk sikur këmbët i dhimbnin, sikur nuk ishin të sajat! Ktheu kokën të

shikonte shokët për herë të fundit. Fytyrat u ishin nxirë e jeshilosur, si akulli kur shkrin e mbetet vetëm një kërce. Vështroi një herë këmbët e saj: ato ishin enjtura. Gishtrinjtë e lëkurra i qenë çarë dhe i rridhnin ujë të verdhë. U drodh e tëra. «Po sikur të mbetem edhe unë? Kush do ta shpjerë letrën?» Mori guxim dhe hodhi hapin.

— Nesër ejani të na merrni, — u dëgjua një zë si nga varri.

Ajo u drodh e tëra, sikur të ishte zgjuar nga gjumi. Ktheu kryet andej, Shaqua kish ngritur kokën dhe e përplasi prapë mbi gjethet e ftohta!

«Nesër ejani të na merrni!» Domethënë ata kanë shpresë të jetojnë gjer nesër! — përsëriti ajo me vete dhe sa nuk u rrëzua mbi dëborë.

5

Nisemi, shoqja Rabo! — tha Pirua me një zë të prerë dhe urdhërues që e pruri atë në vete.

— Po! — tha ajo e vendosur. Hodhi automatikun në krah dhe zgjati hapin.

Ata u nisën, por nuk dihej në se do të mund t'i kalonin edhe ata tre përrenj e ato brigje? Die-lli ishte kthyer nga ana e perëndimit, retë e holla ishin skuqur edhe më, era e veriut vërshëllente më fort dhe ishte bërë më e ftohtë, drurët e xhveshur të pemëve e shtuan edhe më uturimën dhe majat e tyre përkuleshin deri në tokë. Dëborë kërciste nën këmbë dhe ciflat e saj çanin gishtrinjtë e këmbëve të zbathura e të raskapitura të të tre partizanëve që çapeshin me zor.

— Oh, më jepni dorën, o shokë! — thirri me zë rrënqethës Leskua. Ai kish shkarë dhe ishte varur përgjysmë në buzën e një shkëmbi.

Pirua, që ishte më afër, u zgjat shpejt, e kapi nga qafa e bluzës dhe e ndihmoi të ngjitej.

— E kalova edhe këtë rrezik, — tha Leskua dhe përpoqi sytë.

— Lavdi shokëve, o Lesko, — ja priti Pirua si me të qeshur.

«E kaluam edhe këtë greminë, — mendoj me vete Rabushja, — dualëm në bregun tjetër. Kemi edhe dy brigje. Forcat po na lenë, po sikur edhe me thonj e me dhëmbë të kacaviremi, ne do të arrijmë në qafë», — tha ajo duke shikuar qafën përtej.

Shumë herë ata rrëshqitën deri në fund të përroit dhe u ngjitën me thonjtë e këmbëve e të duarvet! Tashti u rridhnin ujë të verdhë jo vetëm këmbët, por edhe duart. Thonjtë e gishtrinjtë të duarve e të këmbëve u kishin luajtur nga vendi. Nga të enjturit, gjaku ishte larguar, por ata ecnin, ecnin me shpirt në dhëmbë. «Komunistët nuk mposhten para vështirësive!» — i fishkëllinin në vesh fjalët e komisarit, dhe Rabushja i përsëriste nëpër dhëmbë.

6

Dielli kish perënduar. Brinjën e malit tashi e zbardhoni rrezet e hënës, dëbora shkëlqente si kristal. Thëllimi ishte bërë dhe më fshikullonjës, por ata nuk e ndjenin, ishin mpirë!

Ashtu të mpirë e të gjymtuar, e ngjitën edhe greminën e përroit të fundit. Dolën në breg. S'u

kish mbetur pikë fuqie! U përplasën mbi baltën e kuqe, që sa ishte çliruar nga dëbora. Këmbët e duart nuk i luanin dot, buzët e gjuha u ishin trashur! Kasollja e barinjve nuk ishte shumë larg, ndo njëqind hapa, por ata nuk nxirrnin dot as edhe një fije zëri. Barinjtë sa kishin mbështjellë bagëtinë në vathë dhe po ndiznin zjarrit. As qentë nuk i kishin lëshuar.

Pirua u ngrit përgjysmë dhe lëshoi një «eeeeuu», që gjëmoi, dhe jehona i shkoi deri në kasollen e barinjve. Ata e dëgjuan, por nuk kuptuan në ishte britmë njeriu, apo e ndonjë kafshe të egër.

— Eeeee, morreee, — sokëlliti Rashua sa doli jashtë kasollës dhe mbajti vesh.

— Aaaa, — lëshoi edhe një klithmë Pirua dhe u përplas mbi baltën e kuqe, fytyra iu palos në baltë, gati sa nuk ju zu fryma.

— Dikush është! Ndonjë partizan i raskapitur nga dëbora. Si duket, ka ngrirë. Shpejt, shokë, t'i shkojmë në ndihmë! — thirri Rashua dhe ja dha vrapit tutje. Të gjithë barinjtë u lëshuan pas tij, por nuk u ndie më gjë.

— Eeee, kush foli? — thirri më tej Rashua, por askush nuk iu përgjegj! Të tre partizanët ishin shtrirë përtokë pa ndjenja. Pirua e kishte akoma mëndjen dhe e ndjeu thirrjen e bariut. Lëshoi një rënkim të thellë që u ndje mbyturazi!

Mbas pak, të tre barinjtë u futën në kasolle me nga një partizan në krah. I vendosën mbi gunat e tyre dhe u erdhën rrotull; i vështruan me vëmendje. Më në fund, Ndrekua njohu Piron. «Oh! — thirri Rashua, — qenka edhe Rabushja! Ata i hodhën edhe më dru zjarrit, mbyllën derën

e kasolles dhe filluan t'i fërkonin me ujë të vakët, që t'i sillnin në vete dalngadalë, se përndryshe mund t'u pushonte zemra.

Pas shumë fërkimesh, Rabushja u përmend, hapi sytë dhe luajti duart. Trupi iu drodh. Deshi të fliste, por nuk mundi.

— Mos luani, shoqja Rabushe — e qetësoi atë Rashua, — ne ju muarëm nga buza e shkëmbit të Stravastroit dhe ju prumë këtu në kasolle. Tashti jini të sigurt, shtrihuni e qetësohuni deri nesër në mëngjes.

— Ku jam këtu? Kush jini ju që na kini shpëtuar? Ku është mali i Stravastroit?

— Qetësohu, shoqja Rabushe, — i thirri prapë Rashua, — mos ki frikë, unë jam Rashua! Më njeh?

Rabushja hapi mirë sytë dhe u përmend si nga ndonjë gjumë i rëndë. Vuri dorën mbi xhepin ku kishte vendosur letrën, ajo ishte atje.

— Ti Rasho je? — e pyeti ajo dhe e vështroi me habi. — Ju na shpëtuat?

— Po, Rabo, unë jam, Rashua, po qetësohu.

— Është larg mali i Stravastroit?

— Ditën mban një orë, por natën më shumë se dy, — iu përgjegjën të dy barinjët bashkë.

— Kam një letër urgjente, dua ta shpie sonte atje. Duhet t'i jepet sonte patjetër komandantit të batalionit, përndryshe dështon çdo gjë.

Çobanët vështruan njëri tjetrin.

— Po a nuk është e mundur ta shpiem ne? — Pyeti Rashua, — edhe ne partizanë jemi, pa çka se jemi me bagëti. Ne sot u takuam me komandantin e batalionit, u shpumë bukë partiza-

nëve. — Rabushes ju hapën sytë kur dëgjoji këto fjalë dhe emrin e atij mali aqë të njohur.

— Unë duhet të shkoj vetë patjetër dhe son-te, përndryshe çdo gjë dështon.

Pas shumë debatesh, u vendos që Rashua dhe Rabushja të shkonin t'i shpinin letrën komandan-tit, kurse të tjerët u nisën menjëherë për të mar-rë të tre shokët që mbetën në dëborë.

Rashua e mbështolli Rabushën me gunën e tij dhe e hipi në mushkë. Pas dy orësh arritën në Malin e Stravastroit.

JORDAN HAXHNIKOLLA

KUR DOLI DIELLI MAJË MALIT...

Ishim në klasë, në mësimin e gjuhës shqipe. Trokiti dera dhe të gjithë këthyem kokën andej. Brënda u fut xha Petrua, portjeri, një burrë i thyer në moshë e me dhëmbë të vënë. Plaku iu drejtua profesorit dhe diç i tha me zë aq të ulët, sa asnjë nuk dëgjoi. Pastaj, profesori i gjuhës, një burrë i shkurtër e i pashëm, e drejtoi vështrimin nga unë:

— Të kërkon drejtori.

U ngrita. Duke ecur nëpër klasë ndjeva se të gjithë më kishin ngulur sytë. Edhe profesori. Andej nga fundi i klasës se kush mëmëriti: «E thërresin për punë të demonstratës».

Trokita në zyrën e drejtorit.

— Hyrë! — dëgjova zërin që nga brënda.

Hapa derën dhe qëndrova më këmbë në mes të dhomës. Drejtori rrinte i ulur përpara tavolinës mbi të cilën qenë shpërndarë një tok me shkresa. Në të djathtë që ulur një burrë që nuk e njihja dhe që më vështronte nga koka deri te këmbët.

— Afrohu, — foli drejtori me zemërim të përmbajtur.

U afrova duke mos ditur ku t'i fusja duart: t'i mbaja mbrapa shpinës apo të lëshuara poshtë.

— Me këtë zotërinë — tha përsëri ai me një tingull metalik e të prerë — do të shkosh deri në shtëpi. Ka ca punë me ty. S'kam ç'të bëj. Një-mijë herë ju kam thënë të mos ngatërroheni me politikë.

Që të dy më vështronin në sy. Ja se ç'na qenka. Ai burri që qëndronte pranë drejtorit duhej të ish ndonjë agjent. Për këtë s'kish më dyshim. Pasi ai u përshëndet me drejtorin, dualëm jashtë. Në koridor dëgjoheshin vetëm hapat tona: të miat dhe të agjentit.

Që të gjithë nxënësit ishin nëpër klasa; me sa duket agjenti e kish menduar që largimi ynë nga shkolla të mos binte në sy. Tek qoshja e rrugës, pikërisht sapo muarrëm kthesën, dy karabinierë të fshehur më vunë menjëherë në mes. Që të dy mbanin pushkë të shkurtëra italiane.

Çdo gjë m'u bë e qartë. Duke ecur po vrisja mendjen: a kisha lënë në shtëpi ndonjë send që mund të më komprometonte. M'u kujtuan traktet. M'i kish dhënë Viktori në darkë për t'i shpërndarë, por më patën mbetur nja pesë copë. Në mëngjes, duke nxituar për në shkollë, i vura mbrapa pasqyrës. Po sikur t'i kishin gjetur?

Në shtëpi gjeta mjaft karabinierë që kontrollonin dhomat. Banoja me nënën në një shtëpi të vogël dollmallije me gjashtë shtatë shkallë, si shtëpitë e Elbasanit. Nëna, të cilën siç duket e kishin marrë nga fabrika e cigareve ku ajo punon-

te, qe hutuar. Kur hyra në derë, më pa si me qortim, sikur desh të më thosh: «Ja ç'na bëre, mor bir i nënës!» Unë bëra sikur nuk e vura re këtë gjë. Sytë më vajtën menjëherë tek pasqyra përpara së cilës qëndronte një karabinier. Ai shikonte mustaqet me vemendje dhe, siç duket, ishte i kënaqur prej tyre. Në çast kapi pasqyrën në duar, ndërsa mua më ngriu gjaku. Ç'do të bënte me të? Do ta hiqte nga muri? «Tani mbaroi çdo gjë» — mendova. Për fatin tim të mirë dhe si për çudi, karabinieri u largua menjëherë nga pasqyra dhe hyri në guzhinë.

— Kontrolloni mirë!

Oficeri italian, një njeri i vrejtur e që nuk i qeshte fytyra kurrë, më hodhi një vështrim të rreptë, aq sa nuk nuk munda ta shikoja drejt e në sy për një kohë të gjatë. Ula vështrimin. Italisht kuptoja diçka. Mund të merresha vesh.

— A keni armë?

— Jo.

— Je i sigurtë?

— Po.

Karabinierët e bënë shtëpinë rrëmujë po nuk gjetën gjë. Kjo më qetësoi. Traktet nuk u zbuluan. Fashisti më tha se duhej të shkoja deri në komandë për të plotësuar disa formalitete e pastaj do të shihnin e do të bënin. Atëhere nëna e humbi fare.

— Nënë, mos bëj kështu, — i fola unë.

Ajo e mblodhi veten, fshiu lotët dhe më përcolli me vështrimin plot dhëmshuri:

— Burgu për burrat është, bir' i nënës...

Karabinierët më vunë në mes dhe u nisën

për në komandë. «Duhet të duroj» — thashë me vete.

Në komandën e karabinierisë hyra nëpërmjet një porte të madhe. Pas portës shtrihej një oborr i gjërë, i rrethuar me ndërtesa. Lart shikohej një copë qiell. Pas pak më mori në pyetje një kapter fashist, një farë Mario, siç e quanin. Mbante flokë të gjatë që herë pas here i binin mbi sy. Ai i kapte me dorë dhe i flakte mbrapa.

— Të thuash të vërtetën, se ndryshe...

Ai më pyeste dhe unë i përgjigjesha me atë italishten e sakatosur të një liceisti të klasës së gjashtë.

— Ke marrë pjesë në demonstratë?

— Po!

— Kush të shtyu?

— Asnjeri!

Mario më shponte tejprtej me atë vështrimin e tij të djallëzuar e të ftohtë. Më paralajmëroi që të mos mërzitesha, se të gjitha ato që dija do të m'i nxirrte me marifete të tjera po të mos i thosha vetë. Po të tregoja emrin e ndonjërit, çdo gjë do të lehtësohej. I thashë se nuk më kish shtyrë asnjeri dhe se në demonstratë mora pjesë pa dashur, tek pashë gjithë atë turmë të madhe njerëzish. Mendova se me këtë mund ta gënjeja.

Papritur ndjeva një të goditur të fortë në faqen e djathtë që m'u ndez si prush i nxehtë. Fashisti më kish qëlluar, megjithatë zemra më gufon-te nga një gëzim i madh. Nga pyetjet që më bënte fashisti kuptova se rreth grupit tonë nuk dyshohej asgjë. Kjo kish rëndësi. Shokët mbas

arrestimit me siguri do të merrnin masat e duhura e do të tregoheshin më vigjilentë.

Dy karabinierë më shpunë në birucë. Ajo ishte një dhomë e ngushtë, fare e vogël. Në derën e saj të ftohtë ndodhej vetëm një dritare e vogël ku s'mund të nxirrje dot as hundën. Që andej merrte dritë e gjithë biruca. Atje brenda kish njerëz.

— Mirësevjen — dëgjova disa zëra nëpër errësirë.

— Kush jeni ju?

— Jemi shokë.

— Përse ju kanë arrestuar?

— Për pjesëmarrje në demonstratë.

Po më merrej fryma. Biruca mbante erë lagështie dhe amoniak. Duke u zhytur në errësirën e birucës humba lidhjen me njerëzit e gjallë. Sa ngadalë rrjedh koha këtu brënda. Vendi është i ngushtë, ajri i prishur. Sa kohë do të qëndroj këtu? Fillova të shoh në errësirë, të dalloj njerëzit, shokët. Disa pinin cigare dhe, e merrja me mend se si mbi kokat tona varej tymi i duhanit që më shtrëngonte të kollitesha herë pas here. Aty në birucë njoha Petritin, një djalë i gjatë e i dobët, që punonte si mekanik në oficinën e një të pasuri. Kish një zë të ëmbël që të bënte për vete. Ai na fliste vazhdimisht mbi situatën politike, na thoshte se fashistët nuk do ta kishin të gjatë, se gjermanët në frontin e lindjes po thyenin kokën, se Partia Komuniste Shqiptare po i printe popullit në luftën heroike për çlirimin e atdheut. «Ata duan të nxjerrin nga ne të dhëna, emra shokësh, bazat e fshehta, teknikën. Besoj se asnjëri nga ne nuk do ta turpërojë veten dhe të bëhet tradhëtar, qoftë

edhe sikur ta varin. Trëmben vetëm ata që nuk kanë asnjë qëllim në jetë, asnjë ideal politik. Kurse ne e dimë se e ardhmja jonë është pavarësia e Shqipërisë.»

Petriti, ky djalosh me shëndet të lig, dinte të fliste mirë dhe bukur. Unë e shikoja në gojë dhe mundohesha ta imitoja në çdo gjë. Shkollë kish vetëm pesë klasë, por dinte sa një mësonjës. Gjatë qëndrimit në karabinieri, e kishin torturuar me spica nëpër thoj, i patën vënë vezë të nxehta në të dy sqetullat, por ai nuk e kish hapur gojën. Sqetullat i kish akoma plagë. Duke e parë, më dukej se kisha përpara syve ndonjë hero legjendar. Kurse ai në të vërtetë ishte aq i thjeshtë e aq i turpshëm me shokët; herë herë i pëlqente të shtrihej në krevatin prej dërrase dhe t'ja thoshte ndonjë kënga partizane.

«Dalongadalë po vjen behari...»

Ne të tjerët i afroheshim pranë, e vinim në mes dhe këndonim bashkë me të, ngadalë e shtruar. Melodia e këngës na pushtonte që të gjithëve. Mallëngjimi më kapte thellë në shpirt dhe sikur më trishtonte. Një natë, dy karabinierë erdhën dhe e morën përsëri Petritin. Pas dy orëve e sollën në birucë, pa ndjenja, me fytyrë të gjakosur dhe syrin e djathtë të nxirë e të enjtur. Petriti mezi e mori veten pas katër a pesë ditësh. Ne i qëndruam mbi kokë, i thonim fjalë ngushulluese dhe herë herë këndonim këngë revolucionare.

Një ditë na kishin nxjerrë në oborr për nja dhjetë minuta, sa për të marrë ajër të pastër. Po rrinim të strukur në një qoshe të oborrit, pranë derës së birucës ku mezi arrinin disa tufa nga

rrezet e diellit. Ishim që të gjithë të zbetë, me fytyra të hequra e të parruara. Petriti ishte më i dërmuar. Qielli, ajo copë qiell që dukej, që mbuluar vende vende me ca re të bardha, mu si arna të qepura pa njëfarë bukurie.

Shikoja dritaret e asaj ndërtese të zymtë dhe mundohesha të merrja me mend njerëzit që punonin mbrapa tyre dhe planet djallëzore që thurnin ata. Për ditë sjellin njerëz këtu, i pyesin, i rrahin për vdekje dhe pastaj i futin nëpër biruca. Mbrëmë dëgjuam të thirrurat e një njeriu që torturohej. Na doli gjumi që të gjithëve dhe mbanim vesh. Kush ishte ai? Çfarë po i bënin? Urrejtja na mblidhej si lëmsh mu në fund të gjoksit. «Një ditë do të hakmerremi për të gjitha këto» — foli Petriti si për të na dhënë kurajo. Re të zeza po na vinin mbi kokë. As jeta e atyre që ishin jashtë nuk qe e siguruar. Ç'bënin shokët? Ç'bënte Viktori? Ndoshta dhe ata një ditë do të kalonin nga kjo birucë, që kish parë kaq vuajtje e tortura dhe do të dëgjonin hapat e rënda të rojës së armatosur.

Në kohën që roja na bëri me shenjë të futeshim në birucë, një burrë i gjatë e kockëmadh, i veshur me kostum të zi, me kapele të zezë e me papijon, kapërceu prakun e portës së karabinierisë. Ashtu i gjatë siç ishte, dukej si një sorrë e shëmtuar. E pamë që të gjithë. Deshi të fshihej por ishte vonë. Ne e kishim njohur.

— Të pamë, «grerë» e dreqit — i bërtiti Petriti në çastin që po futeshim në birucë.

Mbeta me gojë hapur. «Grera» ishte një nga profesorët e shkollës, që na jepte mësim. Dhe ja tani këtë e shikoja përpara derës së karabinierisë.

Ishte spiun. Më erdhi neveri dhe fillova të dridhesha i tëri nga zemërimi.

— I poshtri!

— Shokët do t'ja gjejnë vendin, mos ki merak.

Ditën e njëzetë na lajmëruan të bënim gati plaçkat, mbasi do të na hiqnin që aty. Ku do të na dërgonin? Pas dite na nxuarrën dhe na lidhën dy e nga dy: dora e djathtë e njërit me dorën e majtë të tjetrit. Mua më lidhën bashkë me Petritin. Mario, kapteri me flokët e gjatë, i dha një shkelm m'u në këmbën e djathtë. I dhëmbi sa s'bëhet, por ai nuk e bëri veten. Kafshoi vetëm buzën dhe lëvizi pak nga vendi. Me dorën që na kish mbetur e lirë hodhëm plaçkat mbi kurriz dhe u nisëm në rresht dy e nga dy, të shoqëruar nga karabinierë të armatosur. Ktheva kokën dhe njëherë prapa. Kapërcyem portën e madhe dhe dualëm në rrugë. Këmbë njeriu nuk të shihte syri. Ora mund të ishte diçka më tepër se gjashtë e mbrëmjes. Njerëzit qenë mbyllur nga «Copprifuocoja» nëpër shtëpitë e tyre. Rrugët ishin të shkretëta. Aty këtu takonim nëpër qoshka ndonjë patrule. Rojet ndaleshin për një çast, na hidhnin vështrime të rrepta nga koka e deri te këmbët, dhe diç pëshpëritnin midis tyre. Ne ecnim të lidhur dy e nga dy pa i parë fare. Vetëm Petriti çalonte nga pak dhe mundahej të mos rënkonte. E shikoja me bisht të syrit tek përpiquej të duronte dhëmbjen. Rrugës e kuptuam se do të na shpinin në burgun e madh të qytetit.

Në burg dryni i madh i derës së hekurt kërciti, kapërcyem pragun: Brënda na hoqën prangat. Për herë të parë në jetën time po hyja në një burg të zymtë. Hypëm shkallët prej guri dhe u ngjitëm

lart. Të burgosurit e tjerë politikë na pritën ngrohtë. Na përçafuan, biseduan me ne, na pyetën si kishim kaluar në birucë. Në emrin tonë fliste Petriti, të cilin e njihnin fare mirë. Një mëngjes në ushqimet që më dërgonte nëna më zuri syri një libër të vogël që m'u duk si i njohur. I lexova titullin. Ishte «Baba Tomorri» i Çajupit. Kjo më gëzoi sikur të kisha gjetur kushedi se çfarë. Ja tregova Petritit. Ai e mori ndër duar dhe tërë atë ditë u muar me vjershat e Çajupit.

Të dënuarit politikë e kishin organizuar jetën në burg si s'ka më mirë. Dukej aty dora e fortë e një organizatori të zot. Çdo gjë bëhej me rregull dhe kolektive: shpërndarja e ushqimit, leximi i librave, informacioni politik, lidhjet me lëvizjen jashtë burgut. Edhe të burgosurit për gjëra të zakonshme, kishin respekt të madh për të gjithë shokët. Në fillim ata silleshin vrazhdët, fyenin njeri tjetrin, ziheshin, por pas ca kohe shtroheshin e zbuteshin si për çudi. Nëna më sillte bukën për ditë dhe më jepte të fala nga shokët, nga Viktori. Ajo lodhej dhe mua më vinte keq për te. Një herë në javë takoheshim në dhomën e veçantë. Nëna nuk qante më. Ajo ish bërë trimëreshë e më jepte kurajo edhe mua. Sa herë vinte çasti i largimit më pushtonte në krahët e saj të dobët, më puthte në të dy faqet dhe pastaj zhdukej prapa derës. E mjera nënë! Me gjithë hallet e saj, duhej të duronte dhe dëshpërimin e burgosjes sime. Për të gjitha këto fajtor ishte fashizmi që erdhi në vëndin tonë i pafuar, që na prishi qetësinë dhe donte të bënte me popullin tonë si t'i donte qejfi. Por kjo nuk do t'i ecte. Megjithatë burgu na mërziste.

Kur dola nga burgu, pas disa muajsh, isha bërë tjetër njeri. Më dukej vetja si revolucionar. Puna e parë që bëra që takimi me Viktorin. U përqaftuam bashkë për një kohë të gjatë. E pyeta për shokët. Dy nga ata kishin dalë partizanë. I shpjegova se ç'kisha ndërmend të bëja.

— Po në qytet kush do të punojë? — tha ai.

— Unë kam vendosur.

Viktori më përqaftoi.

— Për disa ditë do të të jap përgjigje.

Vajta në shkollë sa për të mos rënë në sy. Disa studentë të klasave të larta nuk i pashë më. I kishin përzënë. Shokët më shtrëngonin dorën, më pyesnin si e kisha kaluar në birucë e në burg. Unë ua tregoja ashtu si i kisha jetuar. Ata më shikonin me habi, sikur të isha një hero përpara tyre. Më jepnin shënimet dhe tregoheshin të gatshëm të më ndihmonin në mësimet. Profesori i gjuhës shqipe, ai burri i shkurtër e simpatik, më përgëzoi. Po kështu bëri dhe xha Petrua me supet e rënë nga peshja e viteve. Vetëm drejtori dhe ajo «grera e zezë» bënë sikur nuk më vinin re.

Viktori më solli lajmin se do të dilja partizan me grupin e parë. Nuk e përmbaja dot gëzimin. Bisedova me nënën. Ajo do të vazhdonte të punonte në fabrikën e cigareve. Për të do të interesohej edhe shokët, që të mos e ndjente dhe aq mungesën time. Më në fund do të ndaheshim. Ajo më shikonte me gojë pak të hapur dhe me fytyrë të ndehur. E mjera nënë! M'u duk se ajo ishte mplakur, gjatë asaj kohe që kisha ndenjur në burg. Ma pushtoi kokën, ma mbështeti pranë gjirit të saj dhe dëgjova që tha:

— Shko bir, shko, unë do të bëj si të bëj.

Një mëngjes herët u veshja mirë dhe dola jashtë qytetit tek vendi i caktuar. Viktori i pat marrë të gjitha masat. U bëmë tre veta. Para se të nisesha, hodha një vështrim në drejtim të burgut, atje ku ndodheshin shokët dhe Petriti, mësonjësi im. Pastaj hodha sytë atje ku mezi shquhej çatia e kuqe e shkollës, ku mësova vite me radhë. Buzëqesha. Kur doli dielli në majë të malit, ne kishim bërë goxha rrugë dhe i qemë afruar çetës partizane.

SHPËRBLIMI

Korrik. Kish pllakosur një vapë e madhe, e paduruar. Era s'pipëtinte gjëkund. Bariu e pa të udhës t'i fusë bagëtinë në mërzim para kohe, se ato jo vetëm s'po kullosnin, por s'po gjenin derman e s'dinin ku të futnin kokën nga zhegu. Ai vuri dy gishtat në gojë e lëshoi një vërshëllimë që u dëgjua deri përtej majave karshi. Pastaj sokëlliti edhe njëherë si më ujk dhe u var poshtë pyllit për të mbledhur bagëtinë. Nisi tre cjepët e zileve përpara dhe tufa, e bindur si ushtarët që shkojnë pas komandantit, i ndoqi pas, për të dalë te një burim ku zunë vendet e preferuara, midis shpellave. Ai varg shpellash i ngjante një kinoteatri. Përbëhej prej tre katesh, me dysheme e tavan stenash. Gjithë bagëtia, si qenie të vetëdijshme, vinin në vendin e tyre, kruanin me thundra shpellën për ta pastruar dhe uleshin barkas, me këmbët e para shtritur, ndërsa të prasset mbledhur pas kryqeve.

Ky vend mërzimi, që kishte zgjedhur Qerim Shkoza, ish gjithmonë i freskët, s'e kish shokun

në ato anë. Përroi i thellë e ujët që gurgullonte në shtratin e tij, burimet që vinin varg njëri pas tjetrit, hijet e dendura të pyllit me lajthi e shkoza, e bënin bariun plak e tufën të harronin se ish korrik. Edhe atë ditë bagëtia erdhën me nxitim, me shpresë se do të gjenin freskinë e përhershme. Pas tyre erdhi bariu, i shoqëruar nga besnikët e tij, Balua dhe Murrua, që s'ja ndanin hapin. Por për çudinë e plakut, edhe aty, asnjë gjethe peme nuk lëvizte, asnjë zog nuk cicëronte. Vetëm gjinkallat të shurdhonin me ato xhërxhëret e mërzitshme. Një tufë e madhe bishtatundësish, që ishin mbledhur rreth një burimi, ndjenë këmbët e bariut, rrahën krahët e fluturuan poshtë, drejt përroit të thellë.

Qerim Shkoza, sa hoqi nga krahët dyfekun, çantën e bukës dhe lëkurën e dhallit, futi kokën në burimin e akullit, u freskua mirë e mirë dhe sikur e mblodhi një çikëz veten. Pastaj mori sheqëzën e moli dy dhi. Qumështin e hodhi në lëkurën e dhallit. Për bukë as i shkoi mendja. Balua e Murrua s'gjenin derman nga vapa. E lanë vendin e tyre të zakonshëm dhe u futën poshtë përroit, buzë pellgjeve me ujë. Bagëtia rrinin si të shushatura e të dremitura.

«Do të kemi shi», mendoi me vete bariu.

Lart, mbi kodrën e Beronjës, zgjati kokën një re e zezë pisë. Qerimi, sa e pa, u bind se shiu ish i afërt. Shenjat i vuri re që në mëngjes atje në mone, kur çoi bagëtinë në kullotë. Kish qenë një natë plot zagushi, edhe atje në mes të qafës, ku veriu s'pushonte as natë as ditë. Kur agonte dhe lindja merrte flakë, bariu shpesh ndjente mornica dhe bënte nga një flakë zjarr, por

asaj nate ai fjeti pa e hedhur fare gunën krahëve. Nata kish qenë e keqe. Qerimit i qe dukur vetja sikur ish në pus. As fyellin, që e kish aq qef s'e pat zënë me dorë. Në mëngjes, dielli kish dalë jo me shkëlqimin e tij verbonjës, por me një dritë të zbetë gati si të hënës dhe rreth e rrotull maleve ish parë një tymësirë e hollë. Kur dielli ish ngritur nja dy tre hostenë, mbi majën e Tomorrit ish dukur njërezë sa një shkabë kur tendos krahët për fluturim. Dhe ajo re e vogël herë ngrinte kokën përpjetë si të nepërkës; herë sikur e vaiste në një krah.

Ajo re, ish lajmëtare e shiut të afërm. Me ç'ankth e prisnin shiun bujqit! Edhe barinjët e prisnin shiun me padurim, që t'u mbyste pluhurin që ngrihej deri në qiell ngado që shkonin bagëti. Dhe ja tani, reja e vogël e mëngjesit, që s'ta mbushte syrin, kish zaptuar kupën e qiellit. Ajo ish ngarkuar me shi dhe nga çasti në çast do të zbrazej. Male dhe lugina do të oshëtinin. Pastaj, ai shi i bekuar do të freskonte tokën e zhuritur dhe çdo gjë do të gjallërohej, do të bëhej më e bukur, më e madhërishme. Qerimi, sa e pa renë e zezë, u gëzua. Kishin kaluar dy muaj pa shi.

«Ishalla na kujton me një çikëz shi!» pëshpëriste plaku me vete në shpellë.

S'kaluan as dhjetë minuta, një gjëmim çau ajrin dhe mbushi lugina e sheshe, përrenj e lumenj, kodra e male, dhe pastaj fryu një erë e tërbuar që i përkuli majat e drurëve deri në tokë. Bubullimë e erë e marrë, shkrepëtimë e rrufe që s'kishin të sosur, tregonin se diçka e tmershme do të ndodhte. Dhe ja, nga maja sipër, me shpejtësi vetëtime, vjen një rrebesh i fortë breshëri.

Bariut iu rrënqeth trupi kur kujtoi se mund të gjenin ngordhjen kush e di sa krerë bagëti, do të shkundej gruri dhe furtuna do t'ua rrëmbente fshatarëve bukën nga goja. Po midis atyre shpellave ai ndjehej i sigurtë për bagëtinë e tij.

Shtërgata sa vinte po bëhej më e egër dhe s'kish ndërmend të pushonte. Ajo zbrazte breshër me kokrrën sa një arrë dhe era ish aq e madhe, sa edhe njeriun mund ta fluturonte si leckë. Qerim Shkoza, dyzet e pesë vjet bari, as kish parë e as kish dëgjuar një rrebesh si ky: sikur po rrëzoheshin qiejt. Dhe ashtu siç ish e egër stuhia, po ashtu të forta qenë rrufetë që rrëzonin lisat tej. Ja një rrufe para hundës së tij, në mes të shpellave ku ishin tulatur bagëtia. Ja edhe një tjetër, fare pranë, në mes të përroit, që për një çast e la bariun pa ndjenja. Vonë, ai e mblodhi veten dhe pa se stuhia e çmendur vazhdonte me furri. Një oshëtimë shurdhonjëse vinte që lart, drejt rrjedhës së përroit. Bariu ktheu sytë andej i mahnitur. Në shtratin e thatë ecnin me shpejtësi ca stena të mëdha, drurë e shkarpa përzier, që i kish vënë përpara si me kamxhik një fuqi e padukshme.

— Xhindet! Klithi plaku dhe desh t'ja jepte vrapit.

Kur ja, pas asaj potereje, vinte me vërtik një valë uji si katran, që kish marrë vrapin tatëpjetë.

— O Zot! të qofshim falë! murmuriti bariu, që mbeti i pataksur nga gjithë ajo valë e zezë dhe e madhe, sikur të kish plasur mali e të kish lëshuar detin që mbante në zemrën e tij.

Qerimi rroku patickën dhe e zbrazi pesë herë: bam... bam.. bam..., por rrebeshi bëri të tijën. Si kaloi një orë, breshëri pushoi, era sikur u ndal, veçse binte një shi i madh, si me lëkurë. Barriu u çua të shohë bagëtinë. U afrua tek stenat dhe u lemerit kur pa valën e ujit që ish ngjitur deri lart në katin e parë të shpellave.

— Bobo, bagëtia! — thirri.

U pikëllua aq shumë, sa më s'e desh të gjallët. Të paskish një fije shprese se mund të delte përtej, do të ish përmbledhur në valën e ujit të tërbuar, por aty as zogu s'mund të fluturonte.

Dallga e ujit filloi të ulet vonë, se përroi e rrëketë që mblidheshin në të qenë të shkurtra e shumë të pjerrta dhe uji ecte me shpejtësinë e vetëtimës. Bagëtia filluan të dilnin nga mërzi, varg njëra pas tjetrës, dhe u hapën pyllit për të kullotur. Qerimit s'i rrihej. Ai kërcëu në ujin e turbullt që i erdhi deri në brez dhe që për pak desh e përlau. Kur hipi në katin e tretë të stenave, i ra kërraba nga dora: nëndë kokë bagëti kishte vrrarë rrufeja.

— Bobo, ç'hata e zezë! — u lebetit plaku dhe dy pika lot i shkanë faqeve të fishkura. — Mos m'i vrau rrufeja edhe qentë? u drodh ai.

Me zemër të ngrirë, kapërceu së këtejmi për rruan e shkoi në atë buzë rrekeje ku qentë po kalonin vapën. Por ç'të shihte? Murrua e Balua ishin shtrirë sa gjatë gjerë pranë njeri tjetrit dhe hundë e gojë i kishin plot me gjak të zi.

— Ç'hata që më paska gjetur mua të varfërin!

Zemra iu çorr e qau si fëmijë sipër qenve. Ata qen e kishin nderuar me vjete. Sa herë që ujku, si kusar i regjur, derdhej në tufën e Qerimit, mundimi i shkonte kot: Balua e Murrua, me t'ia ndjerë erën, i turreshin si shqipe mali dhe i kërcenin në kokë. Pastaj e vinin përpara dhe e ndiqnin aq larg sinorit, sa të thoshte mendja se egërsira s'vjen më kurrë. Kur ktheheshin në tufë, shkonin pranë bariut, e përgëzoheshin duke tundur bishtin, sikur donin t'i mburreshin se sa të ishin ata gjallë, ujku nuk do t'i lyente dot dhëmbët me gjakun e bagëtive. Bariu ua kthente përgëzimin, duke u fërkuar kurrrizin me dashmirësi, ata hiqeshin mënjanë e secili zinte nga një cep vënd. Aty shtriheshin barakas, me gjuhën një pëllëmbë jashtë, ndërsa ijet u rrihnin si çekan mbi kudhër.

Toka e mbuluar nga një shtresë e hirtë breshëri avullonte dhe, në çast, u ngrit një mjegull e madhe. Kjo mjegull e papritur e detyroi Qerimin t'i bënte sytë katër dhe ta harronte dhimbjen. I dërmuar në shpirt, ai la qentë te vendi, vuri dyfekun në krahë dhe u hodh me nxitim matanë përroit, ku ishin shpërndarë bagëtia. Gjithë shpresën e kish tek veshët, se sytë s'bënin para në atë mjegull, ndërsa Balua e Murrua dergjeshin atje tej, buzë rrëkesë së nëmur. Me të arritur në mes të tufës, cjepët e zileve u trembën. Bariu sokëlliu sa mundi, zbrazti dhe nja dy herë patickën, por bosh. Tërë bagëtia kishin ngritur kokën lart dhe po blegërinin. Qerimi vrapoi si i marrë përmes atij pylli të dendur, shtiu përsëri me dyfek, por bagëtia zunë brithmën e u shpërndanë koqe-koqe,

si bravare të këqia. Përpara gjeti tri kokë të çara nga ujku. Eci gjithë duf dhe u ndesh ballë për ballë me ujkun. Ja mbajti me dyfek në kokë, por s'e zuri mirë. Ujku i gjakosur e për lau me dhëmbë gushën e pushkës. Bariu hiq mënjanë e ujku hiq në anën tjetër. Plaku e mori vdekjen në sy. Duke u kacafytur me egërsirën, ruajti çastin kur gryka e dyfekut qëllonte drejt për drejt më gjoksin e ujkut dhe ja shkrepiti. Egërsira angulli si e tërbuar dhe u përmbys.

Ndajnatëherë, mjergulla u zhduk. Aty-këtu zbardhnin togjet me breshër. Pylli kish mbetur gjysëm i xhveshur, por natyra ish hijeshuar përsëri. Zogj të panumurt cicëronin ëmbël. Dytri lauresha fluturonin lart në qiell duke kënduar, sikur të donin t'u hiqnin frikën njerëzve prej tmerit që u panë sytë. Andej-këtej dëgjoheshin sokëllima barinjsh e bujqish, të cilët kishin dalë për të mbledhur bagëtinë dhe për të parë dëmet që pësuan.

Qerim Shkoza e drejtoi tufën nga vatha më shpejt se çdo herë dhe numëroi bagëtinë. Tetëmbëdhjetë krerë i kishin vajtur dëm. Ca i vrau rrufeja, ca i mbyti ujët dhe ca i çau ujkun. Plaku ish bërë pikë e vrer. Dyzet e pesë vjet kish ai me bagëtinë e Fuat beut, një jetë njeriu, por s'kish parë kurrë një shtërgatë kaq të tmershme, kurrë s'i kish ndodhur të kacafytej me ujkun. Ai u rrit dhe u plak me tufën. Dimër e verë, ditë e natë rrinte me të, s'ndahej kurrë prej saj. Kur bagëtia nishin të pillnin, ai u rrinte në këmbë me kandil në dorë, i merrte keçërit pas zjarrit në acarin e dimrit, i mëndëte tek nënat e tyre dhe, buzë pranvere beut i dyfishohej tufa. Gjithë sa e njihnin

bariun e beut, thoshin se atij s'i gjëndeje shoku në zanatin e tij, se ai, edhe të tijat t'i kish ato bagëti, nuk do t'u rrinte në këmbë siç po u rri. Ata mahniteshin se si ky njeri, nga puna e të cilit beu s'ish kënaqur kurrë, në vend që t'u kllasë ujkun atyre bagëtive, i do me kokë, tretet si qiri-ri pas tyre. Por Qerim Shkoza mendonte se inatin e mërinë që kish për beun, nuk mund ta nxirrite në kurriz të bagëtisë, se po ta bënte këtë, ish një mëkat që nuk falej e që kush ta bënte, s'kish të drejtë ta quante më veten njeri me zemër njeriu. Nuk ishin të rralla rastet kur, miq e farefis, i flisnin dhe e merrnin për budalla që tregonte aq kujdes për bagëtinë e atij të pangopuri, po Qerimi thosh: «Në se nuk do të ma dijë Fuat beu, do të ma dijë perëndia. Në se është ai xhahil, tufa e bagëtive është e uruar. Ato janë kafshë dhe zot i tyre jam unë që u bëj shërbimin».

Hidhërimi që i pushtoi zemrën për zarrarin që e gjeti ish aq i madh sa edhe një vdekje e njeriut më të dashur t'i kish ndodhur, plaku nuk besonte t'i dërmohej aq shumë zemra. Por, ai, bashkë me atë hidhërim të pashoq, ndjente edhe krenari se, duke u kacafytur me vdekjen për të shpëtuar bagëtinë edhe beut do t'i mbushej mendja, do t'i bëhej qefi dhe do t'i rrihte krahët duke i thënë: «Më të lumtë, more Qerim! S'e prisja kurrë që ti të merrje në sy vdekjen për bagëtinë time! E paç hallall atë bukë që ha e ato para që merr». Ja njihte mirë zemrën beut të tij bariu plak, e dinte që zemra e Fuat beut ish si katriani i zi. Beu ish nga ata që edhe kur u thua «shëndet», të përgjigjen «plaç». Por kësaj radhe

sado zemërgur, sado kararsëz, sado dritëshkurtër, nuk kish si të mos e shihte drejt në sy të vërtetën, nuk kish si të mos habitej për burrërinë dhe besnikërinë e bariut.

Posa numëroi bagëtinë, Qerimit i erdhi pranë Jashar Frëngu, shok e mik i tij besnik, hyzmeqar edhe ky i Fuat beut. Pa e përshëndetur mirë akoma, e pyeti:

— E mo, si dole sot? T'u bë gjë zarrar?

— Lëre, mos më pyet. Lumi që më mori me gjithë bagëti! iu gjegj ai me një psherëtimë të zgjatur. Dhe zuri e i tregoi fill e për pe ç'i kish ndodhur.

— Ç'thua, mor t'u haptë dera! Po paske shpëtuar në fillt! U të lëntë mendja, more derëzi e punëzi! Po ç'të duhet t'i thuash vdekjes eja më merr, apo për të mirat që ke parë nga beu?

Pastaj, Jashari zuri e tregoi dëmet e mëdha që u qenë bërë fshatarëve, — sa e sa bagëti të mbytura, — por asnjë nga të zotët e tyre s'e kish vënë kokën në rrezik.

Në këto e sipër, tej në qafë doli beu, hipur doriut, që e ngiste revan.

— Erdhi qafëthyeri, tha Qerimi dhe ndjeu gëzim se do të ish e para herë që do të dëgjonte fjalë të mira nga goja e të zot.

— E, more Qerim, gjallë qënke? bëri shaka beu, kur iu mbush syri me tufën e nuk dyshoi t'i kish ndodhur ndonjë zarrar.

— Gjallë e për djall, o Fuat bej. Më mirë mos më pyet.

— Pse? Ç'të ka ndodhur?

Me zemër të çelur bariu zu e i tregoi. I tregoi për rrebeshin e paparë, për ruan që u bë det e

shkuar detit, rrufetë që tundën dheun, qentë e vrrarë dhe, së fundi, edhe për ujkun e tërbuar, me të cilin u kap fyt për fyt dhe e përmbysi.

Pa mbaruar mirë fjalën Qerimi, beu u vrënjt e mori fytyrë të egër. Bariut plak i shkoi mendja se beu do t'i turrej e ta shante pse kish futur kokën në rrezik, se në një rrebesh të tillë, njeriu me me mend në kokë nuk kërcen mbi valën e ujit të turbullt, nuk i vërvitet ujkut në grykë, nuk vdes për pesë apo dhjetë krerë bagëti. Por nuk ndodhi ajo që priste Qerimi. Beut i ra të zisë dhe tërë ajo burrëri e bariut të tij, tërë ajo luftë që ai kish bërë me vdekjen për të shpëtuar tufën, nuk ja mbushën synë.

— Po pse s'të vrau edhe ty rrufeja, mor frëngu i qerratajt? Pse s'të mbyti edhe ty përroi? Pse s'të çau edhe ty ujku? — Ulëriu.

— Me sa munda, unë u përpoqa, o bej. Rrufenë e shtiri zoti, përruan det e bëri zoti. Sa për ujkun, në mos beson, urdhëro e shiko dyfekun si ma ka kafshuar, — i tha me mburrje bariu.

— Hajt sikter, se s'je nga ato lule ti, s'je nga ata burra që përleshën me ujkun ti!

— Po, po, ja ku duken dhëmbët e ujkut, o Fuat bej — i foli si me drojtje Jashari, që iu këput shpirti për shokun.

— Ikë, mor, çporru nga sytë! Kush të pyeti ty?

Dhe iu kthye Qerimit:

— Të gjitha do të m'i paguash! Një mot të tërë do të të mbaj pa rrogë si qerratanë, more vesh? — iu kanos beu me tërbim.

Fytyra e dashur e bariut u nxi si moti para shtërgatës, vështrimi i tij u bë tmeronjës. Para

syve të tij u çfaq me nxitim të rrufeshëm e kaluara e zezë. Iu bë sikur po i ushtonin veshët nga të bër-titurat e çmëndura të beut, nga sikterisjet e për-buzjet që i kish bërë gjithë jetën dhe që ai i kish duruar. Fytyra e beut iu duk më e shëmtuara në botë dhe kanosja që i bëri beu, si një tallje me njeriun, me nderin, djersën e gjakun e tij.

— Më merr të keqen! Të keqen më merr, xhahil! — iu kanos Qerimi. — Një jetë njeriu të kam shërbyer, po kurrë buza s'më qeshi, kurrë zemra s'm'u ngroh. Ti harron se unë jam njeri, kam burrëri, kam nder... Mjaft të kam duruar! Dhe në të kam duruar kaq gjatë, ma kanë ngrënë kokën ato, i tha dhe tendosi krahun me tërë fuqinë drejt bagëtive. — Urdhëro dyfekun, — ja bëri dhe e përplasi patickën pas gardhit të vathës. — Sa për tufën, më vjen keq se i kam rritur vetë. Ato kafshë janë, po të mirën dinë të ta shpërblejnë! I mola një jetë të tërë që të majmesh zotro-te!... Haram të qoftë qumështi i tyre!

FADIL ZEQRIRI

NJË NDODHI NË BJESHKËT E VERIUT

Helikopteri u ngrit, mori lartësinë dhe pastaj u kthye me kurs për në veri. Këtë radhë pasagjerët e tij ishin të pakët. Vetëm dy vetë: mjeku dhe komandanti i një poste kufitare, Qerimi. Ky burrë i gjatë, me shpatulla të gjëra dhe fytyrë të hequr pat lënë lejën përgjysmë, se mori vesh për sëmundjen e rëndë të ushtarit të tij. Meqënëse helikopteri do të shpinte atje mjekun kirurg, që duhej të arrinte sa më parë, komandanti ndërhyri pranë komandës eprorë për të ndërprerë pushimet dhe për t'u nisur me të. Shokët atje lart për një rast të tillë nuk ja prishën. Qerimi ishte komandanti i postës, e si i tillë, edhe duke qënë me leje, kishte përgjegjësi për çdo gjë që mund të ndodhte me mvartësit e tij dhe me sektorin që i kishte besuar.

Kufitarët e kanë para gjoksit armikun, e shohin me sy, e urrejnë, qëndrojnë gjithmonë pranë postës së tyre, groposen nën dëborë, shtrën-

gohen fort te toka e tyre dhe i duan shumë shokët e armëve, se vetëm kështu mund ta mundin armikun. Kufiri ka vështirësi në shërbim, e të gjitha këto i mposht një rregull i fortë, një disiplinë e çelniktë dhe një dashuri e zjarrtë për Atdheun.

Këto mendonte oficeri atje në helikopter, ku zhurma monotone e motorit nuk ja ngatërronte dot mendimet. Këto mendonte Qerimi ashtu i ngrysur si ajo ditë janari e vetëm një gjë e mundonte: «Si nuk mora vesh më parë që ushtari është në rrezik? Siç duket, nuk kanë dashur të më shqetësonin, nuk donin të më prishnin pushimet».

— Pushimet! — pëshpëriti me vete dhe shtrëngoi nofullat nga inati.

Ekui pazhi i helikopterit përbëhej gjithashtu prej dy vetësh, prej pilotit të parë dhe pilotit të dytë, që rrinin respektivisht i pari në të majtë dhe i dyti djathtas tij, mu aty te hunda e maqinës fluturuese.

Qerimi, pa e fikur cigaren e parë, ndizte me të tjetrën. E pinte atë të flamosur duhan në mënyrë të çuditshme. Kur e thithte tymin, dukej sikur fuste në mushkëri tërë ajrin që kishte kabina. Pastaj, ja ngulte sytë pilotit të parë, një djali të ri, si të donte t'i lutej që të shpejtonte edhe më. Pilotit i dukej sikur në shprehjen e atyre syve të vrrarë prej pagjumësisë, lexoheshin qartë këto fjalë: «atje në bjeshkë ydekja rrezikon një njeri. Ai është i mirë, unë e njoh. Të gjithë të mirë janë ata. I kam parë edhe kur kanë përgjuar me net të tëra pa gjumë, edhe i kam mbuluar në kapanon, kur u binin bataniet nga shtrati, i kam parë edhe

kur kanë qëlluar shkelësin në lule të ballit. Më shpejt, pra, ta shpëtojmë shokun tonë. Më shpejt, të lutem».

Piloti, kur e shihte në këtë gjendje, vinte buzën në gaz për t'i dhënë kurajë. Në fund, ai bërtiti me zë të lartë, se nuk i linte zhurma e motorit të merreshin vesh:

— Mos kini merak. Do të arrijmë patjetër në kohë. Ja tani fluturojmë me maksimumin e shpejtësisë. — Oficeri shkundi tymin e cigares dhe u mundua t'i buzëqeshte pilotit. Ky i fundit e mori buzëqeshjen e tij si shenjë falënderimi dhe iu përgjegj në të njejtën mënyrë.

Doktori qe ulur pak më larg. Ai me njerën dorë shtrëngonte një çantë, sikur të kishte frikë se mos ja rrëmbente njeri dhe tjetrën e kishte futur në xhep të palltos së trashë. Rrinte i qetë. Vetëm kur kaluan mbi 15 minuta, që ndodheshin në ajër, e pyeti Qerimin për disa çeshtje që kishin të bënin me të sëmurin e tij:

— Nëqoftëse nuk mund t'i plotësojmë shërbimet atje, duhet ta sjellim në Tiranë për ta operuar.

— Kot mërzhiteni për këtë, doktor. Kryesorja është ta gjejmë gjallë, sa për ta operuar në Tiranë a në vend, kjo varet nga gjendja e të sëmurit. Nëqoftëse koha pret, e hypim në helikopter dhe kthehemi, por nëqoftëse nuk pret duhet të bëjmë çmos që ta shpëtojmë në vend. Sa për kushtet, pse më pyesni mua? Ju me ne jetoni dhe patjetër i dini. Atje është kufi, është bjeshkë. Pastaj, mos

harroni doktor, se gjatë luftës janë bërë operacione e janë prerë gjymtyra njerëzish me sharra druri e pa morfinë nga doktorët partizanë, apo s'është kështu?

Komandanti e pa se i foli rëndë doktorit, që ndoshta s'e kish atje fjalën. E pa që e shkeli e nuk kishte si ta rregullonte prapë. Si nuk gjeti fjalë për ta zbutur, nxorri paqetën, sepse duhani ishte qetësues për të.

Piloti i parë dëgjoi vetëm disa fjalë të shkëputura prej bisedës së tyre, po prapë e kuptoi si ishte puna. Të fliste, nuk dinte kujt t'ja prishte e kujt t'ja ndreqte, prandaj shikoi poshtë nën re, që me atë vështrim t'u tërhiqte vemendjen dhe atyre. Poshtë nën maqinën fluturuese, dalloheshin më mirë malet, arat e mbjella dhe lumi Drin, që dredhonte nëpër to. Një sy i sprovuar, që e shihte me vemendje nga lart dhe që i kishte parë dhe herë të tjera, mund t'i njihte pa mundim. Më lehtë e bënte këtë syri i mësuar i pilotit. Drini dredhonte në drejtim të detit, por xhamet e ngushtë të helikopterit nuk lejonin të dukej delta e tij, vendi ku ai ndal vrapin. Në drejtim të veriut shikimi bëhej më i dobët. Rrëzë maleve shihej vetëm një cipë dëbore. Sa më lart ngjitej syri mbi maja, aq më shumë shtohet dëborë. Në disa vende rrypat e gjatë e të shpeshtë të dëborës vareshin deri në fund, rrëzë maleve dukeshin boshllëqe të pazbardhura. Kur i shihje nga larg, të ngjanin me kokën e një të moçmi me flokë të thinjura e të zeza, në majë të së cilës zbardh qylafi i bardhë karakteristik. Dielli nuk dukej; ai qe fshehur prapa disa reve të zeza, të cilat vraponin në të njej-

tin drejtim me ta. Errësira shtohet bashkë me lëvizjen e tyre për në veri. Retë e zeza të dendura, që sa vinin u afroreshin maleve, komandant Qerimit i dukeshin si bombardues gjigandë që bien në pikjatë për të bombarduar ose mitraluar. Tek tuk skuqte ndonjë vetëtimë. E, atij që kishte sy dhe mendje ushtari, i dukej sikur «bombarduesit» qëllonin me raketa.

Piloti i parë vuri re se po hynin në alpet, prandaj duke parë dhe kohën e keqe, i bëri shenjë ndihmësit të shtonte vemendjen. Kurse vetë tërhoqi levën e lartësisë. Qerimi rrinte si në gjemba; as vetë nuk mbante mend sa cigare pat pirë në atë kohë aq të shkurtër. Kutia me markën «Partizani» pothuaj qe boshatisur. Prapë ai e prishi i pari atë qetësi që pat rënë. Tundi pak nga prapa pilotin e parë, se e kishte më afër dhe i tha me zë të lartë, që të sundonte mbi zhurmën monotone të motorit, kur pa se helikopteri po kthente djathtas:

— Nuk ka mundësi të fluturojmë drejt? Rruga e drejtë është gjithmonë më e shkurtër.

— Dhe më e rrezikshme — ja priti piloti.

— E rrezikshme! Po ne kemi shokun tonë të armëve atje, që është në rrezik.

— Po, është e vërtetë; — piloti nxorri një hartë dhe ja vuri përpara komandantit, pastaj vazhdoi — ne do të ulemi këtu — dhe vuri në një pikë majën e gishtit. — Rruga më e shkurtër kalon nëpër majën e hekurave, po kapërcejmë Valbonën. Tani atje, siç flasin instrumentat, me siguri bie dëborë. Dy rreziqe kemi tani. I pari, po t'i biem drejt, nëpër majat e maleve të hekurave, shikimi është shumë i dobët, ky vargmal ka shu-

më maja dhe shkëmbinj ku mund të përplasemi; kurse rrezikun e dytë e kemi në ulje, meqenëse atje bie dëborë e, në raste të tilla është e vështirë ulja. Të paktën, të marrim djathtas për t'iu shmanhur rrezikut të parë. Sa për rrezikun e dytë, do të bëjmë si të bëjmë. Pastaj, për të ndërruar bisedë, pyeti: — Kini kohë në ato anë?

— Që në fillim të shërbimit tim si oficer.

— Si duket vendi dhe njerëzit?

— Ngjajnë shumë me njeri tjetrin. Burrat po t'i pyesësh për ndonjë pjesë muzikore mund të mos e dinë se kush e ka bërë por po t'u vesh një pesë lekshe, aq larg sa e dallon syri i njeriut, me siguri e qëllojnë mu në mes me pushkë.

Doktori nuk merrte pjesë në bisedë. Ai nuk ngopej së sodituri ato bukuri që nuk i kishte parë ndonjëherë tjetër. Dalngadalë atij iu pre të parit. Në fillim, i dukej sikur një mjegull në bojën e hirit po dendësohej, pastaj ajo u bë më e errët, sa ja mbylli fare kodrat, luginat e, në fund, edhe majat e thepisura. Akrepi lartësi-matës tregonte 2500 metra. Lartësi e parrezikshme për përplasje, kurse ai i shpejtësisë vazhdonte të qëndronte në numrin më të madh.

Kishin afro gjysëm ore që po fluturonin. I qenë afruar objektit ku do të uleshin, po koha pat ndryshuar kryekëput. Kur u nisën, dielli herë dukej, herë fshihej dhe të ftohtit të përllante, por asnjeri nuk e mendonte se do të binte dëborë.

— A ka shumë rrezik për uljen tonë në këtë kohë me dëborë? — pyeti doktori, i cili, meqenëse nuk kishte çfarë të shihte, përveç asaj ngjyre plumbi në të bardhë, që sundonte për rreth maqinës

fluturuese, vendosi të merrte pjesë në bisedë.

— Helikopteri mund të ulet pothuajse kudo. Kjo nuk na shqetëson. Vetëm kam frikë se mos humbasim drejtimin ose përplasemi gjëkund.

— Ku duhet të jemi tani? — pyeti komandanti.

— Rrotull këtij vendi — tha piloti dhe bëri një rreth me gisht mbi hartë, në afërsitë ku ndodhej fshati.

— Posta jonë ndodhet pesë kilometra në veri të fshatit. Pra, le të ulemi mu këtu. Vendi është i mirë. Një tokë e rrafshët, luginë e lënë djerr për të kullotur bagëtinë, — tha komandant Qerimi.

Helikopteri nisi të ulej ngadalë duke e zvo-gëluar shpejtësinë në mënyrë të dukshme. Sa më shumë ulej, aq më të mëdha e më të dendura dukeshin flokët e dëborës.

— Tani duhet të jemi mbi fshat, — tha piloti i parë.

Asnjë nuk bëri zë. Helikopteri vazhdoi të ulej gjithnjë. Filluan të duken kodrat për rreth, pastaj pemët me degët e përkulura nga pesha e dëborës. Helikopterin e ndanin tani vetëm dhjetë metra nga vendi i uljes. Nën maqinë, mbi sipërfaqen e bardhë shkëputeshin copa dëbore dhe flakeshin tutje nga forca e helikës së madhe. Në qendër, dëbora i ngjante një cikloni të vogël, kur era përqëndrohet në një pikë dhe pluhuri vjen rrotull saj. Aty në atë lartësi qëndroi helikopteri.

— Për këtë vënd më thatë ju? — pyeti piloti i parë.

— Po — iu përgjegj komandanti, pasi shikoi dhe njëherë për t'u siguruar.

Piloti i dhathtë ja mbajti dorën shokut, kur ky u mat t'i jepte levës për ta ulur maqinën fluturuese në tokë. Ai kish marrë një pamje të ngrysur dhe serioze. Përqëndroi dhe njëherë vështrimin diku përpara tek disa pisha, aty nën disa shkëmbij të mbuluar me dëborë dhe tha:

— Shikoni! shikoni! Ç'janë ata njerëz të armatosur që po fshihen prapa atyre shkëmbinjve?

Doktori pa gjithashtu një grup tjetër njerëzish që u fshehën diku djathtas. Ndërsa piloti i parë shihte nga oficeri, i cili shërbente në këto anë, kolegu i tij bënte llogaritë me kompas. I përi u alarmua doktori:

— Mos nuk jemi mbi tokën tonë?

— Jo, llogaritë flasin drejt, — ja priti piloti i dytë.

— Ç'janë këto mendime? Unë kam pesë vjet që i mat me pëllëmbë këto bjeshkë. O burrani të ulemi, se poshtë në tokë e skjarojmë këtë, — u nxeh komandanti.

Helikopteri u ul. Nga tronditja e vogël që patën pasagjerët dhe ekuipazhi, u kuptua se tani rrotat e tij kishin hyrë thellë në dëborë për të prekur tokën. Për rreth shkëmbinjte dhe pishat dukeshin sikur bënin roje. Kurse atje, mbi tri-dhjetë metra prapa një brezi gurësh nxinin disa tyta pushkësh, po asnjë kokë njeriu nuk dukej.

Qerimi flaku tej cigaren, pa njëherë sahatin e dorës dhe, si u mendua pak, shkoi te dera me hap të shpejtë dhe e hapi aq sa iu duk gjysma e trupit. Era ja përplasi flokët e dëborës në fytyrë.

Të gjithë shokët brënda e ndjenë të ftohtin e madh. Komandanti mbushi mushkëritë me ajër dhe bër-titi me sa fuqi që kishte:

— Ç'ka po bani, he burra! Jam Qerim Juba, komandant i postës së kufinit.

Asnjë nuk lëvizi, asnjë nuk iu gjegj zërit të tij, përveç erës që përzihej me zhurmën e motorit. Ata ishin bërë rrafsh me dëborën e nuk u dukej asgjë përveç grykave të pushkëve. Zëri i oficerit u dëgjua sërish:

— O Marash Pjetri! As ti s'po më njef a?!

— Pse, malësorët tanë janë? — pyeti doktori. Pilotët heshtën.

— O Marash Pjetri! jam unë Qerimi. Kena ardhë me doktorin për ushtarin e sëmurë. O Ma-rash Pjetri! As ti s'po më njef?

Atëhere u duk sikur shkëmbinjtë shkundën dëborën. I pari u ngrit e hodhi belxhikun krahut, një burrë afro dy metra i gjatë dhe vrapoi në drejtim të helikopterit, pastaj u ngritën të gjithë e nisën të vinin grupe grupe nga të gjitha anët.

Komandanti doli nga helikopteri i pari. Nuk priti më, po kërceu në dëborë, ku pothuaj sa s'u mbulua i tëri. Një dorë e fuqishme e ngriti. Ishte Marash Pjetri, kryetari i këshillit të fshatit. Mustaqet e gjata deri te veshi, të zbardhura nga flokët e dëborës dhe gjerdani i fishekëve i jepnin një pamje akoma më burrërore.

— Na fal, o shoku komandant. Për pak e pa-tëm hangër sapunin për gjath. Pamë këte aeroplan të çuditshëm. Bora s'na linte të shifnim yllin tonë e unë dhashë sinjalin. Burrat rrokën armët. Men-duem se asht i huej!

Komandantit edhe i vinte të qeshte, edhe i

vinte mirë. I pa dhe njëherë ata burra të ashpër e viganë, si viset ku jetonin. Duart e tyre të fuqishme, që mbanin hekurin e ftohtë, nuk u dridheshin aspak nga acari i madh. I hodhi dhe një sy helikopterit, që ngjante si rob në mes të atyre trimave dhe u bind se kishin të drejtë. Të gjitha shenjat dalluese i qenë mbuluar nga dëborë, me përjashtim të hundës së tij, ku ende mbizotëronte temperatura e lartë e motorit të nxehur, që tani ishte fikur. U hodhi dhe një sy të gjithëve dhe përnjëherë iu duk se dikush mungonte. Mori një pamje serioze dhe, pa u përshëndetur me asnjë, pyeti:

— Po ushtari i sëmurë në postë, si u ba?

— Ma mirë asht, shoku komandant. Ai u rrëxue bashk me një ortek bore tek kryente shërbimin. Ka dhimbje në bark. Ndihmës-mjeku thotë se duhet me e operue.

— Ma mirë asht, ma mirë — ja pritën malësorët.

Të gjithë morën frymë lirisht. Atëhere nisën përqaftimet.

Piloti i parë iu afrua Qerimit. Ky i fundit e pa me dashamirësi. I buzëqeshi ëmbël dhe tundi kokën, si të donte t'i thoshte prapë: «njerëzit këtu janë si bjeshkët e tyre, por dhe unë, që i njoh mirë, këtë të sotmen s'e prisja».

Marash Pjetri rrinte si i turpëruar. Kryet e ulur mbi kraharorin e gjerë i ngjante si degë lisi e përkulur nga pesha e dëborës. Komandanti i ra lehtë në sup në mënyrë miqësore dhe të gjithë së bashku, me pushkët krahaqafë e grykat kthyer poshtë, u nisën në drejtim të postës së kufirit për të parë ushtarin e sëmurë dhe për të vendosur për të.

Më i gëzuar nga të gjithë ishte Qerimi.

LINDJA E DITËS

Ndiqte me sy shtëllungat e purpurta të reve, që dëboheshin nga veriu i lehtë. Mendimet e tij ishin ma të shkathta se lëvizja e shtëllungave të reve. «A do të mund ta kryej detyrën?» Kjo pyetje qëndronte pezull mbi kuvertën e anijes, mbi sipërfaqen e detit dhe lëvizte me shtëllungat e purpurta të reve në perëndim të diellit. Dy-tri pulëbardha vërtiteshin të gëzueme për rreth dyrekut të vaborit të mbytun. Vërshëllimat e sirenavë të vinçave, të anijeve tregëtare dhe të trenit të qytetit ja ngatërronin rrjedhën e mendimeve Durimit. Nji motos kaf e çau ujin me shpejtësi e doli nga porti. Durimi u ngrit nga hambari i traleve dhe u nis për nga kuzhina. Ndërkaq ra zilja për pastrimin e vogël në anije. Detarët u shpërndanë me shpejtësi me peca dhe radace nëpër duar. Durimi mësyu nga lokali i motorave. Në hymje të lokalit u takua me skuadërkomandantin.

— Hajde të pastrojmë panjollat afër akumulatorëve, — i tha Durimit skuadërkomandanti dhe i dha nji grusht lecka pambuku.

Hynë në lokal dhe filluan pastrimin. Ma tej pastronin motoristët. Durimi fërkonte panjollat e aluminit në heshtje.

— Më dukesh si tepër i menduem, — i tha Safeti, skuadërkomandanti.

— Ndoshta se asht dita e parë në anije dhe më duket çdo gja si e pakapshme. Profesion i elektrikistit asht diçka e randë për mue, që kam punue deri dje në bujqësi.

Safeti u ngrit, ndezi dritën dhe tha:

— Nuk e beson sa lehtë do ta kesh. Nji vit do të rrimë bashkë dhe do të kesh gjithnji ndihmën time. Ti në teori je mirë.

— Ç'mirë jam unë në teori? Përmendësh i kam mësue edhe ato ligje e rregulla.

— Po të kesh për praktikën kaq kujdes sa ke për teorinë, do të dalësh faqebardhë. Nuk ka ndonjë punë të mbinatyrëshme këtu. Mjafton të kesh ndërgjegje në punë, të duash atdheun e par-tinë, të shikosh çdo veprim tandin në prizmin kla-sor revolucionar.

— Ka hall se s'mund të përvetësojë speciali-tetin? — pyeti motoristi Nuçi Qesja dhe, pa pritë përgjegje, vijoi: — Mos u baj merak, se asht punë që rregullohet. Kij parasysh ato që të tha Sa-feti, pa çdo gja do të shkojë si sahat.

— Punë, punë! — tha me za të naltë nji tjetër nga motoristat. «Po qe puna për këto që thoni ju, atëhere medoemos do të bahem detar i mirë» mendoi Durimi, po nuk foli. Ai i kish fja-lët të kursyeme.

Durimi fshiu mirë e mirë panjollat e alumi-

nit, fshiu edhe akumulatorët nga jashtë dhe thau pak naftë që kish rrjedhë në kallumë.

Ra zilja për të ngranë darkë. Dezhurni i mençës i kish shtruar tavolinat mbi kuvertë. Detarët e tjerë zunë vend pranë tavolinave, kurse Durimi priti t'i thosh skuadërkomandant Safeti të ulej pranë tavolinës.

Mbas darke, detarët u mbledhën në kubrikun e parë për kulturën masive. Ata që banin pjesë në grupin artistik shkuen në prova, kurse Durimi dhe të tjerët diskutuen një artikull të gazetës. Pastaj ndigjuen kolektivisht nga Radio-Tirana komentimin e javës. Në çdo veprim që bante, Durimit gjithëkund i delte para pyetja: «A do të mund ta kryej detyrën në rregull? Po sikur të kem difekte në postin luftarak dhe me gjithë dëshirën time të mirë të mos mund t'i evitoj? Kam të baj me teknikë! Po të ishte puna vetëm me punue me krah, do të baja të pamundurën».

Doli në kuvertë. Yjet vetëtinin në qiell. Ish një natë e qetë. Ditën kish fry erë dhe mbetë një det i vdekun; ndiheshin llapashitjet e lehta të valëve të ngathta. Papritmas, nga altoparlanti i anijes fqinjë buçiti kanga e Llesh Palit. U ul në një mushama dhe e ndigjoi kangën me andje. Kur kangëtarja popullore arriti deri në gjysmë të kangës, u mbyll altoparlanti.

— Mos, mor zot! — bërtiti Durimi. — Pse e mbylle, mor Zot!

— Ç'ke, mor Durim? — i foli nga mbrapa Safeti.

Atëhere Durimi u kujtue se e kish ngritë zarinin tepër.

— Hajde ndigjo në kubrik — tha Safeti —

Radiua e atyne ka difekt. Durimit i erdhi zor të vraponte në kubrik.

— Nejse, mbaroi tashti — tha dhe qëndroi në kambë, pështetë për shtratin e topit të bashit. Po në atë çast u hap prapë altoparlanti dhe u ndigjuen fjalët:

*Të kanë rrethue me kunorë
Ta kanë dhanë emnin dëshmorë
T'martoi nana n'vi t'kufinit
Njikso nuse i jepet trimit,
Nusja jote asht dekorata,
O fleta e nderit dhe lavdata — hej.*

— Sa bukur asht të vritesh për atdhe dhe të këndohesh kështu! — tha Durimi.

— Të vritesh për atdhe asht bukur vërtet. Dhe të kesh këtë shpirt asht bukur, por që të andërrosh të këndohesh, nuk asht andërr revolucionare.

— Pse?!... — pyeti i habitun Durimi.

— Se atëhere puna jonë do të shndërrohej nga punë për atdheun e partinë në punë për lavdi. Na s'duhet të punojmë për lavdi. Kur kryejmë ndonji punë të madhe, asht mirë të mos na dihet as emni. S'ka randësi emni. «Kush e ka krye këtë punë?» do të pyesin njerëzit. Përgjegja le të jetë: «Nji ushtar i partisë».

— Shumë e drejtë, shoku Safet.

Mbas pak ra zilja për apelin e mbramjes. De-tarët u rreshtuen të gjithë në qiç. Bocmani bani apelin. Sonte listës së apelit iu shtue edhe një

emën i ri: Durim Asllani. Kur thirri emnin e tij, bocmani e vështroi një çast dhe mbylli fletoren.

— Ndigjoni, shokë detarë, — tha bocmani — Sipas planit, nesër do të kemi lundrim ku do të zhvillohen variante të ndryshme stërvitjeje. Këtu ju e dini, po desha t'ju njoftoja, se do të kemi edhe hedhjen e traleve, pra edhe të tralit elektromagnetik. Prandaj kërkohet prej jush kujdes i madh. Posa të mbarojmë fiskulturën e mëngjesit, do të fillojmë përgatitjen për lundrim. Qartë?

— Qartë, shoku bocman, po ate fiskulturën pse të mos e lamë, mbasi kemi lundrim — tha Nuçi Qosja buzagaz.

— Ajo fiskultura të mori në qafë ty -- tha bocmani.

— Hiq, mor dembel — e pasoi kryemotoristi. — Ky edhe ushqimin do ta donte në krevat.

Detarët qeshën. Qeshi edhe Durimi, ndonëse këto shaka nuk i ngjallën ndonjifarë humori. E qeshuna e tij i doli ma tepër nga kënaqësia që ndjeu, nga që gjindej në mes të atij entuziazmi. Imagjinoi se kështu do ta ndjente veten gjatë gjithë jetës së tij në det. E para natë në jetën e tij që ra në një krevat të varun në katër cepat me zinxhir. Dhe dysheku ish i mbushun me tapa të vogla. Po çarçafët kishin një aromë të kandshme dhe Durimi filloi të mendonte në qetësi. Shokët i zuni gjumi. Dikush gërhiste, dikush merrte frymë randë. Ate nuk e zinte gjumi. Herë mbyllte sytë e mendonte, herë shikonte dritën e gjelbër të zbetë, që përhapej nëpër kubrik nga llampa e gjumit. «Tani fillon një jetë e ré për mue — mendoj. — A do të mund ta kryej vallë këta dety-

rë? A do të mund ta meritoj titullin ushtar i partisë?»

Befas e zuni gjumi. Kur dëgjoi zilen e zgjimit nëpër gjumë, disi u trondit. Ai s'e kish ndie ndonjiherë këte tingëllimë rënqethëse. U ngrit me të shpejtë, veshi pantallonat e këpucët dhe brofi në kuvertë. Vrejti se vetëm dy vetë kishin dalë para tij. Kur arriti në kig, pa se ishin çue edhe oficerat dhe prisnin të rreshtoheshin efektivi. Duri mi zuni vend në rresht ndër të parët.

— Duket që ky ka ardhë nga shkolla e instruksionit, — tha ndihmëskomandanti. — Asht ma i shkathët.

Durimit iu ba qefi nga këto fjalë që u thanë për të.

Mbasi mbaroi fiskultura, u dha sinjali për pregatitjen e anijes për lundrim. Tani Durimi s'dinte ç'të bante. Iu paraqit skuadërkomandantit. Sifti i tha:

— Hajde mbas meje dhe shiko me vemendje!

Ata hoqën ma parë kablën e madh, që shërbente për të marrë korrent nga rrjeti elektrik i qytetit. Pastaj u futën në lokal dhe takuen të gjithë çelësat, që u jepnin rrymë aparateve dhe postave të ndryshme luftarake. Sifti i tregonte Durimit.

— Ky çelës i jep korrent radios, ky klloti-këve, ky xhirobusullës, ky hidroakustikës, ky...

Durimi i rregjistronte të gjitha si aparat fotografik. I fiksoheshin në kokë dimensionet, format, ngjyrat e çelësave dhe shkronjat në gjuhët e hueja që mbanin etiketat dhe instruksionet e aparateve. «Duhet të jem në gjendje t'i përdor që sot», — mendonte ai.

Si u takuen të gjithë çelësat dhe u përgatitën mjetet, Safeti raportoi:

— Posti luftarak i 11-të gati për luftë e lundrim!

Zhurma e motorëve aty në lokal ishte ba e tmershme. Durimit sikur diçka ja çponte timpainin. Por ngadalë nisi të mos e kish aqë randë. Veshët i buçisnin, por nervat iu qetësuen. Mbas pak anija nisi të lëkundej. Durimi pyeti Safetin pse lëkundej anija. Ky s'mori gja vesht nga zhurma e madhe e motorëve, ndaj ia afroi veshin te goja shokut dhe, kur e dëgjoi pyetjen, i tregoi me dorë se anija kish dalë jashtë portit.

Lëkundjet e anijes rriteshin çdo minutë. Durimit nisi të mos i pëlqejë që anija lëkundej. Ai shikonte sinjalet që jepeshin me anë të dritave të kuqe dhe zbatimin e tyre nga motoristat. Kur anija pakësonte shpejtësinë, atij diç i përzihej në stomak. Ma në fund, i erdhi për të vjellë. Safeti e hetoi dhe i afroi legenin. Durimi volli, por nuk u lehtësue. E vazhdoi këtë avaz, derisa nuk i mbehti asgja në bark. Pastaj filloi të nxirte vner. Ishte vështirë të nxirrej gjithçka nga stomaku, po ai këte do ta duronte. Dhimbja e kokës dhe të randët e stomakut ishin të padurueshme. Safeti dhe motoristët e tjerë e këshilluen të shkante e të shtrihej në kubrik, por ai s'pranoi. Njeni nga motoristët i shtroi një mushama në një qoshe të lokalit, po ai s'pranoi të shtrihej.

— Jam në rregull, s'kam gja, — thonte në mes të zhurmës.

— E dimë se në ç'gjendje je, — i thoshin ata.

— E kemi provue para teje. Shtrihu se të ban mirë! Rrin ma lehtë!

— Jo!

Pastaj u dha sinjali: «Gaz!» Motoristët futën kundërgazet në kokë. Durimit i tha skuadërkomandanti të mos e vinte kundërgazin. Ai desh të mos e zbatonte urdhërin, por u kujtua se duhej të nënshtrohej. Ndërkohë erdhi shefi elektromekanik dhe i bani vrejtje Durimit. Safeti i shpjegoi si ishte puna. Shefi i tërhoqi vrejtjen Safetit. Pastaj:

— Këto punë bahen me urdhën të komandantit të anijes — tha ai. — Pse e ze deti s'do të thotë që t'i shmanget stërvitjes. Ne kemi edhe detarë të tjerë që na i ze deti.

Durimi, i skuqun nga turpi, vuni shpejt kundërgazin. Shefi elektromekanik doli nga lokali dhe erdhi përsëri. Durimi e ndjente veten ngushtë. S'kish ç'të vllte ma, po megjithate gërmohet. Shefi e kuptoi gjendjen e tij, prandaj i tha ta hiqte kundërgazin.

«Ku ka ma turp?» — mendoi Durimi. «Kështu bajnë burracakët dhe jo ushtarët e partisë. Po ç'të baj, pra? Kjo s'asht në dorën time. Oh sa keq! Po sikur të jem në front?!... Po të jem në front, do të qëndroj e do të luftoj deri në fund. Për luftë jam dhe kështu».

Ndërkohë nga ura e komandimit u dha varianti i avarisë. Supozohej se në bordin e djathtë, në lokalin e motorave kish ra një predhë artilerie. Tani duhej evitue «avaria» Motoristët u vunë në lëvizje të rrufeshme: mblodhën pyka, kunja e jastëkë avarie dhe nisën të zanë «avarinë». Po sakaq shefi u tha që të evitohet avaria në kushtet kur s'ndodhen ato mjete. Si do të zihej? Atëhere

Nuçi Qosja i vuri shpinën vendit ku supozohej të ish avaria.

— Pregatitni mjetin! — tha ai. — nuk e la unë të vërshojë uji.

— Të heqim bluzat — propozoi Safeti. — T'i bajmë shuk dhe t'i fusim «në brimë»

— Shumë mirë — tha shefi elektromekanik dhe doli jashtë. Lëkundjet e anijes u banë shumë të fuqishme. Motorat lëshonin një nxehtësi që të zinte frymën. Era e karburantit bahej ma e theksueme. Me një fjalë, për Durimin ishte zor qëndrimi aty. Ç'të bante? I thanë të dilte, por nuk ndigjoi. Donte të nxirrte edhe zorrët, po s'kish ç'të nxirrte tani. Edhe në kambë qëndronte me zor. Kish shtrëngue një tub nafte me të dy duert dhe shikonte veprimet e detarëve dhe sidomos të Safetit. Deti ish egërsue ndonëse koha ish e mirë. Frynte një erë e fortë ashtu si e ka zakon shpesh herë gjatë ditës, në det, e sidomos nga mezi i ditës.

Papritmas, nisi të vjellë Nuçi Qosja. Pastaj edhe një motorist tjetër. Edhe ata të mbikuvertës i kish lodhë deti, po as që mund t'i pengonte në kryemjen e detyrës. Durimi sa vinte e lodhej. Nja dy detarë e kapën dhe e shtrinë në mushama. Qëndroi ashtu i shtrimë. E ndjeu veten ma të lehtësue. «Ç'po baj kështu? — mendoi. — Ky asht alarm luftarak. Luftë. Stërvitja duhet zhvillue si në kondita lufte. Kjo që po baj unë e humb seriozitetin e stërvitjes. Këto variante stërvitjeje duhen konsiderue variante lufte. E unë rri i shtrimë këtu. Turp për mue. Kështu do ta kryej detyrën?» Kjo pyetje e tronditi. Iu duk se ja thanë

të gjithë shokët njiherësh. Edhe ulërима e motorëve këtë pyetje i bante. Edhe aparatura elektrike e anijes. «Kështu do të bahesh ushtar i partisë ti? Ngrehu dhe qëndro në krye të detyrës!»

U ngrit në kambë dhe futi kundërgazin krahaqafë.

— Ulu, mor Durim! Atdheu nuk kërkon që të damtojmë veten pa qenë nevoja.

— Atdheu kërkon të kalitemi dhe, tue ndejë shtri, s'kemi si të kalitemi, — bërtiti ai; por shoku nuk mori vesht; zani i tij ish dobësue. Durimi nisi të ndjekë përsëri me vemendje veprimet e Safetit.

Ndërkaq, pushoi alarmi. U vendos gadishmënia ushtarake numër dy, domethanë vetëm një motorist të qëndrojë në postin luftarak. Durimi doli mbi kuvertë. Rrezet e diellit po thyheshin në kreshtat e dallgëve, të cilat vinin kurrize kurrize dhe shkapeteshin për bordin e anijes. Pejsazh plot llahtar. Gjithnji kish pasë dëshirë të shikonte sipërfaqen e detit dhe lodrimin e dallgëve, por kësaj here s'po i pëlqente. Kur u fut në lokal së dyti, qëndrimi aty ish i pamundun. Aromat e lokalit nuk duroheshin fare. Safeti e kuptoi atë, prandaj i tha të qëndronte në kuvertë. «Kështu do ta kryej unë detyrën?» — e pyeti veten me habi. — «Jo, jo do të qëndroj. Le të bahet ç'të bahet.» Po ndërkaq Safeti ja la shërbimin motoristit, që zavendësonte sipas rolit luftarak. Mori Durimin për dore dhe, tue dalë jashtë, — i tha:

— Do të shkojmë në kubrik, se kemi dy orë pushim tani.

Të lidhun doradorë, shkuen në kubrik. Duri-

mit gjithnji i vinte për të vjellë, ndonëse s'kish ç'të vllte ma.

— Shtrihu ma mirë! — i tha Safeti.

Durimi u shtri në krevat.

— Paskë qenë njeri i çuditshëm — tha njeni nga motoristët.

— Paska qenë deti i çuditshëm, jo unë.

— Mor po ke ndigjue ti se të gjithë detarët i mundon kështu në fillim?

— Nuk ban me të gjithë kështu. Ka prej atyne që nuk i zen. Me mue po vepron në veçanti, më duket.

— Mor po je në vete ti? E pe që na zuni detarët që kanë afro katër vjet në det apo jo? Ehu, s'e ka deti ashtu. Ditët e para deti të lodh ma tepër, pastaj puna sa vjen e rregullohet. Edhe në të zantë, të lodh ma pak.

«Sidoqoftë, unë nuk po e kaloj ashtu siç e kisha mendue. Nuk e kam besue se do të më çalojë puna që ditën e parë. Kam mendue gjithnji vetëm rreth teknikës. Dita e parë e detyrës nuk më doli me sukses! — mendoj.

Ndërkaq u hap radiua dhe vërshoi melodia e kangës «Qesh vogëlushi im». Asnjihërë nuk e kish pritë muzikën kaq me kënaqësi Durimi! Sa mirë që radiua u hap me kohë dhe ai e ndigjoi qysh nga fillimi:

*Fishekzjarret n'qiellin blu,
po ndriçojnë sonte kudo,
qesh vogëlushi nanës qesh,
qesh ti sonte mos pusho.*

.....

Çfarë ilaçi asht kjo muzikë! — mendoi. — M'u fashit tanë drobitja. Sa bukur! Shikoi nëpërmes iluminatorit që kish tek kambët e krevatit. Mali, që ishte përtej, ngrihej dhe ulej me ritme të çrregullta. Mbasi mbaroi kanga, spikeri tha:

— Dëgjuat këngë nga muzika e jonë...

— Mos! — tha Durimi me keqardhje.

— Shumë të pëlqyeka muzika! — i tha Safeti.

— Shumë më pëlqen vërtet. Po besoj se të paktë janë ata që nuk u pëlqen. Asht e pamundun mos të të prekë në shpirt kjo kangë.

— Gja e bukur asht vërtet. Mirë që të pëlqyeka, se këtu muzikën e kemi me bollëk. Radio kemi, manjetofon kemi, prandaj do të të ushqejmë. Me muzikë të ze edhe deti ma pak, po ç'e do që në lokalin e motorave nuk ndigjohet.

Radio-Tirana po jepte lajmet. Durimi po i ndigjonte i kënaqun nga sukseset që kishin arritë ndërmarrje të ndryshme ekonomike për nder të 25 vjetorit të Partisë dhe të Kongresit të saj të Pestë. E ndjente veten ma lehtë. Po kjo nuk zgjati shumë. Lëkundjet e anijes po baheshin ma të randa. Ai ndjeu nevojën të vjellë, po vetëm pak vner nxorri. Tani ndjente një shtypje të madhe në stomak. I lindi dëshira të kapte barkun me dorë dhe ta shtrëngonte. Po të ish ndonji njeri tjetër që duronte pak, me siguri do të bërtiste nga halli, po ai ja kishte vue detyrë vetes të qëndronte.

Ra zilja për të ngranë. Dezhurni i mencës shtroi tavolinat, solli ushqimin dhe detarët, që ishin në pushim erdhën të hanin. Durimi jo vetëm që s'mund të hante, po nuk donte as ta shifte me sy ushqimin. E lutën për shumë gjana, po s'pranoi. Tani nuk gjente ma rehati as në krevat, s'dinte si

të vepronte. Asnjherë s'e kish pa veten ma ngushtë. Në një anë vëjtje fizike dhe nga ana tjetër vëjtje shpirtnore për detyrën, së cilës nuk po i qëndronte dot në ballë.

Fill mbasi mbaruen së ngrani, u dha alarm luftarak dhe mbas pak, u dha njëfarë sinjali që Durimi s'e kish ndigjue ma parë. Ky sinjal njoftonte efektivin për hedhjen e tralit elektromagnetik.

— Hajde mbas meje! — i tha Safeti dhe shkuen në këmbë. Në hambarin e traleve Safeti takoi një çelës, pastaj doli jashtë, kapi reostatin e arganos së traleve dhe nisi të rrotullojë dorezën.

— Këtu duhet pasë kujdes i madh — i tha Safeti. — Nga lëvizja e dorezës varet shpejtësia e rrotullimit të tamburës. Nëqoftëse do t'i japësh ndonji shpejtësi të panevojshme, rrezikon këputjen e tralit dhe le se ç'damtime sjell...

Një dallgë e furishme u përplas në kuvertën e këmbës. Anija pësoi një lëkundje të tmershme dhe Durimi u shkapet për tamburën e traleve. Për një çast iu errën sytë nga goditja që kish pësue në kokë. «Tani u çburrnova», mendoi. Po ndërsa e ngritën shokët, ai e mposhti të keqen.

— Më lëshoni, se nuk kam gja! — tha.

— Je vra randë! — tha Safeti.

— Jo, jo, s'ndjej asgja. Jam në rregull.

Ndërkaq erdhi komandanti i anijes.

— Shko shtrihu në kubrik! — i tha Durimit.

— Jam mirë, shoku komandant.

— Të urdhënoj të shkosh. Merreni, ti Mark dhe ti Vangjo. S'duem të sakrifikojmë jetën e detarit pa pasë nevojë atdheu.

Shkoi në kubrik dhe u shtri në krevat, po rehati nuk gjeti. I dukej sikur diç i që futë në sto-

mak e në krye e mundohej t'ja shkatërronte ato organe. Ai kaloi ashtu një copë herë të madhe, mandej u ngrit dhe doli jashtë. Trali që mbledhë. Detarët qëndronin nëpër poste luftarake.

Pastaj anija arriti në zonën ku kish ma pak det. Aty u zhvillue stërvitje deri në mbramje. Durimi mori pjesë në stërvitje.

Atë natë anija nuk u kthye në bazë, se kish radhën e shërbimit.

— Po të bahet tepër randë, — i tha Safeti Durimit. — Tanë ditën të ka mundue deti dhe tash të rrish prapë. Po s'ke ç'i ban. Besoj se do të jetë ma lehtë. Erë s'ka. Deti i vdekun do të she-titet.

— Tani s'më ban përshtypje. Le të ketë det sa të dojë.

Por në të vërtetë, kur dolën në vijën e dororit, filloi prapë avazi në stomak. Dhimbja e kokës, që e mbërtheu, që ma e fuqishme se asnjherë. «S'do t'ua ve veshin; — mendoj. — Unë do të qëndroj në kambë e nami të bahet.»

Deri në orën dhjetë të mbramjes të gjithë detarët qëndruen nëpër postet luftarake. Pastaj qëndroi në shërbim ndërresa e parë dhe të tjerët banë pushim nëpër krevate. Kur fjeti Safeti, Durimi shkoi në lokalin e motorëve, tue u mbajtë me vështirësi. I kish kalue 24 orët pa hangër asgja dhe tue vjellë vazhdimisht. Tani s'kish ç'të villo ma, veçse gërmohej kot. As vner s'i kish mbetë. Në lokal të motorëve gjeti motoristin dezurn. Ky buzëqeshi kur e pa.

— Pse s'rri shtrimë? — i tha motoristi në vesh.

— S'më rrihet kërkund — u përgjegj Durimi dhe filloi të vërejë me imtësi çelësat në kuadrin elektrik.

«Ky çelësi i kuq i jep rrymë xhirobusullës, ky tjetri hidroakustikës», thosh me mend. Vazhdoi të përsërisë në këtë mënyrë funksionet që kryente secili çelës. «Nuk paskam harrue asgja», mendoi. Kjo këtu në fund asht elektropompa, ky këtu kuadri i saj, kjo asht arka e pjesëve të këmbimit të sistemit elektrik, kjo... Bah, sa duhmë e tmer-shme! Kjo era e karburantit qenka e padurueshme në det!»

Tue u zvarrisë me vështirësi, shkoi në lokalin tjetër të motorëve. Aty gjeti dezurn Nuçi Qosen.

— Ku vete, ore? — e pyeti ai.

— Ja, të shof...

— Ç'të shohësh, o t'u mbylltë, po shko shtri-hu, se shih si u bëre!

— Nuk jam keq.

— S'është nevoja të thuash se si je. Dukesh në fytyrë.

— S'më ze gjumi. S'rri dot ra.

— Shko në urën e komandimit, të paktën e jo në lokal.

Durimi vazhdoi punën e tij. Kish vendosë të mos rrinte ra. Shikoi të gjithë aparaturën elektrike të lokalit dhe doli jashtë. Hypi edhe në urën e komandimit. Aty gjeti timonierin dhe sinjalistin. Komandanti ishte në kabinën e shturmanit.

— A je ma lehtë, — e pyeti timonieri.

— Ma mirë jam, — tha Durimi.

— Asht ca ma i zbutun deti tani.

— Ah, ky deti i vdekun! — tha sinjalisti, që edhe atë e zinte ndonëse kish dy vjet në atë anije.

Durimi shikoi hapsinën qiellore. Yjet vezullonin në qiell dhe vegonin në det nga reflektimi i përthyer i dallgëve. Konturet e maleve nxinin përtej. Diku në breg, qyteti ishte ndezë nga dritat e shumta elektrike. Vegimi i atyne dritave ishte ngjitur në qiell. Edhe yjet dukeshin të dobët mbi qytet. Durimi vërejti ca horizontin, pastaj shikoi në errësinë teknikën e anijes: busullat, timonin, repiterat e xhirobusullës, kllolikët, prozhektorin, mitralozat e sa gjana të tjera që ndodheshin aty. Tani, për të parën herë gjatë asaj dite, sikur e ndjeu veten ma lehtë. Nuk po i gërmohej ma në stomak. Këte gjendje ua shprehu edhe shokëve.

— Po të sjell ushqim, — i tha timonieri.

— Bah, në asnji mënyrë! Nuk e shof dot.

— Ke mundësi të hash. Do të shohësh sa do të forcohesh.

— Të falem nderit! S'ke pse...

— Do të sjell vetëm bukë të thame në furrë dhe djathë.

— More nuk mundem. Mos më thuej.

Pastaj ata hapën një bisedë të përzemërt e intime në mes të tyre, po Durimi donte të bisedonte gjithnjë për çështje të detyrës. Për atë çdo gjë ishte e re, kurioze në anije.

Ndërkaq, në urën e komandimit hypën komandanti dhe komisari. Detarët u ngritën në kambë në shenjë respekti për eprorët.

— Mos luani! Rrini dhe vazhdoni bisedën! — tha komisari. — Ti je detari i ri? — i tha Durimit dhe, pa pritë përgjegje vazhdoi. — Nuk po të ze deti tani?

— Tani po më ze ma pak.

— Gjatë ditës ke vujtë shumë... Po kështu e

ka deti në fillim. Edhe unë kam vuejtë mjaft, kur erdha, se para dy muejsh kam ardhë këtu. Kam qenë në kambësori.

— Ky na ka ba një vërejtje për karburantin, — tha komandanti. — Sapo erdhi në anije, na qortoi për shpërdorim karburanti...

— Po thuej, nuk ka të drejtë? .. Edhe unë jam krejt dakord me Durimin.

Si biseduen ca, komisari i tha Durimit:

— Shko pusho në krevat, se të ban mirë. Kur të ngrihesh pastaj, do të jesh ma i fortë.

— Më pëlqen të rri këtu, — tha Durimi.

— Mirë, mirë, si të të pëlqejë — tha komisari. — Unë pra po shkoj të pushoj pak. Shërbim të mbarë djema!

— Gjumë të mirë, shoku komisar! — thanë detarët njizani.

Komandanti qëndroi edhe ca në urën e komandimit pastaj u largue nga kiçi i anijes.

Mbas pak, Durimit nisi t'i vinte gjumë. U mbështet për një salvaxhent llastiku dhe nisi të gërhiste. Po shpejt i doli gjumi nga një andërr e trishtueshme.

— Ç'pate? — i tha buzagaz timonieri.

— M'u duk se më zu korenti elektrik... Dreq, o punë!

— Ke këcye shumë. Më trembe edhe mue.

Durimi u ngrit, shkoi në lokal të motorave, shkoi të gjithë kuadrin elektrik edhe njëherë, tue përsëritë me mend funksionet që krynte çdo çelës dhe shkoi në kubrik. E zuni gjumi menjëherë. Papritmas, buçitën ulërimat e sirenave dhe të zileve elektrike. Alarm luftarak! Durimi kërceu nga krevati. Zilet vazhdonin të binin. Mbrenda disa se-

kondave detarët dolën në postet luftarake. Tue kal-
lue nëpër kuvertë, Durimi ndigjoi një krizëm dhe
pa një fishekzjarri, ai pa një dritë të kuqe në sipër-
faqen e detit. Nuk pati kohë të shikonte ma, se
duhej shkue në postin luftarak. Në lokalin e maqi-
nerisë kundërmonte era e randë e karburantit dhe
temperatura ishte rritë së tepërmi nga që ishin
ndezë të gjithë motorët. Kjo duhëm e bani Duri-
min të gërmohej edhe njëherë në stomak, po nuk
nxorri gja. Vuni kundërgazin kraheqafë dhe që-
ndroi në postin e tij. Të gjithë postet luftarake ra-
portuen për gatishmëninë luftarake. Raportoi edhe
Safeti.

— Posti luftarak i 11-të gati për luftë!
Raportoi edhe ndihmëskomandanti:

Shoku komandant, anija gati për luftë!
— Ngreje spirancën! — urdhënoi komandanti.

Safeti vrapoi te argonoja e spirancës. Shkoi
edhe Durimi. Safeti takoi rrymën dhe lëvizi dore-
zën e reostatit. Për çudi argonoja nuk lëvizi. Safeti
rrotulloi përsëri dorezën, por spiranca vazhdonde të
qëndronte në fund të detit.

— Nuk funksionon — i tha Durimit Safeti.
— Mos! Si të bajmë? Mos asht djegë sigure-
ca?

Safeti i turpënuem raportoi në vendkomandën
kryesore. Komandanti urdhënoi të nxirrej spiran-
ca me anë të levave. Duhej ba ç'mos që të ndiqej
anija e panjoftun, që shkonte në drejtim të atdhe-
ut dhe nuk u përgjigjej shenjave të njoftjes. Deta-
rët e bashit kapën levat dhe nisën të tërheqin
spirancën. Safeti hapi kuadrin e sigurecave për të
pa mos ish djegë sigureca, por ato ishin në rregull.

Kontrolluen karbonçinat e elektromotorit. Edhe ato ishin mirë.

— Ç'djall na ndodhi kështu? — i tha i prekun Safeti.

— Mos e ka fajin reostati? —tha Durimi që tashma nuk e ndjente lodhjen e detit.

Morën lllampën portative, zberthyen reostatin dhe filluen të kontrollojnë. Ndërkohë detarët e nxorrën spirancën dhe anija mori udhë. Fishekszjaret vazhdonin. Anija e huej nuk ndalej. Intensitetet psiqik në radhët e ekuipazhit. Durimi me lllampën portative në dorë shikonte me imtësi të madhe të gjitha vidat, fijet, rezistencat e kondensatorët. Lëkundjet e anijes baheshin gjithnji ma të forta, dhe uji hypte mbi kuvertë. Kjo ua vështirësonte punën elektricistëve. Uji i krypun u fut mbrenda në aparat. Anija ecte përpara me të gjithë shpejtësinë, po prap anijen e panjoftun nuk e arrinte dot. Komandanti dha urdhën të lëshohej raketa e kuçq, që paralajmëronte zjarrin. Sinjalisti ia lëshoi edhe atë, po anija e panjoftun nuk po bindej. Atëhere, komandanti me komisararin menduen të hapin zjarr, por të mos qëllohej anija me të parën.

— Topi i bashit gati! — u dha komanda, dhe mbasi u dha distanca, kursi dhe pelengu, u ndigjue: — Zjarr!

Nji krizme e tmershme tronditi anijen dhe nji dritë verbuese vegoi si rrufe. Mbas pak u ndigjue një kërkëllitje zinxhirësh në largësi!

Ndërkaq, Safeti dalloi nji fije përçuese të këputun dhe e lidhi me shpejtësi.

— Nesër do ta saldojmë! — tha enthuziast. E mbërthyen shpejt dhe e provuen. Tani ar-gonoja funksiononte për mrekulli. Safeti dhe Du-

rimí ishin ba qull nga dallgët që u shpërthenin në kuvertë. «Oh, sa mirë! mendoj Durimi. Sikur të mos ish Safeti, ndoshta s'do ta vija në gadishmëni as nesër. Ja, çfarë të papritunash ka detyra luftarak!»

Safeti raportoi për gadishmëninë e postit luftarak. Pastaj të dy elektrikistët shkuen në lokalin e motorëve.

— Ti, po të duesh, qëndro në kuvertë dhe, kur të paraqitet nevoja, nxirr spirancën nga deti. Tani e din si të veprosh me reostatin apo jo? — i tha Safeti Durimit.

— Si urdhënon, shoku skuadërkomandant!

Anija e jonë luftarake zuri përsëri vijën e shërbimit. Kur u dha komanda: «Hidhe spirancën» Durimit i rrafi zemra me furi. U afrue pranë reostatit, ktheu dorezën e rrymës, pastaj zuni të lëvizte ngadalë reostatin. Elektromotori nisi të ulërijë dhe argonoja nisi të lëshojë gadinën në det. Të rrafunat e forta të zembrës u zavendësuen nga një entuziazëm i ambël.

— Bravo, elektrikisti i ri! — i tha bocmani.

Durimi ja shtoi shpejtësinë argonos dhe spiranca s'vonoi të binte në fund të detit. Stakoi çelësin dhe mori një leckë për të fshi reostatin. Ndërkaq ra edhe një dallgë, që arriti deri në urën e komandimit. Durimi e prapësoi punën. «Dallgët qenka zor t'i mposhtësh!» mendoj. Shkoi në urën e komandimit. U ul në një qoshe, se kish të pështjellme të forta në stomak. Shikoi qiellin. Yjet nuk e kishin ma vezullimin e përparshëm dhe ishin ma të rrallë. Çdo objekt në natyrë nisi të shquhej ma qartë. Nga lindja dukej sikur dikush po e priste

tylin e errësinës. Durimi u ngrit në kambë, dhe shikoi lindjen. Kish kohë që s'e kish soditë lindjen e ditës në këtë mënyrë. «Kalova një natë pa gjumë si pa e kuptue fare. Kur iku nata kaq shpejt? Kushedi ç'detyrë më presin në të ardhmen! Deti qenka i çuditshëm!... Iku një natë plot vështrësi, por tani leu dita e re. Ndoshta edhe sot do të provoj ndonji rrebesh, ndonji të papritun.»

— Ti, po të dësh, qëndro në kuvertë dhe kur të parqitet nevoja, nxirr spirancën nga deti. Tani e din si të veptosh me reostatin apo jo? —
i the Sateti Durimit.

— Si urdhëron, shoku skuadërkomandant!
Anija e jonë luftarake zuri përse një vijën e shpërbimit. Kur u dha komanda: «Hidhe spirancën» Durimit i trazi zemra me furë. U afrue pranë reostatis, këtu dorezën e rrymës, pastaj zuri të ulëvizte ngadalë reostatin. Elektromotori nisi të ulëvizte dhe argonja nisi të lëshojë gazin në det. Të trauat e forta të zemrës u zvendësuan nga një entuziazëm i ambël.

— Bravo, elektricisti i ri! — i the komandanti. Durimi ja shtoi shpejtësinë argonos dhe spirancës s'vonoi të binte në fund të detit. Shtoi çelësin dhe mori një leckë për të fshi reostatin. Ndërkad ra edhe një dallgë, që arriti deri në urën e komandimit. Durimi e prapësoi punën. «Dallgët përka zori t'i mposhtësh!» mendoi. Shkoi në urën e komandimit. U ul në një doshë, se kish të pështejtë me të forta në stomak. Shikoi djellin. Yjet nuk e kishin ma vezullimin e përparshëm dhe i shinin ma të mallë. Çdo objekt në natyrë nisi të shpudhet ma partë. Nga lindja duket sikur dikush po e priste

TASIM ALIU

TE FSHEHTAT E LAVDISË

Kish plot tri netë që Kruja ziente e buçiste nga galdimi. Festa i kish rrëmbyer të gjithë banorët me turma e me pari. Faltoret ishin plot dhe buisnin si asnjëherë nga lutjet dhe ngazëllimi për kryetrimin. Skënderbeu nuk mund të çlodhej për asnjë çast. I vinin paprerë letra, urime dhe dhurata nga të katër anët e krishterimit. Dhe ai kthehte përgjigje urimi, letra a peshqeshe në të katër cipat ku sundonin princët miq. Hareja e atyre ditëve qe e rrallë në botën e qytetëruar. Kryetrimi kish korrur dy fitore të rrufeshme në dy ditë. Kjo ngjarje qe aq madhështore, sa dhe e pabesuar. Ish një nga ato mrekullitë e luftës, të cilën mund ta përsoste kështu vetëm Skënderbeu.

Ndërkohë në pallat ja mbërriti një lajmëtar. Një farë arabi nga Aleksandria, i quajtur Kebir el Rustem Gaxhi, kërkonte të takonte Princin e madh arbëror-Skënderbeu.

Kryetrimi e lejoi dhe, ndërkohë, dha urdhër të gatitej çdo gjë për pritjen e mysafirrit. Në krye të fronit vetëinte kurora e artë e kryetrimin, i ci-

li rrinte më këmbë, madhështor dhe fuqiplotë. Në të djathtë qëndronte Tanush Topia, i regjur në luftëra e fitore. Në të mëngjër të Princit, Zahari Gropa e Pejko Manueli ngjanin si dy binjakë. Ata duheshin si vëllezër. Kudo gjëndeshin bashkë. Të dy ishin të paarritur në burri e bujari. Oda e pritjes qe shtruar me qilima të kuq. Që larg u dëgjuan hapat e rënda të arabit. Çdo gjë qe gati. Te dera u dha një trup i mdh e i zi sterrë. Arabi ish veshur e ngjeshur me armë, sikur do përballonte një ushtri të tërë. Llërëve dhe gjoksit i zgjateshin rripa-rripa muskujt e shumtë e të fuqishëm. Gjysmën e sipërme të gjoksit ja mbulonte një parzmore hekuri e veshur me flori. Në gjunjë kish kallçina të ndritura dhe brezi i qe mbushur me gjithfarë armësh. Në dorë mbante një përkrenare të zezë. Flokët e gjatë e të dredhur i derdeshin valë-valë supeve.

Përpara princit ai u përkul ngadalë e me madhësi dhe si ndenji ca ashtu, u drejtua sërish:

— Unë erdha t'ju takoja e t'ju shihja vetë, o princ i madh e i fuqishëm. Besoj se tek ju u ngjall së dyti Aleksandri i madh.

— Mirësenaurdhëruat

— Lé t'u bëhet rruga dritë ngado që të shkoni, o mirëdashës i largët, — ja ktheu kryetrimi. Si u përshëndetën kesisoj, Skënderbeu urdhëroi të shtrohej gësia e pritjes sipas zakoneve arabe.

Kebir el Rustem Gaxhi — siç nisi të rrëfejë — ish një trim kokëshkretë, që kish luftuar parrështur herë nën atë, herë nën këtë princ arab. I pëlqente burria dhe lavdia e burrave. Ish gati të luftonte me këdo. Ai numuronte njëqint kokë trimash fort të rrallë, që i kish prerë një nga një në

shesh të mejdanit. Kebir el Rustem Gaxhi nuk e pinte shumë verën. Pëlqente mishin e dashit të pjekur dhe sherbetin e mjaltit.

«Trimëritë edhe fitoret e tua, o princ i madh, më kanë mahnitur dhe më kanë tronditur përmbi çdo gjë tjetër në jetë. Erdha këtu, të shikoja çfarë burri është ky Skënderbeu, me ç'lloj armësh lufton dhe si ka mundur nëna të pjellë një të tillë dragua. Desha të mësoj si lufton princi i madh dhe cila është e fshehta e lavdisë së tij. Që është një strateg fort i shquar, këtë e dimë të gjithë. Por nuk besoj se çdo gjë është arritur në saje të atij apo këtij manovrimi luftarak. Vendi juaj nuk është aq i madh sa t'i bëjë ballë Turqisë, e cila sot rreh të marrë botën. Nuk kuptoj pra qysh kini mundur ju t'ja delni mbanë kësaj lufte, o kapedan i ndritur. Si kini arritur të fitoni të gjitha luftërat? Si kini arritur të korrni një lavdi të pashoqe, të cilën ua ka zili e gjithë bota që tek ngrihet e deri tek përmbysset dielli?

Muhameti na mëson se rob i Allahut, sado trim apo i ditur që të jetë, prapseprapë, nuk e kapërcen dot qarkun e forcës së tij. Por mua më duket, o princ fort i dëgjuar, se ju e kini kaptuar qarkun e forcës tuaj dhe se po bëni ca mrekullira, për të cilat më besohet se s'ka si t'i përkasin vetëm një dore, sado e ndritur apo e fortë që të jetë kjo. Desha të di, a ka gjë të fshehtë në qënien tuaj. Mos vallë ju kini depërtuar në mosqënien, duke shtënë kështu në dorë ndonjë mjet magjik, për të drejtuar fatin si lodër shahu? Mos vallë ju kini zbërthyer të fshehtat e misterit dhe ndaj mbeteni kështu zot absolut, i pathyer në betejë dhe i parritur në lavdi? Si kini stisur ju këtë përsosmëri

trimërie? Ja këto desha të di, o i madhi Skënderbe, shëmbëlltyra e Aleksandrit të madh».

Fjala e arabit u dëgjua me respekt dhe nderim nga të gjithë. Askujt nuk i shkoi ndër mend të mendojë se arabi foli shumë. Përkundër, sapo la fjalën, të gjithëve u erdhi keq që pushoi gojaria e tij.

— Dëgjoni Kebir el Rustem Gaxhi, efendi, trim mbi trima dhe i urtë si Muhameti lavdëmadh. Po deshët, lemëni radhën të pyes: Përse ju kini luftuar me bujë e batërdi herë ndënë këtë, herë ndënë atë principatë? — i tha të huajit Skënderbeu. Të gjithë u çuditën nga kjo pyetje, bile as vetë trimi arab nuk e priste këtë. Ai u zù ngushtë. Uli kokën, ktheu një kupë me shërbet, pastaj duke iu drejtuar Skënderbeut tha:

— Nuk e kuptoj se ku qëlloni kështu. Jo, o urtësia e princërve. Vajta dyzet vjeç dhe këtë pyetje s'kam dëgjuar të ma bëjë njeri. Do ju përgjigjem. Unë luftoj i harbuar vetëm për lavdi e madhëshhti. Vras e pres që bota të thonë se mbi tokë u ngjall Rustem Zalli. Dua që të gjithë të ma kenë frikën. Të gjithë të dridhen nga unë.

Si tha këto, arabi priti sërish përgjigjen, duke shikuar me zili nga Skënderbeu. Po Kryetrimi nuk nxitohej fare dhe as që e vërente padurimin e mikut.

— Ja ta zëmë se ja arritët asaj dite, vijoi ai, po pastaj çdo bëni në jetë?

— Pastaj? — Arabi mblodhi supet e gjëra. — Ku ta di unë se ç'do bëj pastaj! Mëndja e robit nuk arrin të shkoqisë gjëra që s'i ka provuar, o princ i madh.

Po kur s'arrin t'i shkoqisë, përse ahere

arrin t'i lakmojë ato duke derdhur gjithë këtë gjak — pyeti sërish Princi, pa e lënë tjetrin të çlodhej.

— As këtë nuk e di — tha arabi, duke ngrysur të dy vetullat, që ngjanin me dy kreshta resh në shënëndre.

— Nuk e di — vijoi papritur arabi. Nuk e di, por e shoh se sado që të luftoj unë, edhe sikur të fitoj për njëqint vjet radhë, prapseprapë e kuptoj se juve nuk ju arrij dot në lavdi.

— Ju e lartësoni pa kursim lavdinë time, o bujar i largët. Megjithatë unë po jau tregoj një për një të fshehtat e kësaj fame. Lavdia që ju pandehni se më përket mua, në të vërtetë ju takon ja këtyre kapedanëve këtu, popullit dhe ushtrisë sime. Tek ne, të gjithë luftojnë si luanë për lirinë e vatanit. Kështu, o mik i largët e bujar, cilido princ në botë, me këta kryetrima që po shikon rotull meje, me një popull dhe ushtri të tillë, do e kish dërmuar armikun po me aq burrëri sa dhe ne. Dashtë Zoti që dhe ju ta arrini ndonjë ditë këtë famë, meqë jini kaq i etur për të dhe meqë përpiqi kaq shumë dhe kaq me zjarr.

Arabi ndërkohë luajti pak nga vendi dhe bëri të afrohej akoma ndaj Skënderbeut. Priste të dëgjonte gjëra mrekullisht të habitshme dhe pafundësisht të vyera e të shtrenjta për jetën.

— Ju e kini kënduar Shah-Namenë, apo jo?

— E kam kënduar mbi njëqint herë, pothuaj di përmëq çdo faqe.

— Ashtu de! Po qysh s'e kini kuptuar se kundër kujt luftonte Rustem Zalli që fitoi gjithatë nam në jetë të jetëve?

— Ja kjo s'më ka shkuar ndër mend, se mua më kanë rrëmbyer vetëm trimëritë e tij.

— Po kjo duhet t'u shkonte ndër mend, efendi. Ju kini luftuar si një dragua i vërtetë, por falmëni. Ju s'kini ditur përse luftoni. Ju s'kini ditur përse e kini derdhur gjithatë gjak, përse i kini prerë gjithë ato koka trimash fort të dëgjuar. Ju kini harbuar me kalë nëpër botë me shpatë në dorë, pa ditur se ku do shkonit, me kë do ndesheshit dhe përse do luftonit. Ndërkohë mëmëdheu juaj ka patur aq shumë nevojë për trimat si ju. Ndërsa ju shkuat larg, i vetëm, pa miq dhe vëllezër prapa, pa u kujtuar se ku është dhe ç'po bën vatani. Nuk u vinte mallë as për nënën, as për njerëzit. As juve për këta as këtyre për ju. Bëtë heroizma të mëdha, po kujt i hynë në punë trimëritë tuaja, kujt i ndihën në jetë? Kujt ja hoqët ju hekurat e robërisë? Kujt i sollët lirinë dhe pasurinë me shpatën tuaj të famshme! Ju kini luftuar vetëm për vete. Përse pra kërkoni lavdi në botë e në atdhe? Vendi juaj s'kish nevojë që Rustem Zalli i dytë të derdhte dikë në botë rrëkera gjaku. Jo, vendi juaj kish shumë nevojë që të luftonit dhe ju për lirinë e tij, për pasurinë e tij, kurse kjo gjë as që u ka shkuar ndër mend. Pa mendoni pak sikur gjithë këto luftra, gjithë këto heroizma e fitore që kini korrur deri tani t'i kishit bërë në emër të lirisë së mëmëdheut! Po të kish ngjarë kështu, ju siguroj, i dashur mlk Kebir el Rustem Gaxhi, që edhe ju do kishit fituar një lavdi po aq të madhe sa dhe ne. Po të kish ngjarë kështu në jetën tuaj, ju s'do ma kishit zilinë as mua, as kreshnikut të madh Rustem Zallit.

Arabit i humbi fare zëri dhe po shikonte i ne-

mitur nga princi i madh. Atëkohë e kuptoi mirë, se me të vërtetë ky burrë ish i paarritshëm. Atëkohë arabí e kuptoi dhe përse qe kaq i madh dhe kaq i paarritshëm Princi i Arbërit.

— Ju faltë Zoti ymër dhe Allahu qoftë me ju o Skënderbe! Sot më kini hapur sytë. Sot mësova përse kam ardhur në botë dhe ç'duhet të bëj. I mësova të fshehtat e lavdisë së madhe. S'kam pse të pyes më tutje.

Skënderbeu u ngrit dhe e mori për qafe trimin arab. Oda u ndez nga brohoritjet.